



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br. 66/22
Nr. i fq. / Br. si - 1 -
Data: / Datum 21.3.2022
VUSHTRRIË- VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **31 mars 2022 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 j shkurt 2022;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2022;
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomike – financiare dhe zbatimin e planeve investuese, i punës së Kryetarit të komunës – ekzekutivit për vitin 2021;
4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2021/2022;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021;
6. Shqyrtimi i Planit të punës i Këshillit për Siguri në Bashkësi për vitin 2022;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave të pashpenzuara dhe tejkalimi i planifikimit të të hyrave nga viti 2021 në vitin 2022;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimeve për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdheve në Komunën e Vushtrrisë;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve në bujqësi;
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës për lirim nga pagesa e taksës për shërbimet e çerdheve publike;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë;
14. Të ndryshme.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuesë e Kuvendit të Komunës





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 65/22

Nr. i fq. / Br. sf - 1 -

Data: / Çurim 21. 3. 2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

PËR/ZATO:	Kuvendin e komunës
NGA/OD/FROM:	Melihate Basholli Latifi <i>Melihate Basholli Latifi</i> Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Sekretarisë së kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 17.3.2022

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 54, paragrafit 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 5, paragrafit 1, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **17 mars 2022** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomike – financiare dhe zbatimin e planeve investuese dhe i punës së Kryetarit të komunës – ekzekutivit për vitin 2021.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
2. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2021/2022.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të plotësohet me informata analitike dhe të detajuara dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdheve në Komunën e Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës për lirim nga pagesa e taksës për çerdhet publike.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e nismës për identifikimin e shtëpive – shkolla (themelimi i komisionit).
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
9. Shqyrtimi i Planit të punës i Këshillit për Siguri në Bashkësi për vitin 2022.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E I E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 24 SHKURT 2022

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit - në deklaratimet e anëtarëve të kuvendit para rendit të ditës njoftoi se duke u bazuar në nenin 14, paragrafi 14.1.6. që legjitimon të drejtën e qytetarëve për të parashtruar çështjen para kuvendit, fjalën ia dha Ismaj Hazirit, për të referuar kërkesën e tij para anëtarëve të kuvendit.

Ismaj Haziri, qytetar i Komunës së Vushtrrisë - njoftoi kuvendin se në vitin 2012, kishte parashtruar kërkesë në Drejtorinë e Urbanizimit për pajisje me leje ndërtimore, pasi i kishte plotësuar të gjitha kushtet e parapara me legjislacionin në fuqi, dhe shikimit të vendit të ngjarjes dhe konstatimit të gjendjes faktike, Drejtoria e Urbanizimit akoma nuk ka vendosur lidhur me këtë kërkesë. Kësisoj zyrtarët e kësaj drejtorie e kanë zvarritur këtë çështje dhe kështu ai është maltretuar në aspektin psiko-fizik duke u sorollatur nga një zyrë në tjetrën por pa sukses. Ai pretendon se i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore për pajisje me leje ndërtimore, sipas ligjit apo legalizimit të tij. Drejtoria e Urbanizimit në saje të heshtjes administrative është duke prolonguar vendosjen e kësaj çështjeje dhe kësaj është duke bërë shkelje të drejtave të njeriut. Ai i propozon kuvendit të komunës të merret seriozisht me këtë çështje dhe ta obligojë Drejtorinë

e Urbanizimit që të veprojnë, duke themeluar një komision komunal për verifikimin e kësaj çështjeje dhe gjetjen e një zgjidhjeje sa më të shpejtë.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - sqaroi se kërkesa e z.Ismaj Haziri, do të trajtohet me prioritet përmes Drejtorisë së Urbanizimit dhe konform kuadrit ligjore do të jep përgjigja brenda afatit të arsyeshëm.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – duke ju referuar seancës së jashtëzakonshme të datës 21.10.2019, të thirrur me kërkesën e ish-kryetarit të komunës, ishte nxjerr vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me kompensim për 40 vite Kompanisë “Emona Center” pronë e cila gjendet në fshatin Gracë në sipërfaqe prej 3 hektarësh nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5.37.00 ha. Kjo pronë i ishte dhënë në shfrytëzim kompanisë të cekur më lartë me qëllim të hapjes së biznesit për përpunimin e peshkut të detit, dhe ku kjo kompani vendore do të bashkëpunojë me Kompaninë kroate “Conex Trade” dhe në konsorcium me një kompani tjetër spanjolle. Ndër të tjera është thënë se vlera e investimit nga ky projekt do të jetë 7 milionë euro dhe do të punësoheshin 400-500 punëtorë kryesisht gra dhe vajza, kurse afati për fillimin e realizimit të këtij projekti ka qenë gjashtë muaj, ndërsa finalizimi i projektit do të bëhej brenda 24 muajve. Dhe sot kur jemi në muajin shkurt 2022, ky projekt as nuk ka filluar dhe nuk kemi asnjë informacion për të. Pyetja e tij për kryetarin e komunës është se a është takuar kryetari me përfaqësuesit e Kompanisë “Emona Center” për të diskutuar rreth këtij projekti për faktin se cili do të jetë epilogu i kësaj çështjeje dhe si do të veprohet me çështjen e asaj prone komunale. Pastaj më datë 16.04.2021 po ashtu në një mbledhje të jashtëzakonshme Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka marrë vendim për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite në parkun industrial në fshatin Lumadh, subjekteve afariste për ushtrimin e veprimtarive biznesore, iu ka ndarë parcela 22 bizneseve dhe është thënë se do të punësohen 800 punëtorë, dhe prej asaj kohe kanë kaluar më tepër se 10 muaj dhe akoma nuk kemi vendosje të bizneseve në atë zonë industriale, për këtë çështje pyeti se deri ku kanë shkuar procedurat lidhur me vendosjen e bizneseve në këtë zonë industriale.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – pyeti kryetarin e komunës, se përse nuk u ftuan dhe nuk ishin pjesëmarrëse shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së në rastin e krenimit të 14 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – pasi përshëndeti të pranishmit ngriti shqetësimin e qytetarëve të cilët i dërgojnë fëmijët e tyre në kopshtin e fëmijëve “Foleja”, për siç njoftohet nga ta përhapja e insekteve në këtë çerdhe, gjegjësisht insekteve humane-pleshtave tek fëmijët, për shkak ndoshta edhe të nivelit të higjienës. Në këtë kontekst i bëri thirrje Drejtorisë së Arsimit që të bëjë dezinfektimin e këtij objekti sa më shpejt që të jetë mundur për të rritur sigurinë dhe higjienën e këtij objekti edhe ashtu të vjetruar, dhe që ka nevoja reale për një renovim të atij objekti gjë që beson se është inkorporuar në buxhetin e komunës për vitin 2022.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit – duke ju referuar premtimit elektorale të kryetarit të komunës, që në afat prej 6 muajsh të shtrihet rrejtja e ujësjellësit, kërkoi të di se deri ku kanë shkuar punët lidhur me këtë projekt. Lidhur me këtë ai njoftoi se gjatë periudhës 14 mujore sa ka shërbyer si drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, janë realizuar rreth 4000 kycje në rrjet dhe mëse 23 fshatra. Kanë mbetur edhe 1000 kycje të ekonomikeve familjare pa u realizuar, dhe 6 apo 7 fshatra. Lidhur me këto a është i njoftuar kryetari i komunës dhe a ka ndonjë plan operativ për realizimin e këtij projekti

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - duke ju referuar pyetjeve të anëtarëve të kuvendit sqaroi me sa vijon: lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim kompanisë “Emona” dhe një kompanie kroate për përpunimin e peshkut, njoftoi se nuk ka pasur akoma ndonjë takim me këta përfaqësues të

këtyre kompanive, por së shpejti mendon të mban ndonjë takim, dhe u zotua se ato kompani që nuk i kanë realizuar obligimet, pronat që iu janë dhënë në shfrytëzim do t'i kthehen komunës. Lidhur me projektin e parkut industrial, njoftoi se janë gjetur parregullsi substanciale në kontratat e lidhura me operatorët ekonomik të cilat përbëjnë shkëlqje ligjore. Për secilën pronë të dhënë në shfrytëzim është lidhur një kontratë unike, e që nuk do duhej të ishte ashtu, sepse është dashur të kemi kontrata specifike për secilin biznes duke ia bashkëngjitur edhe planin e biznesit, ashtu që kontrata të jetë në harmoni me planin e biznesit. Ajo çka ka qenë shqetësuese është tek neni 9, pika 7 dhe 8 e kontratës ku thuhet se prona mund të shfrytëzohet për kolateral, mandej thuhet se operatori ekonomik mund të lëshojë në nënqira të parë të drejtën e marrjes në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, tërë objektin e kontratës apo një pjesë të tij. Bazuar në këtë, sqaroi se në bazë të Ligjit për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim në mënyrë decitive thuhet se citojmë nenin 19: e drejta e pronës të dhënë në shfrytëzim nuk mund të bartet tek personat e tretë, që i bie se prona nuk mund të jepet me nënqira. Lidhur me këtë çështje është kërkuar dhe është marrë opinioni i zyrës ligjore në kuadër të komunës dhe kjo e fundit ka konstatuar se nenet e kontratës që i referohen tej bartjes apo nënqirasë bien në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim. Pastaj kur është pyetur zyrtari ligjor se si ka mundësi të lidhet një kontratë e tillë në kundërshtim me ligjin, ai është përgjigjur se kontratat e tilla fare nuk janë trajtuar në zyrën ligjore gjë që e shton dyshimin se këto kontrata janë bërë jashtë komunës. Kësisoj duke marrë për bazë të gjitha këto me 14 janar 2022 është thirrur një takim me të gjitha bizneset përfituese të pronës në atë zonë ekonomike, ku janë njoftuar se nuk janë kundër bizneseve, porse deri sa të bëhet revidimi i atyre kontratave dhe të qartësohen këto gjëra që të shfuqizohet neni i cili i lejon bartjen e pronës tek personat e tretë në nënqira dhe deri atëherë do të ndërpritet puna. Të gjeturat tjera janë se ka filluar tjetërsimi i pronave në zonën ekonomike, dhe kjo në të vërtetë përbën një shqetësim të madh. Lidhur me të gjitha këto, janë alarmuar organet gjegjëse, dhe lënda është duke u hetuar nga krimet e rënda ekonomike, andaj deri në një vendim të organeve kompetente ky projekt do të stopohet, ashtu që të bëhet revidimi i kontratave dhe ecet tutje. Sa i përket çerdhes së qytetit tha se Drejtoria e Arsimit duhet t'i ndërmarr menjëherë masat për dezinfektimin e atij objekti. Në fund tha se sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm njoftoi se ka realizuar takime me kompaninë e ujësjellësit me qëllim të sanimit të gjendjes në terren, dhe gjetjen e zgjidhjes sa i përket fshatrave që kanë terren kodrinor-malor, ku uji nuk shkon me rënie të lirë, sidomos në pjesën lindore të komunës.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – lidhur me çështjen e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, për ndërtimin e fabrikës së peshkut, shtoi se ka qenë efekti i pandemisë që ka ndikuar në zhvillimin e këtij projekti, dhe vlerësoi se është e drejtë e komunës që të denoncoj ato kontrata kur operatorët ekonomik nuk i përmbushin kushtet dhe obligimet për investime që janë paraparë në kontratë. Pastaj sa i përket zonës ekonomike, sqaroi se nëse për një çështje të caktuar ekziston një ligj specifik, atëherë ai ligj do të ketë epërsi për atë çështje duke i përjashtuar ligjet tjera, në rastin konkret ekziston Ligji për Zonat Ekonomike që e rregullon këtë çështje, neni 11, pika 8 e këtij ligji thotë: E drejta e shfrytëzimit brenda zonës ekonomike nuk mund t'i bartet ndonjë personi të tretë pa pëlqimin e themeluesit ose, në rast të mbikëqyrjes të zonës ekonomike përmes partneritetit publiko- privat, të personit të autorizuar për ndërtimin dhe mbikëqyrjen e zonës ekonomike, andaj në rastin tonë themelues i zonës ekonomik është Komuna e Vushtrrisë dhe me pëlqimin e kësaj të fundit mund të tejbartet kjo pronë. Në fund tha se komuna jonë i ka marrë përvojat nga Komuna e Drenasit sa i përket zonës ekonomike dhe kontrata për këtë çështje është marrë nga modeli i Drenasit.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - tha se ligj specifik për dhënien e pronës në shfrytëzim është Ligji për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim, ndërsa Ligji për Zonat Ekonomike përcakton norma

dhe standarde sa i përket funksionimit të zonave ekonomike. Sa i përket të gjeturave lidhur me këtë zonë ekonomike, ato janë fakte dhe janë konstatuar nga juristët e zyrës ligjore, që i kanë adresuar përmes opinionit të tyre ku thuhet se ka pasur shkelje substanciale gjatë hartimit të kontratave mes komunës dhe operatorëve ekonomik. Tutje vlerësoi se në rastin konkret jemi duke folur për prona komunale të cilat janë dhënë në shfrytëzim, por duhet të kemi parasysh se pronat duhet t'u jepen në shfrytëzim atyre që kanë dhe investojnë kapitalin e tyre për të hapur vende pune, e jo për përfitime personale dhe tjera. Në fund sa i përket ftesës së shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, njoftoi se ato janë ftuar dhe iu kanë bërë ftesë që ata të dërgojnë një përfaqësues që të jetë pjesë e këshillit organizativ, ashtu siç edhe e kërkon ligji, por Shoqata e familjeve të dëshmorëve e ka dërguar përfaqësuesin e tyre z.Enver Isufin i cili është pjesë e këshillit, e i cili ka marrë pjesë në dy apo tri takime, por e vërteta është se ata janë ftuar të gjithë që të jenë pjesë e organizimeve dhe aktiviteteve për nder të 14 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, por hatërmbetja e tyre ka qenë se përse të gjitha këto shoqata nuk janë në këshillin organizativ, gjë të cilën nuk e lejon Ligji i Protokollit të Shtetit. Në fund u zotua se këto shoqata do ta kenë përkrahjen e plotë të tij si kryetar i komunës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – pyeti se prej 22 bizneseve që janë përfituese të pronës në zonën ekonomike a ka ndonjë biznes që është tërhequr, duke mos dashur që të investojë. Pastaj adresoi kërkesën e banorëve të fshatit Lumadh që të rregullohet kanalizimi dhe një urë e cila është dëmtuar gjatë ndërtimit të zonës ekonomike, kërkoj nga komuna dhe punëkryerësi që ta bëjnë sanimin e gjendjes duke e rregulluar urën dhe kanalizimin.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - sqaroi se deri tani nuk kemi ndonjë operator ekonomik që ka njoftuar se tërhiqet nga prona. Ndërsa sa i përket rregullimit të urës dhe kanalizimit do të shikohet mundësia për futje në projekte kapitale për ndërtimin e tyre dhe sanimin e asaj gjendjeje.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit – pyeti drejtorin e Shërbimeve Publike, lidhur me kyçjen e njësorëve për ndriçimin publik, dhe pasi ka pyetur në KEDS përgjigja e tyre ka qenë se nuk kanë kërkesë nga komuna për mbulimin e shpenzimeve, konkretisht bëhet fjalë për rrugët në fshatin Stanoc i Epërm rr. “Ferat Haxha”, rr. “Rrahim Kosumi”, rr. “Sadik Mala”, rr. “Caka”.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së - sqaroi se ndër kërkesat e para që ka nënshkruar janë ato për pajisje me njësor elektrik për ndriçim publik, dhe të njëjtën e ka adresuar në KEDS, por sa ai ka informacion prolongimi po ndodh për shkak të krizës energjetike.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha më herët nuk ishte deklaruar sa i përket zonës ekonomike në Lumadh, por e vërteta është dhe ai ka bindjen se kryetari Idrizi dhe qeveria komunale është e interesuar që ky projekt të zhvillohet dhe të funksionalizohet në tërësi, sepse është investimi më i madh në Komunën e Vushtrrisë që nga paslufta. Tutje shtoi se çështja e mospajtimeve lidhur me kontratat është evidente dhe dëshiron që të sqaron para opinionit se personalisht ka qenë pjesë e komisionit dhe krenohet me punën që ka bërë komisioni. Ndarja e pronave është bërë konform kritereve, dhe konsideron se funksionalizimi i këtij projekti është në interes të përgjithshëm sidomos në këtë kohë të krizës ekonomike të papunësisë dhe varfërisë. Më tej sqaroi se dhënia e pronës në shfrytëzim ka kaluar të gjitha fazat ligjore, duke përfshirë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila me vendimin numër 020-363/3 të datës 30.4.2021, ka dhënë opinionin e saj përmes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si kompetente e lëndës dhe si konkluzion është nxjerrë se: pas trajtimit të kërkesës së MAPL-së për vlerësimin e ligjshmërisë të vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për dhënie e pronave në shfrytëzim në zonën ekonomike në Lumadh, Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë jep opinion se zhvillimi i këtij projekti është bërë konform legjislacionit në fuqi. Çështja e kontratave është kompetencë ekskluzive e kryetarit të komunës, dhe se një nga nenet e kontratës thotë se palët më vullnetin e tyre mund ta ndryshojnë

dhe modifikojnë kontratën në mes tyre, që do të thotë se palët në procedurë mund të përmirësojnë ndonjë gabim teknik ose përmbajtjesor i kontratës dhe të vazhdojnë procedurat sepse vetëm një investitor do të investojë rreth 4,800,000.00 € në atë zonë ekonomike. Çështja e bartjes së pronësisë është diskutabile ndoshta në aspektin juridik, por në aspektin ekonomik është shumë në rregull, kjo për faktin se si do të vjen një investitor i jashtëm të investojë në një shoqëri aksionare në pronën e dikujt tjetër, ndoshta këtu gabimi është se është dashur të jetë se kjo të bëhet me aprovimin e komunës e që kontrata mund të modifikohet e që nuk barten kurrfarë pasojash me pëlqimin e të dyja palëve. Andaj si përfundim beson se nuk ka pasur nevojë që t'i bëhet gjithë ky pompozitet dhe çështja të zvarritet duke e dërguar në prokurori, sepse ky arazhman-projekt i ka kaluar të gjitha fazat ligjore. Ai apeloj se aksenti do duhej të ishte tek pranimi teknik i këtij projekti, mbushja me zhavorr e terrenit të parkut industrial e të ngjashme. Krejt në fund ai deklaroi se nuk beson se dikush ka pasur tendencë që dikë ta dëmtojë dhe se shpreson se ky projekt të vazhdojë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - sqaroi se sa i përket komisionit nuk ka dyshim se punën e kanë kryer në mënyrë profesionale, dhe nuk ka ndonjë vërejtje, por problematika është tek lidhja e kontratave, sepse këtë e ka konstatuar edhe zyra ligjore derisa ata kanë dhënë mendimin e tyre profesional ai nuk dëshiron të lëshohet në interpretime. Ai sqaroi se nuk ka tendencë të bllokimit të këtij projekti, por dëshiron që të ketë spastrim sa i përket anës ligjore të kësaj çështjeje.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit – tha se zona ekonomike është një projekt më i madh që nga paslufta, ajo është financuar nga Ministria e Tregtisë e cila në atë kohë është udhëhequr nga Nisma Socialdemokrate. Pastaj lidhur me kontrata vlerësoi se anëtarët e kuvendit nuk janë të informuar se si janë lidhur ato kontrata sipas cilave kritere, standarde dhe cilat specifikacione janë marrë për bazë. Kontratat nuk mund të ndryshohen, ato duhet të jenë konstante, përderisa një gjë të tillë nuk e bënë kuvendi. Në momentin e lidhjes së këtyre punëve juridike, në kontratë duhet të parashihen fillimi i zbatimit të punëve, afatet e realizimit, plani biznesor, investimi dhe specifikime tjera. Mandej operatorët ekonomik duhet ta kishin dhënë garancionin bankar me qëllim që të kemi siguri sa i përket realizimit të investimeve. Ai e përgëzoi kryetarin e komunës që lëndën e ka dërguar në prokurori dhe ky projekt duhet të stopohet deri në një vendim të prokurorisë, ashtu që çështjet të spastrohen nga elementet e kundërligjshme.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – tha se sikurse edhe në mbledhjen e kaluar edhe në këtë mbledhje kemi pika shtesë, që janë dërguar në të ndryshme pa kaluar në procedura ligjore. Ai nuk e di nëse këto pika kanë ndonjë urgjencë të cilat janë sjellë kështu pa ndonjë arsyetim të bazuar.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - sqaroi se nuk është ithtar që pikat të sillen me vonesë, pa kaluar procedurat ligjore, por sido që të jetë kjo le të mbetet në vullnetin e kuvendit se a dëshiron që t'i shtyjë përpara. Në arsyetimin e tij ai njoftoi se çështja e tregut është e natyrës urgjente, sepse kemi të bëjmë me një donacion, sepse lokacioni ku atje është paraparë ndërtim i tregut ka qenë në pronësi të AKP-së. Lidhur me rekomandimin për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit për dhënien e kioskave në shfrytëzim, njoftoi se është themeluar një komision në ç' rast është konstatuar se kemi të bëjmë me nënqira të atyre pronave dhe kësaj duhet të bëhet shfuqizimi i pjesshëm i vendimit me të cilin janë dhënë në shfrytëzim ato prona.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – tha se është mirë që të flaken praktikat e këqija të procedimit të pikave të rendit të ditës, sepse kjo ndikon edhe në marrjen vendimeve të paanalizuara mirë, dhe të gabuara. Për çështje për të cilat ekziston arsyetimi se kanë urgjencën e vet nuk janë që t'i bllokojnë sikurse është puna e tregut të gjelbër që ka qenë prioritet edhe i subjektit të tij politik, andaj kjo duhet të procedohet. Mandej shtoi se është joserioze që një pikë e rendit të ditës sikur është propozimi për subvencione të ndryshohet tri herë brenda një periudhe shumë të shkurtër

në KPF vjen një material tjetër, mandej në adresë elektronike dërgohet një tjetër, ndërsa sot brenda seancës në material fizik vjen krejt diçka tjetër. Në fund shtoi se pika që nuk kanë urgjencë mos të procedohen fare, por të mbesin në mbledhje në afat të rregullt.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – kërkoi nga kryetari i komunës që mos të ngatërrohet tregu për prodhues vendor, me tregun që ka pasur të ndërtohet në zonën tek Interex, sepse janë dy projekte krejt të ndryshme. Lokacionin për tregun për prodhime vendore e përkrahin sepse në atë sipërfaqe do të mund të ndërtohej një treg i mirë. Por ai kërkoi nga kryetari i komunës që ta publikojë vendimin e AKP-së që lidhet me lejimin e zhvillimit të projekteve në prona të AKP-së që gjenden në procedurë të shpronësimit për qëllim të interesit të përgjithshëm.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - tha se do t'i dërgojë anëtarëve të kuvendit gjithë korrespondencën që ka pasur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe sqaroi se vendimi të cilit i referohet anëtari i kuvendit z.Lahu ka të bëjë me një vendim të kryeministrit për iniciimin e procedurave të shpronësimit me qëllim të bartjes së pronësive tek komuna për pronat që tani gjenden në emër të AKP-së.

Alban Tahiraj, drejtor i DGJKP-së - tha se kur t'i referohemi një dokumenti-akti, duhet t'i shkojmë deri në fund, e jo duke e cituar pjesërisht, duke tentuar të keqpërdoret, dokumenti për të sajuar një gjendje që në fakt nuk ekziston. Lidhur me këtë sqaroi se vendimi që anëtari i kuvendit z.Lahu i referohet, i lëshuar nga AKP-ja, ka edhe një shkresë përcjellëse ku është obliguar komuna, që brenda afatit tridhjetëditorë të paguajë 20 % të shumës që del nga procesi i privatizimit, por kjo pagesë nuk ka ndodhur dhe atëherë në qeverisje ka qenë LDK-ja. Komuna përkatësisht qeveria aktuale e komunës, ka komunikuar me AKP-në dhe aktualisht kemi dy alternativa për të lëvizur përpara, të aplikohet këmbimi i pronave mes komunës dhe AKP-së, apo përmes shpronësimit dhe kjo mund të vërtetohet me fakte dhe prova. Pengesat në këtë proces kanë dal sepse qeveria e kaluar nuk i ka përmbushur obligimet e 20% dhe ky proces ka mbetur i pafinalizuar.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – tha se në të kaluarën janë zhvilluar projektet pikërisht në pronat e AKP-së, siç është ndërtimi i gjimnazit në Vushtrri dhe një objekt i QMF-së po ashtu në Vushtrri që janë ndërtuar në të kaluarën dhe tani po dalin pengesa tjera që janë të natyrës së njëjtë.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit - propozoi që pika që lidhet me ndryshimin e vendimit për themelimin e KKS-së të tërhiqet nga rendit i ditës, ndërsa dy pikat tjera të mbesin si pjesë e rendit të ditës pasi e kanë rëndësinë dhe urgjencën e vet.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 33 vota “për” 2 vota “kundër” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 janar 2022;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2021;
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit pesëvjeçar të menaxhimit të mbeturinave 2022 – 2026;
4. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2021 në Komunën e Vushtrrisë;
5. Propozim – vendim për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina, për familjet përfituese të asistencës sociale;
6. Propozim – vendim për ndarjen e subvencioneve;

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e nismës, për identifikimin e shtëpive – shkolla (themelimi i komisionit);
8. Shqyrtimi i rekomandimit për shfuqizimin e pjesëshëm të vendimi të kuvendit me Nr. protokollit 01Nr.125/14 i datës 28.05.2014, apo shkëputjes së kontratave për dhënien në shfrytëzim të kiosqeve;
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër të prodhuesve vendorë në Komunën e Vushtrrisë;
11. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 janar 2022

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – paraqiti vërejtje për procesverbalin e mbledhjes të datës 31 janar 2022, të cilat u inkorporuan në procesverbal.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 janar 2022, me korrigjimin e lartshënuar.

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2021

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – pyeti se a ka ankesa të qytetarëve ndaj policisë që operojnë në Komunën e Vushtrrisë.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit – pyeti se çfarë masash janë duke u ndërmarr për trajtimin e problemit me qentë endacakë, dhe cilat janë arsytet e rritjes së numrit të veprave të rënda penale.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës - njoftoi se është lidhur një memorandum i mirëkuptimit mes komunës dhe një organizate zvicerane për trajtimin e qenve endacakë ku do të trajtohen deri në 600 qenë endacakë. Por lidhur me këtë problematikë do ta kontaktojë kryetarin e komunës së Mitrovicës dhe atë të Obiliqit, për shkak të pozitës gjeografike që kemi ku mund të ketë lëvizshmëri të tyre prej një komune në komunën tjetër. Ideja do të ishte që të shkohet në një projekt me bashkëfinancim për ndërtimin e një kampi të përbashkët për trajtimin e tyre.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - kërkoi nga drejtorja kompetente komunale që të bëjë kërkesë në KEDS për renovimin dhe ndërrimin e shtyllave elektrike dhe për renovimin e rrjetit pasi ai po paraqet rrezik për qytetarët. Si kryetar i fshatit Stanoc i Epërm ka bërë kërkesë në KEDS për renovimin e shtyllave dhe rrjetit në disa lagje, por nuk ka marrë përgjigje nga ana e KEDS-it. Ai apeloi që të mbahen takime bashkëpunuese me policinë për ngritjen e vetëdijes për shfrytëzimin e nënkalimeve siç kishte ndodhur një në vitin 2018 që kishte rezultuar si mjaft i suksesshëm.

Reshat Kovaçi, komandant i Stacionit Policor në Vushtrri - paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me informatën për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2021, duke iu përgjigjur temave të ngritura nga anëtarët e kuvendit. Lidhur me pyetjen se a ka ankesa ndaj zyrtarëve policorë, konfirmoi se ka ankesa në vazhdimësi dhe të njëjtat adresohen në stacionin policor dhe në Inspektoratin Policor të Kosovës. Ankesat që dërgohen në stacionin policor, adresohen në inspektoratin policor për shqyrtim se a përbëjnë element të veprës penale të rëndë apo shkelje të lehta disiplinore. Në aspektin statistikor, del se kemi rënie të numrit të veprave

penale kundër pasurisë-vjedhje, dhe grabitjeve dhe kësisoj mendojmë se kemi indikator pozitiv në këtë relacion.

3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit pesëvjeçar të menaxhimit të mbeturinave 2022 – 2026

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-tha se Plani pesëvjeçar i menaxhimit të mbeturinave 2022 – 2026, është hartuar nga një grup i ekspertëve në kuadër të DSHP-së dhe ftoi kryesuesin e grupit që ta bëjë prezantimin e këtij plani.

Islam Latifi, zyrtar në DSHP - pasi i përshëndeti të pranishmit tha se, kam nderin dhe kënaqësinë, që në cilësinë e koordinatorit të grupit punues për hartimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, të paraqesë synimet dhe objektivat, si dhe punën e deritanishme që është bërë në hartimin e këtij plani strategjik pesëvjeçar. Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të Qeverisë së Kosovës, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve, si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale. Pra ky ligj delegon më shumë autoritet dhe përgjegjësi te qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Pra në këtë kuadër janë qartësuar edhe përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Inputet e para për menaxhimin e mbetjeve Komuna e Vushtrisë i ka marrë nga partneriteti i ndërtuar me Komunën e Vaxjo- s, i cili partneritet ka ndikuar dukshëm në ngritjen e kapaciteteve të grupit punues, për formësimin e idesë dhe konceptit për menaxhimin e mbetjeve si shërbim prioritar për qytetarët. Planifikimi krahas edukimit, krahas aspekteve financiare dhe legislative, është përcaktuar si një nga (katër) shtyllat kryesore vendimtare për zbatimin e politikës dhe të strategjisë për menaxhimin e mbetjeve, dhe thelbësore për të garantuar qëndrueshmërinë dhe suksesin e menaxhimit të tyre në nivel lokal dhe qendror. Prandaj, Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të implementimit të kësaj infrastrukture ligjore, krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë përmes menaxhimit të plotë të mbeturinave, në bashkëpunim me GAC, ka hartuar Planin për Menaxhimin e Mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrisë, duke synuar periudhën pesëvjeçare 2022-2026. Ky plan i menaxhimit të mbeturinave korrespondon me Ligjin për mbeturinat dhe Strategjinë kombëtare për menaxhimin e mbeturinave, si një plan afatmesëm, përderisa këtij plani i ka paraprirë plani i mëhershëm komunal pesëvjeçar 2016-2020 i miratuar nga kuvendi komunal i atëhershëm, në mënyrë unanime, mirëpo i shoqëruar me skepticizëm në realizmin e suksesshëm të tij, për shkak të marrjes së përgjegjësive nga ndërmarrja publike “Uniteti” dhe bartjes së tyre në komunë, që nënkuptonte marrjen përsipër të inkasimit dhe pagesën e faturës mujore për kryerjen e shërbimit nga ndërmarrja. Përmes planit të kaluar për menaxhimin e mbeturinave, suksesshëm kemi arritur shtrirjen e ofrimit të shërbimit për menaxhimin e të gjitha mbeturinave komunale në tërë territorin e Komunës së Vushtrisë, përcaktimin e shkallës së gjenerimit të mbetjeve për pesë vitet e kaluara dhe një varg çështjesh të domosdoshme siç ishin: krijimi i një kuadri institucional organizativ dhe rregullativ, krijimi dhe zhvillimi i një softveri, pra sistemit të menaxhimit të të dhënave, kontraktimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave me kompaninë “Uniteti” në bazë të kapaciteteve të saj dhe në bazë të planit operativ, mënyrën e llogaritjes së kostos dhe nevojave financiare përmes hartimit të planit financiar, fushatën e vetëdijesimit publik, si dhe në ndërkohë verifikimin e fizibilitetit të këtij projekti. Gjithashtu gjatë hartimit të planit të ri komunal 2022-2026, është bërë një studim përmbajtësor i gjendjes ekzistuese dhe mundësive apo alternativave të reja në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Në bashkëpunim të plotë me përfaqësuesit e “Unitetit” kemi arritur të definojmë sasinë e gjeneruar të mbetjeve në tërë territorin e komunës, e që është 54.6 t/ditë, sasi

e cila aktualisht deponohet në deponinë regjionale në Gërmovë që në bazë vjetore është 19 929 t/vit, pastaj sasinë dhe përqindjen e mbetjeve nga amvisëria dhe mbetjeve tjera qoftë ato të riciklueshme, qoftë mbetjet tjera në raport me totalin e sasisë së gjeneruar. Përveç kësaj ky plan në përmbajtjen e saj përmban edhe shkallën e rritjes së sasisë së gjenerimit të mbetjeve e bazuar ekskluzivisht në shkallën e rritjes ekonomike përmes BPV dhe shkallën e rritjes së popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2011. Nga përvoja dhe praktikat e shteteve të zhvilluara siç është Komuna e Växjö-s së Suedisë, kemi vërejtur se ata kanë ndërtuar një sistem tërësisht të integruar të mbeturinave dhe ujërave të zeza, në ç rast mbi 90% e mbetjeve ripërdoren në industri, një pjesë për prodhimin e biogazit, një pjesë për prodhimin e energjisë elektrike, ndërsa vetëm 8-10 % e sasisë së mbeturinave deponohet në deponi. Prandaj edhe synimi ynë është që brenda këtij pesëvjeçari të zvogëlojmë dukshëm sasinë e mbeturinave që duhet të deponohet në deponi përmes promovimit dhe praktikimit të ndarjes së mbeturinave që në burim, pastaj kompostimit të mbetjeve organike dhe riciklimit të mbetjeve të riciklueshme, të rrisim shkallën e inkasimit dhe eliminimin e qëndrueshëm të deponive ilegale. Përmes kompostimit të mbetjeve organike në komposter, ekonomitë familjare do të përfitonin prodhimin e humusit apo plehrave, ndërsa në fushën e riciklimit të mbetjeve të riciklueshme (siç është letra, plastika dhe metalet) ne tashmë e kemi bërë hapin e parë, përmes ndërtimit të qendrës për grumbullimin dhe paketimin e këtyre mbetjeve, e cila aktualisht paketon rreth 40 tonë në vit. Prandaj bazuar në nevojën imediate për menaxhimin e mirëfilltë të mbetjeve, kërkojmë vëmendjen e theksuar për miratimin e këtij plani dhe hapjen e mundësive të reja për menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit - tha se hartimi i këtij plani është model i cili mund të merret edhe nga komunat tjera, dhe për këtë nuk kemi inate politike për ta pranuar si sukses sepse i gëzohemi suksesit të komunës sonë. Nëse ky plan do të krahasohej me planin për studimin e efekteve të pandemisë të cilin e kishte sjellë ish - kryetari i komunës, e për të cilin ishin paguar 140,000.00 €, atëherë del në pah se ky plan për menaxhimin e mbeturinave, i cili sot po shqyrtohet në kuvend është pakrahasimisht më i mirë, më informues dhe më solid për Komunën e Vushtrrisë. Plani për studimin e efektit të pandemisë i hartuar në qeverisjen e Xhafer Tahirit dhe i mbështetur edhe nga PDK-ja në Vushtrri nuk ka qenë gjë tjetër veçse një farsë dhe një instrument për keqpërdorim financiar të parasë publike në Komunën e Vushtrrisë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - pyeti drejtorin e DSHP-së se në kuadrin e kujt funksionon punëtorja për paketimin e letrës në fshatin Bukosh, si dhe sa punëtorë ka ajo fabrikë.

Imi Azemi, anëtar i kuvendit – sqaroi se në kohën kur është votuar vendimi për studimin e efektit të pandemisë, kemi menduar se po votojmë diçka pozitive për Komunën e Vushtrrisë dhe se nuk i kemi ditur prapaskenat e tij. Por i kujtoi z.Malokut se gjithçka që kishte sjellë në kuvend Xhafer Tahiri, grupi i Vetëvendosjes ia kishte bërë “animin akoma pa hapur gojën ai”.

Shkelzen Xhaferi, anëtar i kuvendit – tha se e mbështesin aprovimin e këtij plani dhe njoftoi se hartimi i këtij plani ka filluar në kohën e qeverisjes së LDK-së.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit - tha se aty ku ka pasur interesa grupore e klanore, grupi i Lëvizjes Vetëvendosje asnjëherë nuk ka votuar sikurse ishte ai për 140,000.00 €, por edhe ai i ndarjes së parcelave në Lumadh, këto i kishte nxitur vet Xhafer Tahiri dhe i mbështetur edhe nga PDK-ja.

Imi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se ka respekt për kolegun e tij z.Refik Maloku, por atë ose ka filluar ta lëshojë kujtesa ose fletë të pavërteta, sepse mjetet për atë plan janë votuar pothuajse unanimisht me përjashtim të z.Lorik Maxhuni i cili kishte votuar kundër.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së - njoftoi se punëtorja në fshatin Bukosh, është menduar të funksionojë si ndërmarrje sociale, por akoma nuk e ka marrë këtë status, ajo bashkëpunon me Ndërmarrjen “Uniteti” dhe ka 2 punëtorë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovet Plani Pesëvjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave 2022-2026.
 2. Qëllimi i hartimit të këtij plani është të përmirësojë gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe në përgjithësi përmirësimin e gjendjes mjedisore në Komunën e Vushtrrisë, të ndihmojë në konsolidimin e infrastrukturës ligjore sa i përket çështjeve të ruajtjes së mjedisit.
 3. Obligohet Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike që të ndërmarrë masa për implementim të këtij plani në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore, duke bashkëpunuar me gjithë akterët përgjegjës në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së ambientit.
 4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Pesëvjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave 2022-2026, i Komunës së Vushtrrisë.
 5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektiveve.
 6. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
- 4. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2021 në Komunën e Vushtrrisë**

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – tha se gjithherë do të duartrokasim atëherë kur qeverisja komunale do të bëjë punë të mira dhe në interes qytetar, por gjithherë do të kritikojnë kur nuk punohet dhe bëhen punë jo të mira në Komunën e Vushtrrisë. Andaj shtoi se informata për shërbimet shëndetësore për vitin 2021 në Komunën e Vushtrrisë, ka ardhur në Komitetin për Politikë dhe Financa pothuajse në nivel qesharak, më pas është kërkuar që ajo të plotësohet, por prapëseprapë lë shumë për të dëshiruar, dhe kjo duke filluar që nga aspekti i drejtshkrimit, i cili në një hartim me shkrim nuk do të mund të kalonte me notë pozitive, e deri tek titujt dhe nëntitujt që nuk dihet se ku fillojnë dhe nuk kemi një ndarje strukturore dhe po ashtu ka gabime përmbajtësore që lidhen me rrjedhën e fjalive në këtë informatë. Niveli i hartimit të kësaj informate është për keqardhje dhe kjo nuk nënkupton kritikë me karakter personal, ndaj askujt e veçanërisht ndaj profesionistëve shëndetësorë që kanë dhënë maksimumin, sidomos gjatë etapës së pandemisë. Tutje shtoi se komiteti ka kërkuar që kjo informatë të plotësohet, por nuk kemi kërkuar të ofrohet, sepse nuk ka qenë në rend të ditës informatë për shërbimet në QPS dhe për shërbimet e Qendrës Rezidenciale, të cilat janë inkorporuar në këtë informatë. Pastaj mungon numri i faqeve dhe kjo e bënë të vështirë të adresohen vërejtjet pasi që nuk mund t’i referohesh numrave të faqeve. Referim në vite diku është viti 2020 e diku viti 2021 dhe kjo përbën dyshim se kjo informatë është bërë në

stilin copy-past. Në njërën nga faqet e informatës thuhet: jemi përpjekur si menaxhment që nga fillimi i vitit 2021 në bashkëpunim me DSHPS-në dhe IRSHPK-Mitrovicë, dhe më tej thuhet kemi njoftime zyrtare, këtu kemi përgjysmim të fjalive dhe nuk ka lidhje logjike fjalia. Mandej dinamika e punëve thuhet së është bërë në versionin t'u pa t'u ba, dhe kjo terminologji dhe ky togfjalësh nuk e di se ekziston në menaxhimin e proceseve në shëndetësi, kjo me siguri se përbën “inovacion” në vete, por është mirë të shpjegohet. Pjesa hyrëse flet për panjohuritë për virusin covid-19 në fillim të viti 2021 dhe kjo sikur virusi ka filluar në vitin 2021, por virusi ka filluar në fillim të vitit 2020, ndërsa në fund të po të njëjtës faqe thuhet se kemi bërë njohuri në vitin 2021, derisa më herët ishte shënuar sintagma e funksionimit t'u pa t'u ba, d.m.th kjo informatë një pjesë është e vitit 2020 ndërsa një pjesë është e vitit 2021. Në sektorin e shëndeti publik, pyetja e parë është se përse është shuar vendi i punës i shefit të Sektorit të shëndetit publik të cilin e ushtronte i ndjeri Dr. Safet Idrizi, dhe i njëjti është zëvendësuar me një vend pune në administratë për shkak të punësimeve politike dhe pyetja është se kush e ka udhëhequr këtë sektor gjatë vitit 2021. Pastaj thuhet se laboratorit dhe rëntgeni bëjnë pjesë në diagnostikë dhe kanë të rëndësishme për mjekun, për këtë pyeti se çfarë kuptim ka kjo fjali? Ky përkufizim është i nivelit fillor të të shkruarit. Shërbimet e GPS nuk janë përshkruar se a janë funksionale dhe se në çfarë konteksti janë duke u përdorur, a janë duke e dhënë efektin e kursimit të derivateve siç i kishin dikur në kohën kur ai i kishte implementuar. Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, këtu shkruhet: trajnerët e infermierëve, gjatë pandemisë i kam lutur që përveç punëve të planifikuara të bëjnë trajnime për stafin për higjienën, shtrohet pyetja se kush i ka lutur, dhe se a ka ardhur puna në QKMF-ja të funksionojë në saje të lutjes së stafit, andaj është e turpshme që ky raport të jetë objekt medial, dhe bëhet skandal se çfarë niveli i dokumentacionit kalon në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë. Tek pjesa e bashkëpunimit me AQH-në ku thuhet jemi ndihmuar me pajisje të shumta mjekësore, aparatura dhe inventar dhe mes tjerash gjatë fillimit të vitit 2021 do të realizohen dy laboratorë, d.m.th po flasim për vitin 2020 që janë paraparë ndërtimi i dy laboratorëve në kohën kur ai ka udhëhequr Drejtorinë e Shëndetësisë, ato janë ndërtuar në vitin 2021 dhe kjo është mirë, por në informatë duhet të ceket se këto projekte janë përfunduar. Tutje tek pjesa e investimeve kapitale, e ka cekur shumë shpesh, por edhe në fushatë paraelektorale sepse ka pasur një luftë për t'i përvetësuar meritat për të arritur në fushën e shëndetësisë përgjatë qeverisjes trivjeçare, dhe në këtë kontekst ceku se të gjitha projektet kapitale në shëndetësi në vitin 2021 kanë shkuar në suficit dhe kjo është e vërtetë. Kjo është kështu edhe përkundër faktit se ka informacione se të gjitha projektet dhe kërkesat nga QKMF kanë shkuar me kohë dhe për këtë pyeti se çka ka ndodhur sepse njëri nga zyrtarët e prokurimit tani është emëruar drejtor dhe ai duhet të ketë informata se ku kanë ngecur punët dhe përse nuk janë realizuar këto projekte, por edhe tjerët që kanë qeverisur në këtë kohë duhet ta kenë përgjigjen se janë thirrur se kanë qenë projekte të ish-qeverisjes me emër të ish-kryetarit të komunës dhe përse nuk janë realizuar këto projekte: teknologji informative 20,000.00 €, pajisje mjekësore 85,000.00 €, furnizim me inventar 32,186.062 €, ndërtimi i recepcionit në objektin e ri të QKMF-së 4000.00 €, rehabilitimi dhe izolimi i rëntgenit dhe ventilimi për objektin e ri të QKMF-së 43,523.00 €, rehabilitimi dhe adoptimi i laboratorit në QMF-3 4000.00 €, rregullimi i oborrit të objektit të ri të QKMF-së 30,589.23 €, gjithsej 217,112.23 € kanë shkuar në suficit në kohë pandemie në nevoja të sistemit shëndetësor për përmirësim të vazhdueshëm të gjendjes në suficit për shkak të neglizhencës, keqmenaxhimit dhe ndryshimit që ka ndodhur, një gjë e tillë nuk ka ndodhur në vitet paraprake në një situatë të tillë. Mandej thuhet se jemi në fazën e rekrutimit të dy doktorëve specialistë të mjekësisë familjare një stomatolog, një referent dhe një punëtor për ngrohtore. Ai ka parë konkursin që kërkohen dy stomatologë, kjo kuptohet se njëri është për vendin e tanimë drejtorit aktual të emëruar, por edhe kjo është në kurriz

të shuarjes së një vendi, por për çfarë qëllimesh është duke u bërë kjo na mbetet në seancat tjera të shohim ku duhet të kemi një arsytim se përse duhet të shuhet një vend pune. Nganjëherë është qesharake informata ku në fund thuhet faleminderit dhe shënohen tri !!! me respekt kryerësi i punës së drejtorit të QKMF-së – Vushtrri, dhe ky emërtim nuk mund të gjendet në asnjë normativ shëndetësor, sepse ose duhet të ketë drejtor të QKMF-së, ose ushtrues detyre të drejtorit të QKMF-së. Sa i përket raportit të Shtëpisë Rezidenciale në Lumadh na del edhe diçka që është joetike dhe bie në kundërshtim me ligjin, sepse aty janë publikuar emrat e banorëve rezidentë ku identiteti i tyre është i mbrojtur me ligj, sepse është kundër etikës mjekësore publikimi i emrit të një banori i cili ka ngecje në zhvillimin psiko-motorik, ku ky raport publikohet në faqen e komunës dhe është i qasshëm për publikun dhe mediat. Kjo përbën shkelje të deontologjisë dhe etikës mjekësore dhe për këtë mund të pasojnë edhe suspendime nga detyra për ata përgjegjës. Në fund tha se kritikën e lartshënuara nuk kanë të bëjnë me baza individuale apo personale e aq më shumë për profesionistë shëndetësorë që kanë bërë një punë të shkëlqyeshme, por aksenti ishte tek cilësia e kësaj informate e cila nuk i përmbush standardet minimale të raportimit.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit – tha se gjatë periudhës së pandemisë janë kryer shumë punë nga profesionistët shëndetësor, por pavarësisht nga kjo mbetet shumë për t'u bërë. Tutje pyeti drejtorin e shëndetësisë se përse është mbyllur laboratorin në Lumadh, përse nuk mbahet ndërrimi i dytë i laboratorit dhe rëntgenit, si dhe reparti i stomatologjisë kur dihet se në vitin 2021 është raportuar dhe është hedhur ideja se është mirë të punohet në dy ndërrime në laborator, për shkak të gjendjes së pandemisë, si dhe në laboratorin e QKMF-së, aparaturat janë dërguar në servisim të njëjtat nuk janë kthyer, andaj kur do të kthehen në funksion.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që të ketë për bazë rregulloren e punës të kuvendit sa i përket kohëzgjatjes së minutazhës në diskutimet e anëtarëve të kuvendit, ashtu që të respektohet koha e caktuar në rregullore. Tutje shtoi se informata në fjalë që po shqyrtohet të cilës i është bashkuar edhe informata për QPS-në dhe ajo për shërbime rezidenciale, vlerëson se këto të fundit nuk kanë qenë objekt shqyrtimi nga plani i punës së kuvendit, por edhe përkundëjt kësaj ato vetëm sa e kanë pasuruar këtë informatë. Mandej kërkoi nga ish drejtorët që të jenë më konstruktiv në deklaratimet e tyre në kuvend t'i shërbejnë frymës së bashkëpunimit dhe tolerancës në mes veti. Pastaj shtoi se deklaratimet në stilin e përqeshjes dhe përuljes për gjoja se dikush i njej punët më mirë në një dikaster nuk i shërben askujt dhe nuk ndikon në ngritjen e performancës as në QKMF e as në Drejtorinë e Shëndetësisë.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit – duke ju referuar diskutimit të anëtarit të kuvendit z.Meholli, vlerësoi se informata në fjalë është e vitit 2021, dhe drejtori aktual nuk ka qenë atëherë në udhëheqjen e drejtorisë, e që i bie se të gjitha kritikën për informatën duhet adresuar qeverisë së kaluar dhe jo ndaj kësaj qeverie.

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit – tha se adresimi i kritikave të tij nuk janë të karakterit personal dhe individual por lidhen me përmbajtjen e informatës me qëllim të përmirësimit.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – ngriti shqetësimin e prindërve të nxënësve të klasës së parë, në Stanoc të Epërm të cilët para disa muajve janë vaksinuar, por që gjatë këtij procesi ata kanë pasur frikë të madhe, dhe kjo ka ndikuar tepër keq ku njëri nga fëmijët nga atëherë refuzon të shkojë në shkollë. Lidhur me këtë problematikë apeloj që kur kemi rastet të tilla të imunizimit një ose dy ditë më herët të njoftohen prindërit ashtu që të lehtësohet ky proces. Po ashtu ai kërkoi që të ketë një bashkëpunim më të madh mes zyrtarëve shëndetësor-mësimdhënësve dhe prindërve në kohën kur ka procese të vaksinimit.

Mentor Hasani, anëtar i kuvendit – tha se sa i përket drejtshkrimit në këtë informatë pajtohet se ka defekte, porse nuk e dëmton esencën e informatës. Lidhur me sintagmën <t'u pa t'u ba> e

theksuar në informatë sqaroi se ky model i punës është i përshtatshëm për faktin se covid-19, ka qenë një sëmundje jo e njohur për të gjithë dhe përderisa ka qenë e panjohur ka pasur ndryshim të simptomatologjisë, për këtë arsye mund të pranohet kjo shprehje. Sa i përket shëndetit publik është e vërtetë se një kohë nuk ka pasur përgjegjës, por ka pasur ushtrues detyre, nëse jo me kontratë ka qenë me detyra të punës. Lidhur me laboratorët vlerësoi se të gjithë jemi të informuar me problemet që janë aty, dhe shpreson se me ardhjen e drejtorit të ri në detyrë këto probleme do të zgjidhen. Objekti i QKMF-së është dashur vitin e kaluar të jetë i përfunduar dhe funksional, por kjo akoma nuk ka ndodhur dhe për këtë duhet të japin përgjigje ish-drejtorët e kaluar se një projekt i tillë nuk ka përfunduar. Laboratori në fshatin Lumadh është hapur pikërisht në fushatë dhe kjo është bërë për qëllim elektoral, sepse janë marrë punëtorë për të punuar për një përudhë prej 4 muajve më pas ata janë larguar nga puna, kështu ata janë mashtruar nga qeveria e kaluar. Funksionalizimi i laboratorit duhet të bëhet përmes rekrutimit të stafit për laborant me konkurs të rregullt dhe në suaza ligjore. Lidhur me imunizimin e nxënësve, njoftoi se para se ky proces të realizohet bëhet paralajmërimi i drejtorit të shkollës nga stafi mjekësor dhe gjithçka shkon në koordinim të plotë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – duke replikuar me parafolësin e tij sqaroi se corona-virusi nuk ka qenë sëmundje e panjohur sepse në të gjitha provimet e mikrobiologjisë familjen e corona-virusve e ke temë të shpjeguar kaheër. Pandemia ka shpërthyer me 31 dhjetor 2019 në Wuhan të Kinës, nuk ka qenë aktive, por virusi nuk është se ka qenë i panjohur. Masat e ndërmarra janë njohur në gjithë botën prej OBSH-së, e deri tek IKSHPK-ja dhe kjo varet se a i kemi bërë apdate, ky është qëllimi. Më tej shtoi se në QKMF, kemi kuadër që ka një shkollim solid, dhe që si staf kanë bërë punë të jashtëzakonshme dhe për këtë iu njeht meritat, por e vërteta është se informata e ofruar në kuvend nuk është e dinjitetshme për ta prezantuar institucionin dhe për të adresuar punën e madhe që është kryer sepse kjo informatë nuk i plotëson as standardet minimale të një dokumenti për informim dhe raportim sepse ka defekte të mëdha në aspektin drejtshkrimor dhe logjik të fjalës. Mandej nuk morëm përgjigje për çështjen më të ndërlikuar që është inkorporuar në informatë siç është shpallja e identitetit të banorëve në shtëpinë rezidenciale në fshatin Lumadh, që është një shkelje flagrante e drejtave fundamentale të njeriut dhe shkelje e etikës mjekësore.

Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHPS-së - tha se është obligim ligjor të raportohet para kuvendit, dhe sqaroi se informata në fjalë është e vitit 2021 kur ai nuk ka qenë i ngarkuar me përgjegjësinë e drejtorit. Në të ardhmen ai do ofrojë informata më të kompletuara duke bashkëpunuar edhe me lektoren e komunës. Informata është hartuar nga një grup zyrtarësh nga sektorë të ndryshëm dhe këtë gjendje e ka trashëguar, nga punëtorët që i ka vendosur Sylejman Mehulli.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – njoftoi se asnjë zyrtar i lartë nuk është shkarkuar nga ana e tij, duke u ndikuar nga bazat politike apo partiake, ata që kanë qenë në pozita udhëheqëse kanë vazhduar në kryerjen e punëve të tyre. Shkarkimi i drejtoreshës së QPS nga ish - kryetari i komunës ka qenë i padrejtë, dhe ai e ka mbrojtur duke e shtyrë të ushtrojë ankesë në Këshillën e Pavarur Mbikëqyrës dhe e njëjta është kthyer në vendin e punës ku ka qenë. Shefja e shtëpisë Rezidenciale është emëruar pasi që drejtori është pensionuar, dhe emërimi nuk ka ndodhur në kohën e tij. Stafi dhe drejtoresha e QKMF-së, ka mbetur po ajo dhe e kanë pasur mbështetjen e plotë për gjitha punët e mira që janë kryer.

Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHPS-së - sqaroi se ai ka qenë diskriminuar në kohën e ish-drejtorit. Tutje shtoi se si rezultat i burokracisë në procedurat e prokurimit, ka pasuar një gjendje jo e mirë e furnizimit me materiale shpenzuese siç janë reagensat, dhe kjo ka bërë që të furnizohemi përmes një donatori.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - tha se çdo kritikë me vend është e mirëseardhur dhe ndikon pozitivisht në përmirësimin e gjendjes. Tutje shtoi se kërkon falje për ata që e kanë lexuar se

informata për shërbimet shëndetësore nuk është e plotësuar, e njëjta ka nevojë të plotësohet, të jetë e qartë dhe të ketë një vijë akademike. Kjo informatë duhet të shkruhet në kohën e kryer sepse ka ndodhur në kohën e kaluar e jo në kohën e tashme, mandej citoi: jemi në përpjekje që si menaxhment që nga fillimi i vitit 2021 në bashkëpunim me DSHKP-së dhe IRSHPK-në dhe kemi njoftime zyrtare se duhet të jemi gati për përballje me virusin covid-19, d.m.th është e paqartë, dhe kërkoi nga drejtoria kompetente që herëve tjera të kemi një informatë të kompletuar si në aspektin drejtshkrimor ashtu edhe në atë përmbajtësor. Më tej apeloj tek këshilltarët e tij që t'i pranojnë me pozitivitet kritikën nga anëtarët e kuvendit pasi që ato ndikojnë në përmirësimin e punëve dhe gjendjes në përgjithësi.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – përsëriti se nuk ka personale asgjë dhe me askënd, dhe shtoi se për krejt dështimet që kanë ndodhur gjatë vitit 2021 që nga suficiti në projektet kapitale e deri tek rënia e parametrave dhe numri i analizave në laborator nuk mund t'i adresohen në përgjegjësi drejtorit aktual të shëndetësisë, mirëpo ai përsëriti se kritika e tij ishte e adresuar në aspektin e informatës dhe përmbajtjes së saj.

5. Propozim – vendim për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina, për familjet përfituese të asistencës sociale

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së - propozoi që në kuadër të këtyre lirimeve nga pagesa të futen edhe punëtorët e operativës-terrenit të Ndërmarrjes regjionale “Uniteti” njësia në Vushtri, ndërsa shuma totale e mjeteve financiare e kufizimit të buxhetit nga ky vendim pa i përfshirë punëtorët e kompanisë “Uniteti” është 74,000.00 €.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit - tha se për këtë propozim-vendim nuk është dhënë një arsytim i plotës, për faktin se nuk është sqaruar se sa është numri i familjeve që do të përfitojnë nga lirimi nga këto taksa, si dhe sa do të jetë kostoja financiare që komuna nuk do t'i inkasojë nga ky vendim apo thënë më ndryshe sa është shuma totale e të hyrave me të cilat do të dëmtohet buxheti i komunës.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LVV-së deklaroi se e mbështesin këtë propozim-vendim.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – tha se grupi kuvendar i LDK-së e mbështesin një praktikë të tillë dhe vota e tyre do të jetë pro.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, familjet me asistencë sociale, familjet e punëtorëve të operativës-terrenit të Ndërmarrjes “Uniteti”, njësia në Vushtri, në Komunën e Vushtrisë.

2. Vendimi për lirimin nga obligimi i pagesës së taksës për shërbimet e mbeturinave bëhet si rezultat i rëndimit të gjendjes sociale të familjeve që përfitojnë nga skema sociale dhe atyre të punëtorëve të Ndërmarrjes “Uniteti”, njësia në Vushtri, si pasojë e pandemisë covid-19, e njohur si Corona-virus.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe fillon të prodhojë efekt juridik nga data 1 janar 2022 deri më datë 31 dhjetor 2022.

6. Shqyrtimi i Propozim – vendim për ndarjen e subvencioneve

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit - tha se në propozim-vendim është lëshuar një gabim teknik ku në vend të vitit 2022 ceket viti 2020, këto gabime duhet të evitohen nga dokumentet zyrtare, ndërsa pyeti drejtoreshën e kulturës ku ceket se tek subvencionimi i OJQ-ve shuma totale është 74,000.00 €, kurse në mbledhjen e kaluar kur është aprovuar buxheti ka ekzistuar një propozim për ndarjen e një shume financiare prej 100,000.00 € për Klubin e futbollit “Vushtrria”, kjo për nder të 100 vjetorit të themelimit të këtij klubi, ky propozim është aprovuar nga kuvendi i komunës, por që nuk është inkorporuar në subvencione tek OJQ-të.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – tha se këtë propozim-vendim e kemi mbështetur edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa duke shprehur një fleksibilitet në shtyllat e caktuara të subvencioneve, sepse e kemi mirëkuptuar nevojën për të mos bërë planifikim të shpejtë, por ka ndryshuar dy herë gjatë procesit dhe kjo ka bërë që mos të kemi një hapësirë të duhur për ta analizuar këtë çështje. Megjithatë ai shpreson që qeveria komunale e ka bërë orientimin më të mirë të mundshëm dhe vota e tyre do të jetë pro për faktin se nga ky vendim adresohen dhe financohen nevojat për bursat e studentëve, për OJQ-të, klubet e sportit, persona që vuajnë nga sëmundjet e ndryshme e të ngjashme. Por nuk e di nëse kalkulimi i këtyre shumave është bërë si duhet p.sh pozicioni Kompensimi për fëmijët e porsalindur dhe rastet me Covid-19. 47,540.00 €, për këtë nuk ka siguri që kjo shumë është e mjaftueshme për të mbuluar koston financiare të këtij vendimi, sepse në vitin kur është marrë ky vendim kemi pasur mbi 800 lindje dhe bazuar në këtë $800 \times 120 = 96,000.00$ €, ndërsa në propozim ne i kemi 47,540.00 € për fëmijët e porsalindur dhe për rastet me covid-19, andaj kjo shumë është e pamjaftueshme për ta mbuluar koston e vendimit sa i përket këtij pozicioni. Andaj në këtë kontekst duhet pasur kujdes që mos të futet në borxhe komuna dhe të vijmë deri tek situata kur nuk do të mund t'i realizojmë këto subvencione. Pastaj tek pjesa Financimi i OJQ-ve përfshirë shoqatat e luftës së UÇK-së, vlera financiare 27,000.00 €, konsideron se nuk është e mjaftueshme sidomos duke e ditur faktin se në këtë pako buxhetore subvencionohet edhe HANDIKOSI dhe zakonisht e merr gjysmën e këtyre mjeteve financiare, kështu shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe shoqatave tjera nga lëmi i shëndetësisë ju mbetet pak buxhet, andaj duhet të shikohet mundësia që ky pozicion buxhetor të rritet. Subvencionimi në bujqësi më parë ka qenë i specifikuar në kode dhe projekte se si do të ndahen subvencionet, tani kemi një pako si total, por është interes të njoftohet kuvendi se cilat projekte do të mbështet-subvencionohen në këtë vit çfarë natyre do të kenë ato projekte dhe cili do të jetë impakti i tyre. Tek Drejtoria e Arsimit, pozicioni Shpërblime për nxënës, 6,500.00 €, kërkoi të dihet se për cilat shpërblime bëhet fjalë dhe çfarë kriteri do të përdoret në ndarjen e këtyre mjeteve. Në fund tha se edhe përkundër faktit se mungon fondi për subvencionimin e klubit të futbollit në vlerën prej 100,000.00 €, ata prapëseprapë nuk do ta bllokojnë këtë vendim pasi që nga ky varen shumë skema të rëndësishme komunale që kanë nevojë imediate të subvencionohen.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – shtroi çështjen lidhur me pozicionin Bashkëfinancim me donatorë për banim për familjet pa strehë në vlerë prej 10,000.00 €, ndërsa në mandatin e kaluar është vendosur të ndahen 5,000.00 € për ndërtimin e një shtëpie, dhe për ndërtimin e 20 shtëpive ishin ndarë 100,000.00 €, ndërsa shuma aktuale prej 10,000.00 € nuk është e mjaftueshme sepse

më këtë do të mund të ndërtohen vetëm dy shtëpi. Andaj propozoi që brenda mundësive financiare të rritet ky fond sepse kemi shumë familje që kanë problem të banimit.

Remzi Ahmeti, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime në linja të përgjithshme, duke cekur se shuma totale e subvencioneve duhet të jetë e përmirësuar 657,540.00 €, ndërsa pjesa e vakumit financiar sa i përket subvencioneve mendohet të përmbushet nga të hyrat e bartura.

Medina Bunjaku, drejtoreshë e DKRS-së - sqaroi se totali i subvencioneve në Drejtorinë e Kulturës, do të jetë 90,000.00 €, ndërsa pjesa prej 30,000.00 € do të plotësohet nga të hyrat e bartura, varësisht prej kërkesave ekuivalente që do të kemi. Sa i përket subvencionimit të klubit të futbollit nga takimet që kanë pasur ka shumë donatorë që janë paraqitur për t'i dalë në ndihmë klubit, duke u bazuar në Ligjin për Sponsorizim në kuotën e 30 %.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - sqaroi se korniza apo tavani i subvencioneve për vitin 2022 është 657,540.00 €, dhe jashtë kësaj kornize buxhetore mund të dilet, mund të kemi lëvizje, por vetëm brenda kësaj shume duke ndryshuar pozicionet e caktuara. Pastaj shtoi se subvencionet në bujqësi janë planifikuar si shumë totale, kjo për faktin se ai ka zhvilluar takime të ndryshme me bujqit, bletarët, pemëtarët dhe kategoritë tjera, dhe i ka marrë kërkesat nga ta, kështu që subvencionet do të shpërndahen konform këtyre kërkesave. Blegtorët janë në krizë dhe ata njëzëri kanë kërkuar subvencionim të qumështit. Andaj ideja është që të përfitojnë të gjithë dhe atë konform sasisë së qumështit që prezantojnë, por nëse ka kërkesa do të subvencionohet edhe ujitja e tokave. Pjesa e mjeteve e propozuar nga anëtarja e kuvendit nga LVV-ja, në vlerë prej 30,000.00 € do të plotësohet prej të hyrave të bartura. Nga takimet që ka pasur me bizneset ka marrë zotime se 30% të fitimit të tyre do të mund ta dedikojnë për financimin e nevojave të klubit të futbollit.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit - tha se shuma e subvencioneve në DKRS, është dashur të jetë ashtu siç ishte votuar në mbledhjen e kaluar në vlerën prej 120,000.00 €, dhe jo tani të arsyetojmë se shuma prej 30,000.00 € do të plotësohet prej të hyrave të bartura. Gjithashtu kërkoi që të respektohet vendimi me të cilin është licencuar Qendra rinore, sa i përket shfrytëzimit të atij objekti.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës - sqaroi se kur është aprovuar buxheti i komunës për vitin 2022, limiti i subvencioneve në bazë të qarkoreve buxhetore të Ministrisë së Financave ka qenë 657,540.00 €, dhe përkundër vullnetit të mirë për t'i rritur subvencionet, nuk mund të dalim jashtë këtyre limiteve të përcaktuara nga niveli qendror. Sa i përket mundësisë së rritjes së këtyre fondeve qoftë për fëmijët e porsalindur apo tek kategoritë tjera kjo mbetet vetëm përmes të hyrave të bartura.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – tha se i kuptojnë mirë limitet buxhetore dhe mundësitë financiare të komunës, por në mbledhjen e kaluar kur është aprovuar buxheti i komunës, kanë qenë të inkuorporuar propozimet e anëtarëve të kuvendit siç ishte ai për klubin e futbollit dhe propozimet tjera të cilat nuk figurojnë se janë inkuorporuar në buxhet.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - përsëriti se brenda totalit të subvencioneve mund të barten mjetet për klubin në vlerë prej 100,000.00 €, por sigurisht se do të mbeten keq kategoritë tjera, dhe sqaroi se mundësia e vetme për rritjen e subvencioneve është përmes të hyrave të bartura.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – tha se që dy apo tri herë grupi kuvendar i LVV-së që ai e përfaqëson ka treguar konstruktivitet kur kanë votuar shuma totale të projekteve, por për këto më vonë do të shihet se sa janë transparentë qeverisja komunale, sikur është rasti me projektet kapitale në hartimin e listës së rrugëve që do të asfaltohen dhe në ndarjen e mjeteve për subvencione në lëmin e bujqësisë.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - u zotua para kuvendit se do të jetë plotësisht transparent sa i përket shpenzimit të parasë publike dhe orientimit të projekteve kapitale.

Mek Selaci, anëtar i kuvendit – tha se propozimi i tij prej 100,000.00 € për klubin e futbollit ka qenë i qëlluar, por të gjithë qytetarët nuk kishin besuar se ky propozim do të jetësohet, dhe atij i vjen shumë keq që ata kanë pasur të drejtë, sepse vetëm është shfrytëzuar vota e tij për aprovimin e buxhetit.

Mentor Hasani, anëtar i kuvendit – propozoi që shuma e subvencioneve për një fëmijë të porsalindur të bëhet 140 €.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 32 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Mjetet financiare të buxhetit të komunës – subvencione dhe transfere të vitit 2022 në shumë të përgjithshme prej 657,540.00 €, shpërndahen sipas drejtorive/sectorëve, zyrave) të cekura si më poshtë:

1.1 Zyra e Kryetarit:

Subvencione për raste veçanta (fatkeqësi natyrore etj.)40,000.00 €

1.2 Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale:

1.2.1 Marrëveshja me Islamic Relief (vizita mjekësore në shtëpi)....100.000.00 €

1.2.2 Ndihmë për strehim – (qiratë e banimit).....20,000.00 €

1.2.3 Ndihmë për shërim.....28,000.00 €

1.2.4 Ndihmë financiare apo artikuj ushqimor për familjet skamnore.10,000.00 €

1.2.5 Financimi i OJQ-ve përfshirë shoqatat e luftës së UÇK-së.....27,000.00 €

1.2.6 Bashkëfinancim me donatorë për banim për familjet pa strehë..10,000.00 €

1.2.7 Marrëveshja për bashkëfinancim me Shoqatën “J. e Ballkanit...20,000.00 €

1.2.8 Kompensimi për fëmijët e porsalindur dhe rastet me Covid-19.47,540.00 €

Gjithsej.....262.540.00 €

1.3 Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Subvencione në bujqësi..... 200,000.00 €.

1.4 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:

1.4.1 Botimi i librave dhe publikimeve6,000.00 €

1.4.2 Financimi i OJQ-ve..... 74,000.00 €

1.4.3 Teatri i qytetit..... 10,000.00 €

Gjithsej.....90,000.00 €

1.5 Drejtoria për Arsim

1.5.1	Bursa për studentë.....	27,000.00 €
1.5.2	Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta.....	20,000.00 €
1.5.3	Transporti i fëmijëve të familjeve me kushte të rënda sociale.....	1,500.00 €
1.5.4	Shpërblime për nxënës.....	6,500.00 €
1.5.5	Bursa për nxënësit e klasave të 10-ta, drejtimi përpunues i drurit dhe metalpunues.....	5,000.00 €
	Gjithsej.....	60,000.00 €

1.6 Zyra Lokale e komuniteteve (për riintegrim të personave të riatdhesuar – për subvencionim të qirasë së tyre)..... 5,000.00 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Arsim, Zyra e Kryetarit të komunës dhe Zyra lokale e komuniteteve.

3. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e nismës, për identifikimin e shtëpive – shkolla (themelimi i komisionit)

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LDK-së, propozoi Shkelzen Xhaferin për anëtar të komisionit për identifikimin e shtëpive – shkolla.

Mek Selaci, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LVV-së, propozoi Refik Malokun për anëtar të komisionit për identifikimin e shtëpive – shkolla.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - kërkoi që të gjitha shtëpitë-shkolla të identifikohen, dhe në të gjitha ato objektet të vendoset nga një pllakë më shkrim identifikues që ato shtëpi janë shfrytëzuar për procesin mësimor apo shtëpi-shkollë në vitet e sistemit paralel të arsimit.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 32 vota “për” 1 votë “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim themelohet grupi për identifikimin dhe vlerësimin e “Shtëpi-shkollave” në Komunën e Vushtrrisë, në përbërjen si në vijim:

- 1.1 Galip Avdiu, kryesues i grupit vlerësues PDK;
- 1.2 Shkelzen Xhaferi, anëtar i kuvendit LDK;
- 1.3 Refik Maloku, anëtar i kuvendit LVV;
- 1.4 Bedri Tahiri, anëtar;
- 1.5 Fahri Pllana anëtar.

2. Grupi identifikues-vlerësues në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të bëjë identifikimin e “Shtëpi-shkollave” në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë.
3. Grupi identifikues-vlerësues ka për obligim që brenda një afati të caktuar kohor të informojë Kryetarin e komunës dhe kuvendin për të gjeturat në terren.
4. Grupi në koordinim me Kryetarin e komunës do të përcaktohen për formatin dhe shkrimin e pllakës që do të vendoset në shtëpi-shkolla.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe Zyra e kryetarit të komunës.
6. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
8. Shqyrtimi i rekomandimit për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të kuvendit me Nr. protokolli 01Nr.125/14 i datës 28.5.2014, apo shkëputjes së kontratave për dhënien në shfrytëzim të kioskave

Albanez Tahiraj, drejtor i DGJKP-së - njoftoi kuvendin se lidhur me këtë çështje është ngritur një komision nga kryetari i komunës, që ka pasur për detyrë mbikëqyrjen e shfrytëzimit të këtyre pronave (kisosqeve), konform kontratave të lidhura mes komunës dhe palëve tjera kontraktuese. Komisioni në fjalë ka bërë një raport të detajuar, ku ndër të tjera ka konstatuar se disa prej këtyre lokaleve nuk janë duke u shfrytëzuar sipas kontratës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se është mirë që po bëhet verifikimi i dhënies së pronës në shfrytëzim se a janë duke u shfrytëzuar pronat komunale sipas destinimi të tyre, dhe kërkoi të sqarohet se ky proces a ka pasur një projekt-menaxher dhe se i njëjti a ka paraqitur vërejtje me shkrim se nuk ka pasur respektim të kontratës. Më tej ai vlerësoi se nëse kemi mosrespektim të kontratës, atëherë duhet të shkëputen këto kontrata, por ceku se do të jetë e vështirë të hapet procedura e sërishme e ankandit, pasi që me një nga nenet e kontratës thuhet se investimet në ato objekte i bartë investitori, dhe në rastin konkret komuna do ta ketë vështirë të gjejë modalitet për kthimin e atyre investimeve.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – tha se kuvendi i komunës vendos për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, ndërsa për më pak se një vit vendos kryetari i komunës. Ajo që duhet kuptuar është se kuvendi nuk vendos për shkëputjen e kontratës dhe për këtë arsye ai nuk e di se përse ka pasur nevojë që ky material të silllet në kuvend.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – tha se ky material duhet të analizohet mirë të hiqen të gjitha dilemat ligjore dhe më pas është dashur të silllet në kuvend për aprovim, andaj propozoi që kjo pikë e rendit të ditë të shtyhet për ndonjë nga mbledhjet e radhës pasi të jepen të gjitha sqarimet e duhura juridike.

Albanez Tahiraj, drejtor i DGJKP-së - sqaroi se kryesuesi i komisionit është projekt-menaxher, ndërsa sa i përket kompensimit të investimeve në ato prona-objekte, në njërin nga nenet e kontratës specifikohet se nëse kontrata shkëputet para kohës, atëherë kompensimin e pjesës së mbetur të investimeve e bënë komuna në saje të një ekspertize të pavarur. Lidhur me dilemat ligjore ai sqaroi se të gjitha argumentet juridike janë prezantuar, se kemi të bëjmë me një material të kompletuar juridikisht dhe se këto kontrata duhet të shkëputen sepse janë shkelur kushte që dalin nga to.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për ndonjëherë nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit, pasi të merret mendimi dhe të bëhet një analizë e mirëfilltë.

Në fund të debatit, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për ndonjëherë nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit.

9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.24/22, dt. 31.1.2022, përkatësisht paragrafi 1, pika 1.4 ashtu që në vend të, **Maliq Ferizit**, drejtor për mbrojtje dhe shpëtim, zëvendësohet nga **Bajram Beqiri**, zyrtar në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Vushtrri.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: menaxheri i personelit dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

3. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër të prodhuesve vendorë në Komunën e Vushtrrisë

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se grupi kuvendar i LVV-së e përkrah fuqishëm këtë pikë të rendit të ditës dhe pyeti se cila do të jetë dinamika e këtij projekti, dhe kur do të mund të shohim vendosjen e shitësve në atë treg. Pastaj ajo shtoi se i vjen mirë që kryetari aktual i komunës ka marrë për bazë zotimin e LVV-së në Vushtrri për ndërtimin e tregut për këta shitës që po shesin produktet e tyre në rrugë këtu afër objektit të komunës. Parcela e propozuar do të jetë një vend ideal për vendosjen e tregut të gjelbër, sepse është në qendër të qytetit dhe do të jetë shumë i qashtë për qytetarët të cilët do të mund të blejnë produktet që ju nevojiten shpejt dhe shpesh, por pozitive do të jetë edhe për shitësit se do t'i plasojnë produktet e tyre në një vend adekuat dhe kështu do t'u rritet edhe puna apo qarkullimi i tyre. Në fund ritheksoi dhe vlerësoi lart mosinjorimin dhe gatishmërinë e kryetarit të komunës për të realizuar një ide që ka herë ka qenë e LVV-së në Vushtrri dhe po ashtu është në interesin e përgjithshëm qytetar.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – tha se si projekt dhe si lokalitet është i përshtatshëm për ndërtimin e tregut të gjelbër, dhe si grup i LDK-së e përkrahin, por nëse ky treg ndërtohet nga fondet që dalin nga memorandumi i bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief atëherë ata nuk do ta votojnë këtë pikë të rendit të ditës. Kjo është kështu sepse ata në fushatë zgjedhore kanë marrë obligime se do të ndërtohet ai treg atje dhe atyre njerëzve do t'u krijohen kushte më të mira të punës, me një treg modern që i plotëson kushtet. Pastaj njoftoi se nga memorandumi me Islamic Relief janë akorduar 400,000.00 US\$ dhe aty do të bëhej një treg

modern, ndërsa lokacioni aktual në hapësirë prej 16 ari është tepër i pamjaftueshëm për një treg, çfarë është menduar të ndërtohet sipas idesë së tyre.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se për projekte të tilla ka qenë praktikë që të propozohen të paktën dy lokacione, ashtu që të hapet debati dhe të gjendet lokacioni dhe zgjidhja më e mirë e mundshme. Sido që të jetë konsideron se propozimi është i qëlluar, mirëpo këtu paraqitet se janë 1637 m² dhe nëse orientohemi në ortofoto del se minarja e Xhamisë është në këtë parcelë, dhe për këtë nuk e di se kompetentët a janë dal në terren për ta konstatuar këtë çështje. Lidhur me këtë ai vlerëson se kishte me qenë mirë që të evidentohet dhe definohet prona apo pjesët e parcelës të cilat do të mund të shfrytëzohen, kjo për faktin se përreth kemi shtëpi, lokale afariste dhe objekte tjera, të cilat do të mund të pengoheshin në qasje. Mbi bazën e kësaj sipas një llogarie të bërë nga ana e tij, del se në atë pronë do të mund të shfrytëzoheshin 6 deri në 7 ari por jo më tepër të sipërfaqes së parcelës. Në këtë propozim-vendim është evidentuar parcela 655, por fare nuk është inkorporuar në propozim-vendim parcela 654 e cila ka sipërfaqe prej më tepër se 1 ari në mes të pronës kah rruga “Hasan Prishtina”. Këtu është dashur të inkorporohet edhe kjo parcelë pasi që është pjesë e këtij propozim-projekti. Lidhur me të gjitha këto ai ftoi të gjithë që ta votojnë këtë pikë por me plotësimet e propozuara, dhe në këtë kontekst vlerësoi se kishte me qenë mirë që bëhej një paramasë paraprake që të dihet saktë e drejta e disponimit në shfrytëzimin e asaj prone. Në fund propozoi që në vendim të inkorporohet edhe pjesa e parcelës 654.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - tha se e rëndësishme është që po diskutohet për një projekt i cili ka rëndësinë për të gjithë qytetarët. Pastaj shtoi se do të ndërtohet një treg i përmasave jo të mëdha, ndërsa në të ardhmen do ta ndërtojmë edhe një treg të madh, kur komuna do të ketë mundësi financiare dhe konform kërkesave qytetare. Ideja e këtij projekti është që shitësit që po shesin produktet e tyre tek objektit i shtëpisë së mallrave, të hiqen nga rruga dhe të vendosen në atë lokacion, sepse nëse e marrim proporcionin e numrit të atyre shitësve do të jetë konform atij lokacioni, dhe terreni i lokacionit është adekuat sepse kemi qasje nga të dyja anët e rrugëve si nga ana epërme ashtu edhe ana e poshtme. Nëse ky projekt votohet sot, mendohet që të ndërtohet gjatë këtij viti, dhe më pas është menduar të nxirret një rregullore për menaxhimin e këtij tregu. Lidhur me këtë projekt njoftoi se i ka ftuar arkitektët e komunës dhe i ka pyetur se a mundet një lokacion i tillë të jetë adekuat dhe ka marrë konfirmim pozitiv. Ky projekt mendohet të realizohet përmes një konkursi publik që të kemi konkurrencë në idenë më të mirë në përzgjedhjen e projektit. Në fund lidhur me financimin e këtij projekti njoftoi se do të kërkojnë donatorë, dhe mendohet se kostoja financiare do të jetë 600-700 mijë euro, ndërsa njoftoi se donatori që kishte qenë më herët për ndërtimin e tregut të madh është deklaruar se është i dëshpëruar sepse prona ku është menduar të ndërtohet nuk gjendet në pronësi komunale.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - pyeti se për shitësit që do të vendosen në atë treg a do të aplikohen taksa?

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës - tha se hapi i dytë për realizimin e këtij projekti do të jetë hartimi i një rregulloreje për menaxhimin e këtij tregu dhe me këtë rregullore do të vendoset se dëshirojmë të vendosim taksa për shitësit apo jo.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit - tha se e mbështesin këtë projekt, sepse këtyre shitësve ka herë iu është premtuar se do t’u gjendet një zgjidhje. Mirëpo për këta shitës ekziston një listë me emrat e tyre dhe ajo listë duhet të merret për bazë që ata shitës të kenë prioritet gjatë vendosjes në atë treg.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 26 vota “për” 6 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri, në parcelën kadastrale P-70202016-00655-0, në sipërfaqe prej 1637 m², Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora: 15:30

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVË



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 5 MARS 2022 PËR NDER TË EPOPESË SË UÇK-së

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 09:05.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, Kryetari i komunës z.Ferit Idrizi, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësues të subjekteve politike në Vushtrri, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtarë tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë ka kuorum të mjaftueshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Në fillim të mbledhjes u intonua himni kombëtar dhe ai shtetëror i Kosovës, në nderim të jetës dhe veprës së Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe Epopesë së UÇK-së.

Më pas kuvendi me një minutë heshtje nderoi jetën dhe veprën e Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe gjithë të rënëve për liri.

Melihate Basholli-Latifi – kryesuese e kuvendit- I nderuari Kryetar i komunës, z. Ferit Idrizi;

I nderuari nënkryetar i komunës, z. Shpëtim Zhegrova;

Të nderuar drejtorë të drejtorive;

Të nderuar anëtarë të kuvendit;

Të çmuar familjarë të dëshmorëve, të veteranëve, të invalidëve, të martirëve e të rënëve për liri;

Të nderuar përfaqësues të organizatave të dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

Të nderuar përfaqësues të partive politike;

Të nderuar përfaqësues të FSK-së, KFOR-it, të policisë së Kosovës;

Të nderuar përfaqësues të mediave, të shoqërisë civile dhe ju të pranishëm;

Zonja dhe zotërinj;

Shumë të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë.

Jam jashtëzakonisht e nderuar dhe e privilegjuar që sot të shpall të hapur këtë seancë solemne kushtuar Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari, dëshmorëve, martirëve dhe të rënëve për liri. Në çdo përvjetor të datave 5, 6 e 7 mars, ne përkujtojmë sakrificën sublime, vetëflijuese e unike të familjes Jashari, kujtojmë e nderojmë luftën për çlirim dhe rënien heroike të kryekomandantit tonë legjendar Adem Jashari, përkujtojmë dëshmorët, martirët e të rënë për liri. Kujtojmë e nderojmë luftën e shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; kujtojmë e nderojmë veteranët e invalidët e luftës; kujtojmë e nderojmë të burgosurit politik; kujtojmë dhe nderojmë viktimat civile, sakrificën e popullit,

sakrificën e secilit që punoi e kontribuoi për çlirimin dhe shtetndërtimin e vendit. Të nderuar të pranishëm, derisa sot kujtojmë se sa e gjatë, sa sfiduese e sa e mundimshme, por edhe me plot krenari, ka qenë rruga për çlirim, për liri e për pavarësi, duhet të mos harrojmë se ne duhet të jemi të bashkuar e të përkushtuar që të jetësojmë synimin e më të mirëve tanë ndër breza. Sa herë i kujtojmë ata, ne rivlerësojmë se sa e shenjtë e sa e rëndësishme është liria dhe bashkohemi më shumë se kurrë për realizimin e idealeve tona, gjegjësisht idealeve të dëshmorëve tanë. Qoftë i përjetshëm nderimi e kujtimi për Kryekomandantin Legjendar Adem Jashari dhe familjen e tij! Qoftë i përjetshëm nderimi e kujtimi për dëshmorët, martirët e të rënët për këtë vend brez pas brezi! Qofshim ne ata që realizojmë ëndrrën shekullore kombëtare! Ju faleminderit për vëmendje!

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë—në fillim të diskutimit të tij përshëndeti gjithë të pranishmit:

Të nderuara familje të dëshmorëve;

Të nderuara familje të martirëve;

Të nderur ish të burgosur politik;

Të nderuara shoqata emblematike të dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë;

Të nderuar përfaqësues të subjekteve politike në Vushtri;

I nderuar nënkryetar i komunës, kryesuese e kuvendit, drejtor të drejtorive komunale, gjithë ju të pranishëm;

Të dashur qytetarë të Komunës së Vushtrrisë.

Sot është një ditë e veçantë edhe për nga dimensionin historik, edhe për nga festa e madhe historike, por edhe për nga lavdia që nuk ka penë e as shkrim që mund t'i thurë lavditë dhe ta përshkruajë në detaje këtë ditë të madhe. Është epopeja e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është fillimi i një epoke të re, është fillimi i një dekade të re, është lufta çlirimtare e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, është qëndresa heroike e familje Jashari, është lufta unike për liri dhe pavarësi kombëtare, është lufta e cila kulmoi me involvimin e faktorit ndërkombëtar, është lufta që bëri botën demokratike dhe faktorin ndërkombëtar, të kthejnë kokën kah shqiptarët e Kosovës që luftuan gjatë për liri dhe pavarësi që kur u nda Shqipëria në vitin 1913 dhe u futën forcat serbe në këto territore. Lufta jonë ka vazhduar përgjatë gjithë historisë me sakrificën më sublime në vitin 1918-1924, për të vazhduar në vitin 1945, sakrificat në demonstratat e vitit 1968, 1981, greva e minatorëve e vitit 1989, rezistenca paqësore e viteve 90 –ta, që kulmoi me daljen në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me 28 nëntor 1997 dhe në fund sakrificat sublime e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij dhe deri në atë kohë faktori ndërkombëtar i shikonte karshi proceset që po zhvilloheshin në trojet shqiptare, veçanërisht në Kosovën e okupuar të gjakosur e të robëruar nga okupatori serb. Por Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij i aktivizoi mekanizmat ndërkombëtarë dhe ishte vetë ambasadori amerikan ai i cili kishte dhënë një deklaratë ndryshe për Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishte i pari Robert Gelbard që i shprehu ngushëllime familjes Jashari dhe ishte diplomacia ndërkombëtare e cila iu kthye fuqishëm në mbështetje popullit shqiptar në mbështetje të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kjo shënon kthesën nga një luftë guerile në një luftë frontale të përmasave kombëtare ku u thirr edhe mobilizimi i përgjithshëm. Ishte kjo koha më e lavdishme, por pa armatim të mjaftueshëm për të gjithë ata vullnetarë dhe vullnetare të cilët prisnin në rresht për të ngjitur Bjeshkëve të Nemura për ta kaluar kufirin Kosovë-Shqipëri, për të arritur deri në Tropojë për t'u armatosur dhe për t'ju bashkëngjitur luftës çlirimtare. Prandaj sot në këtë ditë të shenjtë në epopenë e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe rënien heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, sot

shënojmë epopenë e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sot flamujt valojnë lirshëm në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjithçka që ndodhi gjatë historisë sonë kulmoi me lirinë dhe pavarësinë e Kosovës e cila për 100 vjet ishte e okupuar nga barbarët serbë. Andaj ne të gjallët jemi të privilegjuar, ne të gjallët jemi me fat që e pritëm këtë ditë dhe e festojmë këtë ditë në mënyrën më të mirë në vendin tonë në institucionet tona, të bashkuar i gjithë spektri politik i Kosovës, bashkë me shoqatat e dala nga lufta dhe me familjet e dëshmorëve, bashkë me veteranët dhe invalidët e UÇK-së, ata që i lanë gjymtyrët e tyre në betejat e luftës vetëm e vetëm për t'ia sjellë lirinë Kosovës. Në fund ai apeloj për të gjithë që në ditë festive të këtyre datave të gjithë të jemi të bashkuar, sepse të gjithë jemi hisedar të këtyre festave, të bashkohemi rreth sakrificës së Komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse emblema e UÇK-së është vula e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Lavdi e nderim jetës dhe veprës të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij dhe gjithë dëshmorëve të kombit respekt!

Gëzim Zuçaku, kryetar i Shoqatës të Familjeve të Dëshmorëve - në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit pasi përshëndeti gjithë të pranishmit, tha se sot, me krenari kujtojmë ditët e Epopesë së UÇK-së: 5, 6 dhe 7 marsin e 1998 – ë. Me krenari kujtojmë luftën e Komandantit Legjendar Adem Jasharit. Me krenari kujtojmë sakrificën e madhe të Jasharëve legjendarë. Nuk ka përkufizim gjuhësor, historik dhe filozofik që kap përmasat e kësaj sakrifice. Kjo Epope mori përmasat e ngjarjeve të krijimit të botës së re në hapësirat gjeografike shqiptare, të ndërrimit të epokës së robërisë nga epoka e lirisë. Në ditët e Epopesë së UÇK-së u sprovuan vlerat më të larta të kombit: trimëria, besnikëria dhe shpirti heroik. Përmasa e flijimit historik mori dimensione legjendare. Ato ditë heroike nuk u bënë gërmadha kullat e Jasharëve., në të vërtetë, gërmadhë u bë sundimi serb në Kosovë. Gurët e kullave të Jasharëve u bënë gurë të piramidave kufitare të shtetit të Kosovës. Prandaj kjo sakrificë legjendare për liri u bë model unikat në historinë kombëtare dhe botërore. Njerëzit shpirtmëdhën jo vetëm prekën historinë, por i dhanë trajtë asaj. Dhe çmimi ishte i lartë, por, faqja e historisë u bë shumë e ndritshme. Me luftën dhe rënien e tyre UÇK-ja u rrit në përmasa gjithëkombëtare, diplomacia botërore u vu në anën e luftës së drejtë të shqiptarëve. Me të drejtë, në analet e historisë moderne botërore, Ushtria Çlirimtare e Kosovës vlerësohet si projekti më i suksesshëm politik-ushtarak. Vizioni politik i UÇK-së krijoi parakushtet për intervenimin e Aleancës më të fuqishme ushtarake në interes të vendit tonë. Në këto ditë të shënuara ndjejmë dhimbje të madhe sepse krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe komandantët e saj gjenden padrejtësisht në Tribunin e Hagës, sepse në këtë rast nuk akuzohet individi, por akuzohet lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këto përmasa që po zhvillohet rendi i ri ndërkombëtar, besojmë dhe shpresojmë se do ta kuptojnë se Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e drejtë dhe e saktë dhe se ne nuk ishim agresorë, por ishim viktimë, ne shpresojmë që krerët e UÇK-së shumë shpejt të lirohen dhe të kthehen fitimtar në Kosovë. Lavdi Komandantit Legjendar Adem Jashari, lavdi gjithë Dëshmorëve të kombit, nder dhe respekt për gjithë invalidët dhe veteranët e UÇK-së, urime Epoja e UÇK-së, Zoti e Bekoftë Republikën e Kosovës dhe popullin e saj.

Mbledhja përfundoi në ora: 09:25

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



RAPORT
PËR SITUATËN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE
INVESTUESE DHE I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS – EKZEKUTIVIT
PËR VITIN 2021

Mars, 2022

Hyrje

Raporti për situatën ekonomike financiare dhe zbatimin e planeve investuese është i bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe Planin e Punës për vitin 2021. Në këtë raport është paraqitë puna dhe aktivitetet e Kryetarit të komunës përkatësisht Ekzekutivit të komunës, në përmbushjen e detyrave si dhe përgjegjësi të tyre gjatë këtij viti raportues.

Raporti përfshinë periudhën kohore të vitit të kaluar në të cilin ka qeverisur kryetari dhe qeverisja paraprahe dhe ne jemi munduar që të paraqesim në mënyrë sa më reale gjithë punën e cila është bërë gjatë qeverisjes paraprahe në të gjitha fushat në kuadër të administratës komunale duke përfshi edhe fushën e arsimit shëndetësisë etj.

Nga të dhënat që janë marrë nga zyrtarë përgjegjës komunal, është parë se Kryetari dhe Qeveria komunale që nga fillimi i punës së tyre kanë mbajtur takime javore me drejtor të drejtorive ku është diskutuar për prioritetet e punëve që duhet kryer brenda javës si dhe obligimet për të raportuar për punët e kryera.

Gjithashtu është pasqyruar puna dhe aktivitetet e shumta me qytetarë ku përveç një takimi i cili është mbajtur në muajin qershor 2021 janë mbajtur edhe takime tjera me rastin e shqyrtimit të draft buxhetit dhe projekteve prioritare për vitin vijues në të cilat qytetarët i kanë paraqitur kërkesat dhe nevojat për prioritetet e projekteve në meset e tyre. Takimin e dytë me qytetarë e kemi mbajtur ne si qeveri e re në mbarim të muajit dhjetorë 2021 ku i kemi shpalosë prioritetet tona bazuar në planin e punës i cili është i bazuar në programin në bazë të të cilit janë fituar zgjedhjet në muajin tetor 2021.

Gjatë vitit 2021 sfida kryesore ka qenë përballja me pandeminë COVID-19 si dhe respektimi masave të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës, duke përfshi edhe procesin e vaksinimit si masë parandaluese dhe mbrojtëse për qytetarët e që është duke vazhduar edhe në këtë vit.

Ndër punët dhe aktivitetet që duhet përmendur:

- Raportimi i rregullt në kuvendin e komunës – çdo tre muaj, për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore,
- Mbikëqyrja e realizimit të buxhetit të komunës për vitin fiskal dhe realizimit i të hyrave vetanake,
- Mbikëqyrja e realizimit të projekteve kapitale të komunës,
- Propozim-aktet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje të kuvendit të komunës,
- Mbikëqyrja në zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve të miratuara në Kuvendin e Komunës,
- Bashkëpunimi me komunitetin për realizim të projekteve të ndryshme,
- Bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe organizata të ndryshme humanitare për realizim të projekteve me bashkëfinancim me interes për komunën dhe qytetarët,
- Mbikëqyrje në ngritjen e performancës në administratën e komunës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarë etj.

Në vijim të këtij raporti do të paraqitet realizimi i punëve dhe aktiviteteve brenda vitit 2021, përkatësisht planit investuese të komunës sipas drejtorive.

BUXHETI DHE FINANCAT

Me përfundimin e vitit fiskal është filluar me evidentimin e obligimeve të pa paguara nga viti i kaluar që kanë qenë në shumë prej 495,431.40 euro, barazimet me sistemin e free balancit dhe janë hartuar pasqyrat financiare për vitin fiskal 2020.

Me pagesa kemi filluar me datën 04.02.2021 dhe së pari i kemi krye faturat e pa paguara nga viti paraprahe, pastaj kemi vazhduar me faturat e vitit vijues dhe me disa përjashtime të vogla faturat i kemi kryer brenda afatit ligjor.

Në janar kemi raportuar në Kuvend të Komunës për të hyrat dhe shpenzimet vjetore,

Në muajin shkurt e kemi paraqitur në Kuvendin Komunal shpërndarjen e të hyrave të tejkaluara që ka qenë në shumën totale 290,766.58 euro,

Në majin mars kemi paraqit në kuvend bartjen e të hyrave të pa shpenzuara nga viti paraprak në shumën 1,789,251.83 euro dhe është marrë vendim për kthimin e katër projekteve kapitale nga fondi rezervë në buxhetin e rregullt të komunës në shumën 294,000.00 euro,

Në majin prill kemi bërë raportimin në kuvend për tre mujorin e –I- për të hyra dhe shpenzime,

Në majin maj kemi marrë qarkoren buxhetore 01/2022 nga MF me kufijtë e caktuar dhe së bashku me të gjitha drejtorit kemi harmonizuar kërkesat për vitin 2022,

Në muajin qershor e kemi dorëzuar në kuvend kornizën afatmesme të buxhetit për vitet 2022-2024,

Në muajin korrik kemi bërë raportimin për tre mujorin e –II- për të hyra dhe shpenzime, me theks të veçante për shpenzime kapitale,

Në muajin shtator i kemi finalizuar të gjitha kërkesat e drejtorive, dhe kemi dorëzuar buxhetin në kuvend për aprovim, por në mungesë të votave të nevojshme në Kuvendin Komunal buxheti nuk është aprovuar.

Deri me datën 27.12.2021 janë pranuar 2,178 fatura dhe shumica prej tyre janë proceduar për pagesë, kurse pa paguar kanë mbetur disa fatura që kanë mbërritur pas datës 27.12.2021, kur ka qenë afati i fundit për pagesa, dhe një pjesë në mungesë të mjeteve në programin e caktuar.
Në fund të vitit kanë mbetur fatura të pa paguara në vlerë prej 181,552.59 euro.

Gjatë vitit 2021 janë kryer 9,888 pagesa nga ana e zyrtarëve shpenzues dhe certifikues.
Shuma e përgjithshme e buxhetit të shpenzuar është 18,298,255.90 ose 88% e buxhetit të planifikuar.

Fletë pagesa për automjete janë lëshuar në shumë prej 12,847.00 euro.

Punëtorët e terrenit të tatimit në pronë gjatë vitit 2021 kanë evidentuar 1,066 prona, prej tyre 557 regjistrime të reja 437 verifikime dhe 72 përmirësime të m² dhe cilësisë.

Shkaku që nuk kemi mundur të verifikojmë më shumë prona gjatë vitit 2021 është se këtë vit jemi ballafaquar me pandemin Covid -19, dhe shumicën e kohës kemi punuar me staf të reduktuar, pastaj mungesa e stafit të mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë për arsye se gjatë vitit 2021 konkurset kanë qenë të bllokuara.

Gjatë vitit 2021 janë lëshuar 15,807 certifikata për tatim pagues, pastaj kemi dërguar 153 letër kujtesa për tatim paguesit e mëdhenj dhe kemi dërguar 137 njoftime përfundimtare.

Totali i pasurisë kapitale i regjistruar në vitin 2021 është 3,327,103.92, euro kurse totali i pasurisë së regjistruar prej 01.01.2006 deri 31.12.2021 është 113,626,021.27 euro.

Sa i përket të hyrave vetanake gjatë vitit 2022 komuna ka pasur një performancë shumë të mirë ku planifikimi ka qenë 1,906,903.00, kurse janë realizuar 3,047,135.79 që i bie se janë inkasuar të hyra vetanake më shumë se planifikimi për shumën 1,140,232.79 ose 160%.

Drejtoria për buxhet dhe financa bën inkasimin e pjesës më të madhe të hyrave komunale nga tatimi në pronë dhe po ashtu bënë inkasimin e taksës në firmë vetëm për bankat

Të hyrat vetanake të planifikuar për tatimin në pronë kanë qenë në shumën 923,124.00 €, kurse janë realizuar 895,449.83 €, ose 97% e shumës së planifikuar, kurse taksa në firmë është planifikuar 15,000.00 dhe është realizuar 15,590.00 ose 104% e shumës së planifikuar.

Meqenëse se drejtoria për buxhet dhe financa kryen shërbime për të gjitha drejtorit e tjera sa i përket planifikimit dhe realizimit të buxhetit, ne po e paraqesim në vija të trasha planifikimin dhe realizimin e buxhetit, kurse për shënime analitike është raporti vjetor i të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe pasqyrat financiare që do të paraqiten në kuvend pas auditimit nga ana e auditorit të përgjithshëm.

Forma tabelore: Buxheti i planifikuar dhe shpenzuar

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese(Janar-Dhjetor 2021)		
		Buxheti i planifikuar	Shpenzimet të realizuar	Përqindja e buxhet të realizuar
		4	5	6 = 5/4*100
		€	€	%
Paga dhe mëditje	111	10,603,183.40	10,603,183.40	100%
Mallra dhe shërbime	130	3,842,777.42	3,110,540.88	81%
Shpenzimet komunale	132	334,376.22	309,362.05	93%
Subvencionet dhe transferet	200	1,007,004.93	836,991.44	83%
Investimet kapitale	300	5,074,472.92	3,438,148.13	68%
TOTALI		20,861,814.89	18,298,225.90	88%

Përmbledhja e shpenzimeve sipas drejtorive

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese(Janar-Dhjetor 2020)		
		Buxheti i planifikuar	Shpenzimet të realizuara	5/4*100
		4	5	%
		€	€	%
Zyra e Kryetarit	160	495,014.86	429,092.93	87%
Administrata dhe personeli	163	401,070.72	347,928.08	87%
Inspektimet	166	137,250.87	112,198.99	82%
Prokurimi	167	37,913.48	31,663.96	84%
Zyra e Kuvendit Komunal	169	142,882.89	135,142.11	95%
Buxheti dhe financat	175	171,410.92	156,479.27	91%
Shërbimet publike, Mbrojtja civile dhe emergjenca	180	3,936,889.69	3,509,000.37	89%
Zyra lokale e komuniteteve	195	60,232.97	41,408.56	69%
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	858,410.16	474,938.40	55%
Gjeodezi dhe Kadastër	650	81,826.72	77,598.40	95%
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	1,514,348.57	1,059,664.57	70%

Shëndetësia primare	730	2,724,782.17	2,398,442.71	88%
Shërbimet sociale rezidenciale		322,152.92	204,562.19	63%
Kulturë, rini, sport	850	514,649.86	335,420.50	65%
Arsimi	920	9,462,978.09	8,984,684.86	95%
TOTALI		20,861,814.89	18,298,225.90	88%

EKONOMI BUJQËSI PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Sektori i bujqësisë

Në sektorin e bujqësisë janë zhvilluar një numër i aktiviteteve të bazuara kryesisht në planin e punës për vitin 2021.

Projektet e realizuara:

1. Projekti në bashkëfinancim me organizatën IADK - "Fuqizimi i të rinjve dhe grave të zonave rurale për përfshirje në bujqësi dhe përpunim të ushqimit";

Ky projekt është në fazën e implementimit, ku do të jenë 9 përfitueseve:

- Serra prej sipërfaqe 1 ari për 2 përfituese .
- Pajisje për bletari 3 përfituese.
- Pasje për blegtori 4 përfitues.
- Përpunimi i pemëve dhe perimeve.
- Përpunimi i qumështit,

2. **Projekti: Furnizimi me pajisje për bletari është kryer.**

Nr.	Lloji i investimit	Nr.i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Pajisje për bletari	48	200x48= 9600€	40,000.00€	49,600.00€

3. **Projekti: Furnizimi me frezë për traktorë , është në proces, është bërë thirrja, janë caktua kriteret, janë përzgjedh edhe përfituesit të cilët kanë paguar participimin e caktuar.**

Nr.	Lloji i investimit	Nr.i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Frezë për traktorë	36	200x36=7200€	30,000.00 €	37,200.00€

4. **Projekti: Furnizimi me moto kultivatorë, është në proces, është bërë thirrja, janë caktua kriteret, janë përzgjedh edhe përfituesit të cilët kanë paguar participimin e caktuar.**

Nr.	Lloji i investimit	Nr.i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Motokultivatorë	50	150x50=7500€	28,000.00€	35,500.00€

5. **Projekti; Furnizimi me makina për shokëlimin e misrit është në proces, është bërë thirrja, janë caktua kriteret, janë përzgjedh edhe përfituesit të cilët kanë paguar participimin e caktuar.**

Nr.	Lloji i investimit	Nr.i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Makina për shokëlimin e misrit	18	18x100€= 1800 €	15,000.00 €	16,800.00€

Projektet 3,4 dhe 5 janë në rishqyrtim për procedurën e tenderimit të ri nga ana e Prokurimit për shkak se operatorët ekonomik janë tërhjek nga nënshkrimi i kontratave për shkak të ndryshimit të çmimeve (vonesa e tillë ka ardhur si pasojë e ankesës nga një operator ekonomik në OSHP- e cila është vonuar në kthim të përgjigjes).

5.Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Gjatë reshjeve dhe stuhisë të datës 11,12 dhe 13 janar janë shkaktua dëme të konsiderueshme edhe në bujqësi, në kuadër të komisionit komunal për vlerësim të dëmeve përfaqësuesit e drejtorisë së bujqësisë kanë qenë bartës të vlerësimeve në lëmin e bujqësisë , janë vlerësuar dëmet në 94 ekonomi bujqësore, dëmi i vlerësuar mbërrin shifrën prej **203,408.67€**. Ministria e bujqësisë bazuar në buxhetin e ndarë për kompensim të dëmeve, fermerëve të Komunës së Vushtrrisë ua ka kompensua dëmin në vlerë prej **73,227.12€** respektivisht 36 % të vlerës së dëmit.

Gjatë vitit 2021 është bërë edhe aplikimi i fermerëve të komunës tonë për pagesa direke (subvencioneve) në kuadër të ministrisë së Bujqësisë ku kanë aplikuar gjithsej 1384 fermer për kulturat bujqësore të cilat janë në program si dhe për kategoritë tjera si lope qumështore, litër qumësht, buallica, dele, dhi, derra, pula.

Aplikimi i fermerëve për -Pagesa drektë për qumësht-litër sipas kategorive të cilësisë për dy gjashtë mujorët e vitit 2021 ka këtë pasqyrë:

- Gjashtëmujori i parë: kanë aplikuar 76 fermerë me 1,361,448.00 litra qumësht;
- Gjashtëmujori i dytë : kanë aplikua 67 fermerë me 1,220,139.00 litra qumësht.

Gjithsej 2,581,587.00 litra qumësht janë dorëzua fabrikave gjatë vitit 2021 duke mos llogaritur sasinë tjetër e cila nuk i plotëson kriteret për përkrahje nga ministria (sasia nën 3000 litra në 6- mujor ose kualiteti jo i duhur).

Sektori i Bizneseve:

Biznese të reja të regjistruara 220 Sh.p.k
 Biznese te reja te regjistruara individuale 87 B.I
 Biznese të shuara 49
 Ndryshime 176
 Ndryshime në logo dhe ndërrim certifikatave 183
 Vërtetime 15

Sektori i Pylltarisë:

Nr.	PERSHKRIMI	VENDI	Gjithsejtë Janar-Dhjetor 2021
1.	Kërkesa për leje-prerje	Pran zyrës	48
2.	Kërkesa të kryera	ZK-APK-Mitrovicë	21=667.03m ³
3.	Damkosje ,dru zjarri	ZK-APK-Mitrovicë	667.03m ³
4.	Fl-percjellje P-private	Sektori i pylltarisë	84flp=256.50m ³
5.	Fl-percjellje P-shtetërore	Sektori i pylltarisë	0
6.	Fletë pagesa pyje private	Sektori i pylltarisë	19=1063.20€
7.	Fletë pagesa pyje shtetërore	Shitja e Pishave në Oblovik	0€
8.	Shitje nga konfiskimi	Z.Prokurimit	0€
9.	Konfiskime	Sektori-Policia	8=54.40m ³

10.	Gjendja në depo	Pran Sektorit	103.30 m ³
11.	Zjarre	Ne terene	16.50 ha
12.	Fl-paraqitje k-vajtje	Sektori-Gjykata	96=170.98m ³ =23936.45€
13.	Fl-paraqitje penale	Sektori-Gjykata	15=68.43m ³ =10069.39€
14.	Gjithsejtë k-vaj dhe penale	Sektori-Gjykata	111=238.51m ³ =34005.84€
15.	Kontrolla në terrene	Sektori-Policia	70

Masa drunore në sasi prej 48.90m³ është e bartur nga viti 2020 në vitin 2021, në mesin e tyre 2 konfiskime në sasi prej 7.40 janë kontestuse, prandaj private ku dihet pronari. Te konfiskuara ne vitin 2021 kemi 54.40m³. gjithsejt gjendja në depo është 103.30 m³.

Çështjet Juridike; gjatë vitit 2021 nga zyrtari ligjor janë përgatitur gjithsejtë 131 akte si vendime për formime te komisioneve, rekomandime , përgjigje për palët, vendime për palët, raporte, njoftime, shpallje, certifikata bujqësore, kërkesa, thirrje për aplikim e te ngjashme.

Po ashtu ne gjykatë janë proceduar;

1.	Seanca gjyqësore	Gjykata Themelore/ apeli	94
2.	Kërkesa për inicim te procedurës kundravajtëse	Gjykatë	96
3.	Kallëzime Penale	Prokurori	16
4.	Propozime për përmbarim	Përmbaruesi Privat	42 propozime me vlerë 69145.96€

PROKURIMI PUBLIK

- Raporti i punës, pjesa tekstuale
- Raporti vjetorë i prokurimeve dhe kontratave të nënshkuara për të gjitha vlerat

Në periudhën raportuese, Drejtoria, konform dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e prokurimit publik , ka iniciuar dhe realizuar 104 prokurime, për t'i realizuar dhe përmbushur kërkesat për gjitha shtyllat e buxhetit të Autoritetit Kontraktues respektivisht për gjitha Njësitë Kërkuese.

Në tabelat si më poshtë janë paraqitur të dhënat lidhur me Planifikimin e prokurimeve për vitin 2021 si dhe gjendjen respektivisht realizimin e projekteve të pasqyruara, si vijon :

II.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM

Nr. Ren.	Përshkrimi i Kontratës	Aktiviteti është inicuar – Kontrata është nënshkuar -PO / JO
1	Furnizimi me tonera	Aktiviteti është i inicuar nga AQP
2	Furnizim me dokumente blanko	Po
3	Furnizimi me inventar	Po
4	Teknologjia Informative	Jo – nuk është inicuar
5	Furnizim me veshmbathje	Jo – nuk është inicuar

6	Furnizim me inventar për shkolla	Po
7	Furnizimi me gjeneratorëve dhe inventori	Jo – është anuluar pas inicimit
8	Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ ne oborret e shkollave	Po
9	Furnizim me kuzhina per qerdhet e reja	Po
10	Furnizimi me material pedagogjik	Po
11	Furnizim me aparate kundër zjarrit	Jo – nuk është inicuar
12	Inventarizimi i qendrës se Kulturës	Jo – është në proces të realizimit
13	Furnizimi me kositëse të barit	Jo - është anuluar pas inicimit
14	Furnizimi dhe montimi i ulëseve për nxënës në oborret e shkollave	Jo – nuk është inicuar
15	Furnizimi me mjete konkretizimi dhe topa	Po
16	Furnizimi me projektor dhe mbajtëse për projektor	Po
17	Furnizimi me TV për shkolla	Po
18	Furnizim me pajisje elektrike për amvisëri	Jo - është anuluar pas inicimit
19	Furnizim me lodra për fëmijë	Po
20	Furnizim me produkte tekstili (Çarçaf, qebe, jastëk, b tepi, perde)	Po
21	Pajisje laboratorike dhe mjete konkretizimi	Jo - është anuluar pas inicimit
22	Furnizim me kamera në qytet dhe shkolla	Po – është në realizim
23	Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për klimatizim	Po
24	Furnizim me kupa dhe medaljes	Jo – nuk është inicuar
25	Furnizim me mjete bujqësore për shkolla	Po
26	Furnizim me libra për bibliotekat e shkollave	Po
27	Furnizim me libra për bibliotekë	Po
28	Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e shkollave	Po
29	Furnizimi me preparate kimike	Po
30	Furnizim me dru dhe pellet për ngrohje	Po – për pellet është realizuar ndërsa për dru nuk është inicuar
31	Furnizim me veshmbathje (mantila, kapela, maska dhe papuçe për punëtorë)	Jo – nuk është inicuar
32	Furnizimi dhe montimi I klimave	Po
33	Furnizim me makina qepëse për kabinet te tekstilit	Po
34	Furnizim me mjete për praktike për profilin e ndërtimtarisë	Po
35	Furnizim me mjete dhe pajisje për pune	Jo – nuk është inicuar

	praktike ne kabinetin e teknologjisë ushqimore dhe profilin kuzhinier	
36	Makina për mësim praktik ne SHMT Lutfi Musiqi	Po
37	Furnizim me makina kositëse për traktor	Jo – nuk është inicu
38	Furnizim me makina për mbjellje të misrit	Jo – nuk është inicu
39	Furnizim me makina për lëvrim (Freza Traktori)	Po – është në realizim e sipër
40	Furnizimi dhe ngritja e serave	Jo – nuk është inicu
41	Furnizimi dhe ngritja e pemishteve me arra dhe lajthi	Jo – nuk është inicu
42	Furnizim me pajisje për Bletari	Po
43	Furnizim me Oksigjen (O2)	Jo – është inicu por nuk ka pasur sukses aktivitetit I prokurimit në mungesë të O.E.
44	Furnizim me veshmbathje për stafin e QKMF-s	Jo – nuk është inicu
45	Furnizim me material shpenzues për laborator	Jo – nuk është inicu
46	Furnizim me barëra dhe material shpenzues shëndetësor	Jo – nuk është inicu, është në procedim në këtë viti 2022
47	Furnizim me Pajisje mjekësore	Jo – nuk është inicu
48	Furnizim me dekorata	Jo – nuk është inicu
49	Furnizimi dhe montimi I tubit te rëntgenit	Po
50	Furnizim me tiketa siguruese (banderola)	Jo nuk është inicu
51	Furnizim me hidrofor ,aparar saldues dhe shpuese	Po
52	Furnizime për festat e fund vitit(notes dhe kalendar)	Po
53	Furnizim me E-kisoka	Jo – nuk është inicua nga se është riparua ai ekzistues duke modifikuar dhe përshtatur pajisjen për hapësirën e brendshme
54	Furnizimi me pajisje të IT për Qendra Inovative Viciana	Jo – nuk është inicua
55	Furnizim me pajisje -pompa për thithje të ujit për njësinë e Zjarfikseve	Jo – nuk është inicua

II. 2) Kontratat për Shërbime

Nr. Ren.	Përshkrimi i Kontratës	Aktiviteti është inicuar – Kontrata është nënshkruar PO / JO
1.	Shërbime konsulente për persona fizik për drejtorin e Urbanizmit	Po, nuk ka pasur sukses procedura e prokurimit
2.	Shtypja e materialeve (Procesverbalet, faturat me uniref etj.)	Jo – nuk është inicua
3.	Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimi	Po
4.	Mirëmbajtja dhe riparimi i ngrohjeve qendrore	Jo – nuk është inicua

5.	Servisimi i gjeneratorëve	Jo, nuk është inicua
6.	Servisimi dhe mirëmbajtja e TI-së	Jo – nuk është inicua
7.	Servisimi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit	Jo – nuk është inicua
8.	Transporti i nxënësve	Po – kontratë kornizë
9.	Shërbimet e sigurimit shëndetësor të nxënësve gjatë praktikës profesionale	Po – kontratë kornizë
10.	DDD	Jo – nuk është inicua
11.	Pastrimi (larja) i tepive	Jo – nuk është inicua
12.	Shërbimet për asgjësimin e mbeturinave medicinale	Jo – nuk është inicua
13.	Shërbimet për mirëmbajtjen hixhenike të objekteve të AK-ës	Po – kontratë kornizë 4 mujore, pastaj shërbimet kanë kaluar për ekzekutim të shërbimeve të Ndërmarrja Publike Komunale
14.	Shërbimet e servisimit të TI dhe aparatit fotokopjues	Jo – nuk është inicua
15.	Shërbime përkthimit	Jo – nuk është inicua
16.	Shërbimet e transmetimit përmes valëve të radios	Po – kontratë kornizë
17.	Dekorimi i qytetit për festat e fund vitit	Po
18.	Mirëmbajtja e kamerave në qytet	Po – kontratë kornizë
19.	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale	Po – kontratë kornizë
20.	Shërbime konsulente për persona fizik për drejtorin e Buxhetit	Po – nuk ka pasur sukses procedura e prokurimit
21.	Shërbime konsulente për persona fizik për drejtorin e Kadastrës	Jo – nuk është inicua
22.	Shërbimet e internetit për shkolla	Po – kontratë kornizë
23.	Organizimi i Ditës e patates	Jo – nuk është inicua
24.	Shërbimet e mbushjeve të aparateve kundër zjarrit	Jo – nuk është inicua
25.	Sigurimi fizik i objekteve të Administratës	Po – kontratë kornizë 4 mujore, pastaj shërbimet kanë kaluar për ekzekutim të shërbimeve të Ndërmarrja Publike Komunale
26.	Sigurimi i automjeteve	Po – por është ndërprerë kontrata nga BQK për shkak të falimentimit të Kontraktuesit
27.	mirëmbajtja dhe riparimi i ngrohjes qendrore për AK-ën	Jo – nuk është inicua

II. 3) KONTRATAT PËR PUNË

Nr. Ren.	Përshkrimi i kontratës / Karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë	Aktiviteti është inicuar – Kontrata është nënshkruar- PO / JO
1.	Asfaltimi i rrugës Sllakoc-Kurillovë	Jo – nuk është inicua
2.	Renovimi i Ngrrohjeve Qendrore	Jo – nuk është inicua
3.	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	Po
4.	Ndërtimi i depove për shkolla	Jo – nuk është inicua
5.	Renovimi (Meremetimi) i shkollave	Po
6.	Ndërtimi i rrethojave në shkolla	Po – në realizim
7.	Ndërtimi i Fushave Sportive në Dumnic dhe Stanovc	Po – në realizim
8.	Ndërtimi i tualeteve në shkolla	Po – në realizim
9.	Rregullimi i kanaleve kulluese	Po – në realizim
10.	Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave	Jo – nuk është inicua
11.	Pastrimi i lumenjve në Dumnic, Samadrexh dhe Studime	Po – në realizim
12.	Ndërtimi i këndeve të vaksinimit	Jo – nuk është inicuar
13.	Rregullimi i rrethojave në QKMF, QMF dhe AMF	Po
14.	Ndërtimi i parkut rekreacional Taraxha	Jo nuk është inicua
15.	Rregullimi i oborreve dhe hapësirave të QKMF, QMF, dhe AMF	Po – kontrata nuk është përfunduar – është ndërprerë
16.	Ndërtimi i rrugëve me kubëzave betoni në qytet	Po
17.	Ndërtimi i trotuareve	Po
18.	Ndërtimi rrugës Galip Badivuku	Po
19.	Rregullimi i Hapësirave Publike dhe Shesheve	Po – project në dy lloje: Loti 1 është përfunduar; Loti 2 është project dy vjeçar, pritet të përfundohet në vitin 2022
20.	Ndërtimi i Tregut për Prodhues Vendorë	Jo – nuk është inicuar
21.	Rrugët e rendit të katërt	Po – kontratë kornizë
22.	Ndërtimi i Stacionit të autobusëve	Jo nuk është inicua
23.	Renovimi i palestrës së sportive Jeton Terstena	Jo – nuk është inicua
24.	Renovimi i Stadiumit të Hendbollit	Po – realizimi e sipër
25.	Renovimi i Palestrës Sportive dhe rrethojës	Jo – nuk është inicua

26.	Pllakat Përkujtimore	Jo – nuk është inicua
27.	Renovimi i banjove të QPS-ës	Jo nuk është inicua
28.	Ndërtimi i aneksit në shkollën fillore Anton Zako Çajupi	Jo – nuk është inicua

II. 4) KONKURS PROJEKTIMI

Nr. Ren.	Përshkrimi i kontratës / Karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë	Aktiviteti është inicuar – Kontrata është nënshkruar PO / JO
1.	//	//

Nëse marrim për bazë procedimin dhe realizimin e projekteve në vitin 2021, sikurse u pasqyruan në Pasqyrën si më lartë, atëherë vijmë në përfundimin se plani i punës respektivisht procedimi, kontraktimi dhe realizimi i projekteve në vitin 2021 nuk është i kënaqshëm është përbushur në masën : 60.50% nga ajo që ishte planifikuar në konceptin fillestar të Planit të Punës për vitin gjegjës, 2021

Edhe në vitin 2021 janë duke u përdorur Kontratat Publike Kornizë. Vlera e këtyre kontratave është e pamundur të saktësohet, për shkak të natyrës dhe lëndës së aktiviteteve respektivisht kontratave të tilla. Këtë aktivitetet kanë një vlerë të përafërt të parashikuar, por që duhet theksuar se vlera e këtyre aktiviteteve në raste të caktuar është vlerë e madhe pasi që kemi të bëjmë kryesisht me furnizime, si furnizimi me derivate, naftë dhe benzinë, furnizimi me artikuj higjienik dhe ushqimorë për çerdhen e fëmijëve “ Foleja “ në Vushtrri dhe Shtëpinë rezidenciale në fsh. Lum Madh, furnizimi me reagensa dhe material tjetër të nevojshëm për nevoja të QKMF-re, furnizimi me dru dhe pellet për ngrohje të objekteve shkollore dhe atyre shëndetësore, furnizimi me toner dhe material të ndryshme shpenzuese zyrtare etj.

Duhet theksuar po ashtu se për vonesa të paarsyeshme në përfundimin e projekteve sipas planit dinamik të kontraktuar, drejtoria, në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe Kushteve të përcaktuara në Kontratën e Punës, Furnizime apo Shërbime, ka aplikuar penale për shkak të vonesave të pajustificueshme në përfundimin e kontratës ndaj disa Operatorëve Ekonomik (4 Operatorëve Ekonomik). Vlera financiare e aplikimit të penaleve kap shumë prej 1.215,36€.

Konsiderojmë me interes të theksojmë se nga gjitha prokurimet e realizuara në këtë vit, që po i referohet edhe ky Raport pune, kemi të evidentuar 18 (tetëmbëdhjetë) Kërkesa për Rishqyrtim të vendimit të Autoritetit Kontraktues të parashtuara nga ana e Op. Ek., nga të cilat 16 Kërkesa janë refuzuar ndërsa, 2 Kërkesa janë aprovuar.

Po ashtu nga 10 (dhjetë) Ankesa drejtuar në OSHP (Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik) nga të cilat 8 Ankesa janë zgjidhur, ndërsa 2 ankesa kanë mbetur në procedurë të shqyrtimit pran OSHP-së, organ i cili për momentin nuk është funksional në mungesë të anëtarëve të OSHP-së.

ADMINISTRATË

Sektori i gjendjes civile

Shërbimi i gjendjes civile gjatë periudhës janar-dhjetor-2021 ka ofruar të gjitha shërbimet që janë në kompetencë dhe që kryhen në këtë zyre. Trendi i ngritjes së efektivitetit dhe i ofrimit të shërbimeve me te mira dhe me efikase është në ngritje në këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimit dhe punës që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile, po ashtu në këtë trend pozitiv ka ndikuar edhe vendosja e sistemit për menaxhimin

e radhëve duke krijuar kushte shumë më të mira për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe zvogëlimin e parregullsive me rastin e pritjeve për të marr shërbimin e kërkuar.

Gjatë kësaj periudhe kemi vepruar me disa vështirësi dhe pengesa në punën me palë, me arsyen se kemi vazhduar të përballemi me pandeminë Covid-19 dhe kemi qenë të detyruar që të ndërmarrim dhe të respektojmë të gjitha masat për të ruajtur distancën dhe higjienën dhe po ashtu kanë qenë të obliguar të gjithë nëpunësit që të përdorim maskat mbrojtëse gjatë kontaktit dhe punës në ofrimin e shërbimeve për qytetar.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar dhe ju kemi dhënë përgjigje të gjitha kërkesat të qytetarëve sipas afateve ligjore dhe janë dhënë këto shërbime:

Numri i dokumenteve të lëshuara:

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	40309
2.	Certifikata të lindjes	11614
3.	Certifikata të martesës	8362
4.	Certifikata të vdekjes	4224
5.	Certifikata të Statusit martesor	1674
6.	Certifikata të shtetësisë	377
7.	Certifikata familjare	5724
8.	Certifikata të vendbanimit	2881
9.	Vërtetim nga arkivi	901
10.	Dëshmi e vdekjes	345
11.	Lajmërim dhe Ç'lajmërim i Vendbanimit	328
12.	Vendime te ndryshme	181
13.	Aplikimi për humbe të shtetësisë me lirim	124
14.	Aplikimi për natyralizim	16
15.	Deklarata për mbajtje	30
16.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	36
Gjithsejtë		77126

Regjistrime në Regjistrat e Gjendjes civile

1.	Regjistrime të lindjes	325
2.	Martesa	789
3.	Regjistrime të vdekjes	539
4.	Regjistrime të Shtetësisë	8
5.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	242
6.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	77
7.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	63
8.	Deklarata e Atësisë dhe Amësisë	40
9.	Shkurorëzime	157
Gjithsejtë regjistrime të bëra		2240

Ne këtë periudhë janë verifikuar 2733 qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa që nga fillimi i sistemit të ri me 19.02.2013 janë të verifikuar apo të regjistruar në sistemin e gjendjes civile 101247 qytetar të komunës së Vushtrisë.

Spektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative

Aktiviteti i Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative ishte i përkushtuar në këto qëllimet kryesore:

Funksionalitetit i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës, monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale; integriteti dhe ruajtja e të dhënave; mbështetja lidhur me përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve të TI; menaxhimi dhe administrimi i punëve të përbashkëta si në shërbimin e përkthimit, lekturimit, mirëmbajtës teknike të objektit. Gjatë viti 2021, Spektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative ka kryer këto punë dhe ka ofruar këto shërbime:

- Janë kryer shërbime softuerike dhe harduerike, për administratën komunale;
- Është bërë mirëmbajtja e infrastrukturës së rrjetit LAN
- Është bërë mirëmbajtja e sistemeve të TI s
- Është administruar ueb-faqja zyrtare të komunës
- Janë ofruar shërbime përkthimi dhe

Qendra për Shërbim të Qytetarëve

Në kuadër të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 70321 kërkesa, prej të cilave janë:

Nr.	Përshkrimi	Nr. Kërkesave
1	Drejtoria për Administratë	40.420
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	9359
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	13.694
4	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural	657
5	Drejtoria për Shërbime Publike	1302
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	2020
7	Drejtoria për Arsim	647
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	1231
9	Drejtoria për Inspeksion	546
10	Personeli	1638
11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	410
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	290
13	Zyra Ligjore	147
14	Kryetari i Komunës	279
15	Drejtoria e Prokurimit	26
16	Kuvendi i Komunës	43
17	Zyra Lokale e Komuniteteve	16
18	Njësia e Auditimit të Brendshëm	8
19	Zyra për Integritet Evropiane	1
		72.734

Njësia për të Drejta të Njeriut

Gjatë kësaj periudhe raportuese punën dhe aktivitetit të NJKDNJ një rëndësi e veçante iu është dhënë të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, të drejtave të fëmijëve dhe drejtave të komuniteteve. Një bashkëpunim i përafërt i NJKDNJ me OJQ qoftë rinore qoftë OJQ që fushë veprimtari të tyre kanë çështjet gjinore. Në bashkëpunim me programin e USAID, GIZ, OSBE. Grupi i përbashkët punues është ngrit pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjimet buxhetore, pastaj ngritja e përqindjes së femrave në këto takime dhe të komuniteteve jo shumicë që jetojnë në komunën ton. Tubimet për të drejtën trashëgimore është karakteristik edhe e këtij vitit, pasi edhe ky vit nga qeveria e Republikës është shpallur vit i barazisë pronësore mes bashkëshortëve. Është hartuar Rregullorja për të drejtat e fëmijëve Përveç aktiviteteve të theksuara këtë periudhë e karakterizojnë këto punë:

- Takim pune me Komunitetin Konsultativ për të PAK;
- Takimi me Policinë Kosovës –Stacioni në Vushtrri, marrja e të dhënave për rastet e Dhunës në Familje;
- Vizita në QKMF – Vushtrri;
- Takim me grupin punues për hartat Zonale në komunë organizuar nga GIZ
- Takimi me përfaqësueset e OJQ për të mbijetuarat e dhunës gjatë luftës;
- Pjesëmarrja në takim me shoqatën Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës;
- Plotësimi i pyetësorit nga ABGJ për çështje gjinore;
- Organizimi i tryezës kundër dhunës ndaj gruas, me gratë e viseve rurale;
- Organizimi i katër takimeve me gratë rurale lidhur me sensibilizimin për të drejtën pronësore;
- 30 vizita në shkolla ku kemi biseduar për të drejtat e fëmijëve dhe sigurinë në shkolla;

ARSIM

DKA në Vushtrri ka menaxhuar mbarëvajtjen e procesit mësimor gjithnjë sipas kalendarit të vitit shkollor. Në këtë vit u krijuan vështirësi për mësimin e rregullt pas gjendjes së pandemisë covid-19..

Periudha e parë e vitit shkollor filloi më datën: 14.01.2022 dhe ka përfunduar më 30.12.2022

Numri i nxënësve në nivele për vitin shkollor 2021/22:

Niveli 0: 1020 nx.

Niveli 1: (1-5) 5095 nx.

Niveli 2: (6-9) 4105 nx.

Niveli 3: (10-12) 2627 nx.

Gj. 13178 nx.

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për fundin e vitit shkollor 2020/2021, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara. Ky zhvillim u bë duke u ndarë detyrat më kohe më qëllim të përgjegjësive dhe llogaridhënies.

Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete:

- Janë zhvilluar mentorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, e që në objektiv kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë së procesit mësimor;
- Kanë qenë në funksion 34 vija transporti për nxënës të cilët udhëtojnë mbi 4 km;
- Është hap objekti i ri në SHFMU "Migjeni" Stanoc të Epërm;
- Është hap objekti i ri i shkollës së muzikës;
- Biblioteka e re në SHFMU "Migjeni" në Stanoc të E. për nxënës dhe qytetarë;
- Është shtuar shërbimi profesional me 3 pedagogë në shkolla;
- Janë pajisur shkollat me 146 laptop ;
- Çerdhja e re afër SHFMU "Mustafë Venhari" është inventarizuar dhe fillon punën në shtator;
- Çerdhja e re afër SHF "Ali Kelmendi " është në përfundimit të punimeve;
- Salla sportive në SHMU-2 janë duke u kryer punimet e vrazhda;
- Salla sportive në SHMU-1 është në furnizim të inventarizimit;

- Ka përfunduar punëtorja në shkollën e mesme teknike dhe nga shtatori është e gatshme për praktikë profesionale .
- Rregullimi i hapësirës së oborrit të shkollës në SHFMU- Lumadh;
- Janë zgjedh 12 shkolla më mjedis miqësor kundër abuzimit të fëmijëve;
- Vendosja e muralit në qytet me qëllim edukativ dhe vetëdijesues kundër abuzimit të fëmijëve;
- 69 bursa për të gjithë studentët të cilët kanë notën mesatare mbi 8;
- Janë mbjell 362 dru dekorativ për shkolla;
- Furnizim me mjete didaktike për nxënësit e komuniteteve;
- Janë ndarë 27 shpërblime për nxënës;
- Janë kryer 29 pagesa për transport për fëmijë më nevoja të veçanta

Garat e diturisë dhe vlerësimet e jashtme

- Është mbajtur pilot testi PISA me nxënësit e SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri;
- Është mbajtur testi PIRLS me kasat e IV-ta, në 6 shkolla të komunës së Vushtrrisë ("Naim Frashëri", "A.Z.Çajupi", "Ali Kelmendi", "Liria", "Bahri Kuqi", "Mustafë Venhari");
- Është mbajtur testi nga Instituti Pedagogjik për klasat e dyta dhe të shtata në SHMU-2, "Hajrullah Shala", "A.Z.Çajupi", "Naim Frashëri" rreth studimit: Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasoja në rritjen e pabarazisë në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit:
SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri : klasa e VII lënda Gjuhë shqipe 50.12%, Matematikë 65.67. klasa e dytë gjuhës shqipe 67.15
SHMU-2 Vushtrri: klasa e VII lënda Gjuhë shqipe 30.13%, Matematikë 53.13%;
SHFMU "Hajrullah Shala" Akrashticë : : klasa e VII lënda Gjuhë shqipe 39.10%, Matematikë 52.55% klasa e dytë gjuhës shqipe 51.85%;
SHF " Naim Frashëri" Vushtrri : klasa e dytë gjuhës shqipe 62.37 %;
- Janë mbajtur garat në nivel komunal në esë : vendin e parë SHFMU " A.Z.Çajupi" Vushtrri;
- Nxënësit e SHMT "Lutfi Musiqi" kanë fituar grantin nga Korpusi i Paqes;
- Janë mbajtur garat komunale në lëndën e fizikës dhe të matematikës;
Fizikë në nivel vendi: Gjimnazi vendi i dytë edhe më klasë të XII-të dhe më XI-të;

III.1. Garat sportive

REZULTATET E ARRITURA NË NIVEL KOMUNAL PINGPONG:

SHMU-2, Vushtrri Vendi i parë, Femrat dhe meshkujt;

BASKETBOLL:

SHMU-2 Vendi i parë, Femrat dhe meshkujt;

SHMT "Lutfi Musiqi" vendi i parë, meshkujt;

HENDBOLL:

SHFMU "Lumni Surdulli" – Samadrexhë" vendi i parë (femrat);

SHMU-2 Vushtrri vendi i parë meshkujt;

Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri vendi i parë (femrat);

VOLEJBOLL:

SHMU-2 Vushtrri , vendi i parë, femrat;

SHFMU " Gj.K.Skënderbu" Pantinë, vendi i parë meshkujt;

Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri vendi i parë (femrat);

SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri, vendi i parë (meshkujt);

FUSTALL:

SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri vendi i parë femrat;

SHMU-1 Vushtrri , vendi i parë meshkujt;

BASKETBOLL:

SHMU-1, Vushtrri vendi i parë femrat;

SHMU-2 Vushtrri vendi i parë meshkujt;

SHMT “Lutfi Musiqi” Vushtrri vendi i parë (meshkujt);

Gjimnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri vendi i parë (meshkujt);

SHAH:

SHMU-2 Vendi i parë ;

REZULTATET E ARRITURA NË NIVEL REGJIONAL

Ping-Pong

1. SHMU: Shkolla e Mesme e Ulët “2” – Vushtrri (femrat);
2. SHMU: Shkolla e Mesme e Ulët “2” – Vushtrri (meshkujt);

Basketboll

1. SHMU: Shkolla e Mesme e Ulët “2” – Vushtrri (femrat);
2. SHMU: Shkolla e Mesme e Ulët “2” – Vushtrri (meshkujt);
3. SHML: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” – Vushtrri (meshkujt);

Hendboll

1. SHMU: Shkolla e Mesme e Ulët “Lumni Surdulli” – Vushtrri (femrat);
2. SHMU: Shkolla e Mesme e Ulët “2” – Vushtrri (meshkujt);
3. SHML: Gjimnazi “Eqrem Çabej” – Vushtrri (femrat);

Volejbol

1. SHML: Gjimnazi “Eqrem Çabej” – Vushtrri (femrat);
2. SHML: Shkolla e Mesme Profesionale “Bahri Haxha” – Vushtrri (meshkujt);

Futsal

1. SHMU: Shkolla e Mesme e Ulët “1” – Vushtrri (meshkujt)

Basketboll

1. SHMU: Shkolla e Mesme e Ulët “ 1 ” – Vushtrri (femrat)
2. SHMU: Shkolla e Mesme e Ulët “ 2 ” – Vushtrri (meshkujt)
3. SHML: Shkolla e Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” – Vushtrri (meshkujt)
4. Gjimnazi “Eqrem Çabej” – Vushtrri (femrat)

REZULTATET E ARRITURA NË NIVEL REPUBLIKAN

Ekipe sportive shkollore të cilat fituan në garat republikane janë:

Ping-Pong

1. Vendi i dytë: SHMU: “2” – Vushtrri (meshkujt);
2. Pa plasman: SHMU: “2” – Vushtrri (femrat);

Basketboll

1. Vendi i tretë: SHMU: “2” – Vushtrri (femrat);
2. Pa plasman: SHMU: “2” – Vushtrri (meshkujt);
3. Vendi i Parë: SHMT: “Lutfi Musiqi” – Vushtrri (meshkujt);

Hendboll

1. Vendi i Parë: SHMU: “Lumni Surdulli” – Vushtrri (femrat);
2. Vendi i parë: SHMU: “2” – Vushtrri (meshkujt);
3. Vendi i parë: SHML: Gjimnazi “Eqrem Çabej” – Vushtrri (femrat);

Volejbol

1. Vendi i dytë: SHMP: “Bahri Haxha” – Vushtrri (meshkujt);
2. Pa plasma: SHML: Gjimnazi “Eqrem Çabej” – Vushtrri (femrat);

Futsal

1. Vendi i parë: SHMU: “1” – Vushtrri (meshkujt);

Basketboll

1. Vendi i tretë: SHMU: “ 1 ” – Vushtri (femrat)
2. Vendi i dytë: SHMU: “ 2 ” – Vushtri (meshkujt)
3. Vendi i dytë: SHML: “Lutfi Musiqi” – Vushtri (meshkujt)
4. Vendi i dytë: SHML:Gjimnazi “Eqrem Çabej” – Vushtri (femrat)

Marrë në tërësi rezultatet e arritura këtë vit shkollor janë rezultatet mjaftë të mira , andaj me plotë të drejtë mund të themi se këto rezultate janë të kënaqshme. Edhe këtë vit shkollor komuna e Vushtrisë me 5 medalje të arta, 6 medalje të Agjenda dhe 1 medalje të bronzit, renditet ndër qytetet e para në plasman të përgjithshëm të garave në nivel vendi. Rezultatet a arritura janë mjaftë inkurajuese edhe për gjeneratat pasuese të cilave u mbetet barrë e rënd që këto të arritura t’i mbrojnë e pse jo edhe t’i tejkalojnë, por e gjithë kjo arrihet me punë dhe përkushtim të madh nga të gjithë.

Suksesi në fund të vitit shkollor 2020/ 2021, krahasuar me vitin paraprak në periudhën e njëjtë

Klasa 1-5

Periudha e njëjtë	Suksesi i fundit të vitit shkollor 2021 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, për klasën 1-5												
	Shkëlqyeshëm	%	Sh.mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Të panotuar	%	Të pamjaftueshëm	%	Gj.
2021	350 7	68.0 4	958	18.5 8	537	10.4 1	151	2.92	0	0	1	0.01	515 4
2020	364 1	69.6	926	17.7	513	9.8	148	2.82	1	0.01 9	0	0	523 1
Krahasimi	-134	- 1.56	32	0.88	24	0.61	3	0.1	-1	- 0.02	1	0.01	-77

Suksesi kl.I-V		
Fundi i vitit shkollor	Pozitiv	Negativ
Periudha e njëjtë		
2021	5153	1
2020	5231	0
Krahasimi	-78	1

Periudha e njëjtë	Suksesi i fundit të vitit shkollor 2021 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, për klasën kl. VI-IX												
	Shkëlqyeshëm	%	Sh. Mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Të pa notuar	%	Të pamjaftueshëm	%	GJ
2021	1200	28.72	932	22.31	1106	26.47	789	18.88	0		19	0.45	4177
2020	1464	34.4	986	23.19	1200	28.22	593	13.95	9	0.21	0	0	4252
Krahasimi	-264	-5.68	-54	-0.88	-94	-1.75	196	4.93	-9	0.21	19	0.45	-75

Suksesi kl VI-IX		
GJ.II , Periudha e njëjtë	Pozitiv	Negativ
2021	4158	19
2020	4252	0
Krahasimi	-94	19




Suksesi kl.X-XII		
Periudha e njëjtë	Pozitiv	Negativ
2021	2537	32
2020	2686	3
Krahasueshmeria	-149	29

Periudha e njëjtë	Suksesi i fundit të vitit shkollor 2021 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, për klasën 10-12												
	Shkëlqyeshëm	%	Sh. Mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Të pa notuar	%	Të pamjaftueshëm	%	GJ.
2021	314	12.22	479	18.64	794	30.9	949	36.94	1	0.04	32	1.25	2569
2020	412	15.32	575	21.38	923	34.3	773	28.74	4	0.149	3	0.11	2690
Krahasueshmëria	-98	-3.1	-96	-2.74	-129	-3.4	176	8.20	-3	-0.11	29	1.14	-121

Testi i arritëshmërisë

Viti	2018	2019	2021
%	52.05	49.43	49.78

Testi i matures afati i parë me krahasueshmëri



Suksesi në Gj.vj. e I-rë, periudha e parë
Viti shkollor 2021/2022

Klasë	Shkëlqyeshëm	%	Sh. mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Me një notë të dobët	%	Me dy nota të dobëta	%	Me tri e më shumë nota të dobëta	%	Të pa notuar	%	Përcillen me nota negative	%	Gjithsej
Klasa 1	795	80.79	116	11.79	56	5.69	17	1.73	0	0.00	0	0.00	0	0	0	0	0	0.00	984
Klasa 2	693	70.93	186	19.04	67	6.86	31	3.17	0	0.00	0	0.00	0	0	0	0	0	0.00	977
Klasa 3	669	63.71	237	22.57	119	11.33	23	2.19	2	0.19	0	0.00	0	0	0	0	0	0.00	1050
Klasa 4	630	58.66	265	24.67	144	13.41	30	2.79	5	0.47	0	0.00	0	0	0	0	0	0.00	1074
Klasa 5	560	56.06	244	24.42	140	14.01	44	4.40	4	0.40	6	0.60	1	0.10	0	0	0	0.00	999
	3347	65.83	1048	20.61	526	10.35	145	2.85	11	0.22	6	0.12	1	0.01	0	0	0	0.00	5084

19/a

Suksesi në Gj.vj. e I-rë, periudha e parë
Viti shkollor 2021/2022

Klasë	Shkëlqyeshëm	%	Sh. mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Me një notë të dobët	%	Me dy nota të dobëta	%	Me tri e më shumë nota të dobëta	%	Të pa notuar	%	Përcillen me nota negative	%	Gjithsej
Klasa 6	295	28.72	258	25.12	218	21.22	34	3.31	81	7.89	50	4.87	87	8.47	4	0.3	0	0	1027
Klasa 7	229	24.41	199	21.22	202	21.53	44	4.69	113	12.05	59	6.29	92	9.81	0	0.0	0	0	938
Klasa 8	233	22.47	247	23.82	208	20.05	35	3.38	93	8.97	66	6.36	153	14.7	2	0.1	0	0	1037
Klasa 9	237	22.99	174	16.88	183	17.75	52	5.04	99	9.60	61	5.92	214	20.7	11	1.0	0	0	1031

19/6

Suksesi në Gj. Vj. e I-rë, periudha e parë
Viti shkollor 2021/2022

Klasë	Shkëlqyeshëm	%	Sh. mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Me një notë të dobët	%	Me dy nota të dobëta	%	Me tri e më shumë nota të dobëta	%	Të pa notuar	%	Përcillen me nota negative	%	Gjithsej
Klasa 10	69	7.37	159	16.99	156	16.67	21	2.24	120	12.82	10	11.1	306	32.6	0	0.0	1	0.11	936
Klasa 11	67	8.19	147	17.97	128	15.65	23	2.81	76	9.29	87	10.6	290	35.4	0	0.0	0	0.00	818
Klasa 12	104	13.10	117	14.74	131	16.50	28	3.53	84	10.58	77	9.70	249	31.3	4	0.5	0	0.00	794
Gjithsej	4581	39.27	2349	20.14	175	15.02	382	3.27	677	5.80	51	4.37	1392	11.9	21	0.1	1	0.01	11665

19/c

SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale dhe menaxhmenti i QKMF-së, bazuar në Strategjinë Sektoriale të KPSH në Vushtrri dhe në zbatueshmëri me planin e veprimit janë të përkushtuar maksimalisht që të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagnostikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrrisë.

Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Gjatë vitit 2021 DSHPS dhe QKMF kanë arritur që të kenë një bashkëpunim shumë të mirë me donator për realizimin e projekteve me bashkëfinancim si:

- Bashkëpunimi me AQH e Zvicrës, me të cilët përveç zhvillimit të vazhdueshëm profesional kemi përfituar pajisje mjekësore për hapjen e laboratorit në Lumadh me bashkëfinancim, ndërtimi i aneksit të laboratorit i paraparë me buxhet të shëndetësisë si dhe do të rehabilitohet dhe funksionalizimet Laboratori në QMF-3. Donatori ka sjellë pajisjet mjekësore për mini laborator në QMF-3, neve na mbetet të realizojmë projektin gjatë vitit 2022.
- Me Islamic Relief me seli në Prishtinë kemi vazhduar projektin i cili ka filluar në vitin 2017 në bazë nevojave dhe kërkesave të qytetarëve në fushën e shëndetësisë, vizita mjekësore në shtëpi, ku kemi përmirësuar përkujdesjen ndaj qytetarëve. Në krahasim me vitet e kaluara, kemi rritur numrin e stafit profesional mjekësor, të angazhuar 7 ditë të javës /13 orë, me dy ekipe mjekësore me nga 1 mjek dhe dy infermier, me dy vetura.
- Në bashkëpunim me UNICEF kemi vazhduar projektin për vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare dhe me të arriturat sipas planprogramit jemi shpërblyer me një automjet terreni për realizimin e vizitave shtëpiake.

MSH ka pajisur me pajisje mjekësore të nevojshme objektin e ri të QKMF-së.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Në QKMF dhe QMF 1 punohet nga ora 07:00h deri në ora 20:00h, po ashtu ditën e shtunë dhe të diele kujdestarohet nga ekipi i mjekësisë familjare. Urgjenca punon 24 orë dhe është e vendosur në objektin e QMF1 .

Në QMF 2 dhe QMF 3 punohet nga ora 7 deri ne ora 14 çdo ditë pune.

QMF-të që gjenden në viset rurale punohet nga ora 08 deri ne ora 15 h, përveç QMF Smrekonicë dhe Lumadh ku punohet nga ora 07 h deri 14:00h çdo ditë pune, ndërsa në të gjitha AMF-të punohet nga ora 08:00h deri 15:00h .

Në disa QMF mjeku punon tri ose dy ditë në javë, kjo si pasojë e mungesës së stafit sepse gjatë vitit 2021 ka pasur staf të infektuar me virusin Covid-19 dhe kjo si rrjedhojë ka pamundësuar që mjeku të angazhohet çdo ditë nëpër QMF apo AMF, po ashtu në AMF Skromë dhe Zhilivodë për shkak të mungesës së stafit, terrenit të vështirë dhe mungesës së transportit nuk kemi mundur të dërgojmë ekipin mjekësorë një herë në javë në AMF për banorët që janë në numër të vogël si dhe numri i pacienteve është i vogël .

Ju paraqesim në formë tabelare vizitat mjekësore në QKMF, QMF dhe AMF:

N r.	Emri i shërbimit	Totali	Meshkuj	Femra	Pac. Që kanë participuar	shërbime	Referime	Sëmundje Malinje	Sëmundje Kronike	Me kartela
1	QKMF	6578 4	30753	3503 1	10795	225052	7856	27	3260	718
2	Urgjenca	3413 4	15572	1856 2	2776	166867	4083	291	5550	1
3	Laboratori	2048 2	8051	1243 1	4322	228338	0	0	0	0
4	Stomatologjia	9015	4003	5012	965	42542	222	0	0	1052
5	RTG	5612	2554	3058	1160	22948	0	0	0	0
6	Rtg e dhembit	838	363	475	127	1779	0	0	0	0
7	Vaksinimi	4750	2593	2157	0	19546	0	0	0	3922
8	QMF-1	5714 2	26618	3052 4	11734	151735	8110	36	2421	711
9	QMF-2	5845	2610	3235	809	35262	624	0	199	163
10	QMF-3	6940	3024	3916	1092	48030	60	0	1097	681
11	QMF-AMF	1699 5	7341	9654	2367	69274	4356	5	1646	1737
12	QMF Lumadh	5597	2766	2831	982	12987	768	2	564	602
13	QMF Smrekonice	2594	1144	1450	376	9827	1521	1	229	508
14	QMF Pantine	2298	936	1362	509	9187	769	0	275	930
15	QMF Druar	1393	625	768	114	6992	550	0	101	246
16	QMF Novolan	596	142	454	12	4946	85	0	28	187
17	QMF Maxhunaj	2697	1103	1594	330	9461	570	1	291	113
18	QMF Dumnice	210	56	154	13	2993	44	1	12	94
19	AMF Samadrexh	588	280	308	41	5960	105	0	222	179
20	AMF Strovç	241	82	159	1	1101	28	0	24	0
21	AMF Pasome	213	118	95	0	1874	0	0	9	23
22	AMF Oshlan	44	13	31	4	2186	5	0	1	2
23	AMF Beçiq	190	100	90	12	748	81	0	3	3
24	Amf Dubovc	152	88	64	8	444	39	0	2	9
25	AMF Ceceli	182	40	142	0	568	8	0	0	0
26	AMF Zhilivod	0	0	0	0	0	0	0	0	0
27	AMF Skrome	0	0	0	0	0	0	0	0	0
28	V.SHTEPIA KE	3374	1533	1841	0	35275	2	0	0	0
29	KshillimoreA QH	1551	704	847	0	6068	0	0	212	0
	Gjithsejt	2324 62	105719	1267 43	36147	105271 6	25313	359	14385	8985

Sektori i Shëndetit Publik

Është përgjegjës për imunizim dhe vaksinim dhe për Sistemin Informativ Shëndetësor, ky sektor përcjell gjendjen epidemiologjike në bazë të raporteve kthyesë nga IRSHP dhe bashkë me ta vepron në rast se kërkohet apo dyshohet në ndonjë epidemi. Për shkak të gjendjes dhe situatës në të cilën ishim gjatë këtyre viteve po ashtu në vitin 2021 nuk kemi mundur të kryejmë vizita sistematike nëpër shkolla. Vaksinimi në Vushtrri është ndër më të mirët në Kosovë dhe arrin përqindje prej 95.0 %, në realizim të planit, e që është një bazë e mirë për preventivën e sëmundjeve që më herët kanë qenë të pranishme në Kosovë e rajon.

Bazuar në raportin e IRSHP në Mitrovicë kemi të raportuara 3270 raste të infektuara me virusin Covid -19, kurse prej tyre zyrtarisht janë të konfirmuara 89 raste të vdekjes. Gjatë vitit 2021 kanë qenë 78 të infektuar staf profesional mjekësor, administrative dhe mbështetës.

Që nga muaji Mars 2021 deri më 31.12.2021 janë vaksinuar me dozë të parë 35591 pacient, me dozë të dytë 32152 pacient dhe me dozë të tretë janë vaksinuar 1135 pacient, në total janë dhënë 68878 doza të vaksinave. Po ashtu si çdo vit për shkak të mbrojtjes së popullatës me rrezikshmëri më të lart shëndetësore janë dhënë 2384 doza të vaksinave të gripit sezonal.

Ministria e Shëndetësisë së bashku me menaxhmentin e QKMF në Vushtrri kanë përcaktuar nevojat për staf profesional mjekësor me qëllim të realizimit të planit të vaksinimit

Njësitë e SISH-it të QKMF në Vushtrri është duke funksionuar me sistemin e ri. M.Sh ka bërë shtrirjen e rrjetit për të gjitha QMF dhe AMF, po ashtu ka pajisur KPSH me pajisje kompjuterike dhe pajisje tjera të TI, por që implementimi ende nuk ka ndodhur dhe shpresojmë që gjatë vitit 2022 të funksionalizohet në të gjitha institucionet e KPSH.

Sektori i Shëndetit Oral Preventiv

Në sektorin e shëndetit oral preventiv janë vizituar gjithsejtë 9015 pacient dhe ka dhënë 42542 shërbime. Këtu përfshihet këshilla mjekësore, ekzacerbimi dhëmbëve, shërimi, bllobimi dhe pastrimi i gurëzve në dhëmbë. Punohet nga ora 07^h deri në ora 20^h në QKMF dhe në QMF1, ndërsa dy herë në javë në QMF2 dhe QMF3 nga ora 07^h deri në ora 14^h, QMF Lumadh dhe QMF Pantinë. Kujdestaria mbahet në QMF-1 në ditën e shtunë nga ora 07^h deri në ora 19^h.

Shërbimi i Urgjencës

Gjatë vitit 2021 ka pas gjithsejtë 34134 pacient janë dhanë 166867 shërbime shëndetësore. Në Urgjencë shërbimet janë 24^h dhe punohet do ditë të javës. Në këtë shërbim janë të angazhuar katër ekiye që punojnë me ndërime 12 orësh, janë të angazhuar 5 mjek dhe 17 infermier, këtu kryhen vizita mjekësore dhe shumë shërbime tjera që dalin nga këto vizita.

Sektori diagnostikues

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2021 në Laborator ka pas gjithsejtë 20482 pacient dhe janë dhënë 228338 shërbime të ndryshme, është hapur laboratorin në Lumadh në bashkëfinancim me AQH të cilët kanë dhënë donacion me pajisje mjekësore për laborator por për shkak gjendjes e cila u përkeqësua nga virusi dhe në mungesë të stafit laboratorit, përkohësisht nuk është funksional.

Laboratori ka qenë i furnizuar mirë me reagensë, po ashtu gjatë kësaj periudhe me buxhet të komunës jemi furnizuar me material për kryerjen e analizave: IGG dhe IGM, D-Dimer dhe teste rapide dhe në vazhdimësi ka filluar nga Ministria e Shëndetësisë furnizimi me teste rapide të shpejta.

Rëntgeni nga Janari deri në Dhjetor ka pas gjithsejtë 5612 pacient dhe janë dhënë 22.948 shërbime. Vlen të ceket se të gjithë ata që kanë kërkuar shërbim në Radiologji e kanë marrë atë shërbim. Në Rëntgenin e dhëmbit gjithsejtë ka pas 838 pacient dhe janë dhënë 1779 shërbime.

Barnatorja Qendrore

Ka për detyrë të bënë planifikimin, organizimin, dhe liferimin e produkteve medicinale nëpër QMF dhe AMF.

Furnizimi me material shpenzues medicinal, barëra, insulina nga lista esenciale e MSH për periudhën kohore janar – dhjetor 2021 është realizuar në vlerë prej 245,136.67 Euro.

Për shkak të mungesave gjatë furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shëndetësisë, QKMF ka qenë e detyruar të bëjë blerjet e tyre nga buxheti i komunës të ndarë për blerjet e produkteve medicinale dhe material shpenzues.

ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional për mjekët dhe infermier, është komponent me rëndësi të veçantë për personelin shëndetësor të QKMF-së. Në QKMF mbahen takime të rregullta me mjek dhe infermier të cilat organizohen përmes përgjegjëses për ZHVP. Gjatë vitit mbahen takime profesionale për profesionistët mjekësor për çdo muaj, 10 ligjërata ku ligjërues mund të jenë mjekët familjar apo edhe mjekët e profileve të ndryshëm. Këto ligjërata nuk mbahen vetëm në muajin korrik dhe gusht. Zakonisht janë mbajtur ligjërata me tema që kanë qenë të përzgjedhura nga këshilli profesional i QKMF-së dhe nga ky vit janë të certifikuara nga OMK.

Shpenzimet e derivateve 2021 të krahasuara me vitin 2020

Nr.	Viti	Shpenzimet në derivate
01	2021	16360.13 litra
02	2020	17122.46 litra
Krahasimi, shpenzimet e vitit 2021 kanë qenë më pakë prej		762.33 litra naftë

Shërbimi vizitat shtëpiake për nënën edhe foshnjën. Në koordinim dhe bashkëpunim me M.SH, UNICEFIN dhe AMC. Vazhdohet të implementohet programi i vizitave shtëpiake për gra shtatzëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare.

Në formë tabelare ju paraqesim vizitat shtëpiake për gra shtatzëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare:

Nr.	Përshkrimi	Totali i vizitave	Shërbime
1.	Vizita për gra shtatzëna	692	3460
2.	Vizita për fëmijë deri moshën tri vjeç	2679	13395
	Total	3371	16855

Në vitin 2021 për shkak të arritjes së performances në plan program, QKMF ka përfituar donacion këto pajisje: Llaptop, Ipad dhe veturë, kurse në vitin 2022 kemi fituar një veturë me km 00 nga MSH për programin e vizitave.

Të hyrat vetanake në formë tabelare:

Nr.	Viti fiskal i të hyrave vetanake	Vlera totale e të hyrave
1.	2019	52,721.00
2.	2020	28,444.50
3.	2021	57,188.50
Në krahasim me vitin 2020 dhe 2021 kemi rritje në e paraqitur në ndryshim vlera		28744.00 Euro, e që i bie mbi 50%

Ekipi i terrenit Islamic Relief

Projekti është realizuar sipas Objektivave të shtojcës B të marrëveshjes për ofrimin dhe dhënien e shërbimeve mjekësore si :

- Gratë shtatzëna dhe lehonat;
- Moshë e tretë mbi moshën 65 vjeçare;
- Personat me aftësi të ndryshme;
- Personat me sëmundje kronike;
- Personat me sëmundje malinje;

Në kuadër të implementimit të projektit vlera e investuar nga donatori ka qenë 100,000.00 e cila ka pasur të siguroj fondë në vlerë prej 100,000.00 Euro ose 58.82%, kurse buxheti komunal të participojë me kontribut financiar prej 70,000.00 Euro ose 41.18%.
Projekti sa i përket financave është realizuar dhe menaxhuar nga IRË me seli në Kosovë.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Pranë QPS –Vushtrri, në Asistence Sociale janë 1473 familje, prej tyre 1412 familje me 6873 anëtarë janë shqiptarë si dhe 61 familje me 178 anëtarë janë minoritete.

Gjatë këtij viti janë parashtruar 174 kërkesa për asistencë sociale prej të cilave 54 janë aprovuar, kurse 120 prej tyre janë refuzuar si familje të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret. Ndërsa janë riaktivizuar 17 familje. Asistenca sociale i është ndërprerë 62 familjeve të cilat kanë qenë shfrytëzuese të asistencës sociale.

Në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 145 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM 124 aplikues, janë refuzuar 19 aplikues, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 2 .

Gjatë kësaj periudhe 9 familje i kanë kthye mjetet pasi që janë refuzuar nga ATK dhe janë të obliguar ti kthejnë mjetet, kthimi i mjeteve bëhet për shumën e marrë të ndihmës sociale për një muaj.

FËMIJËT PA KUJDES PRINDOR

Edhe në këtë vit, QPS-ja detyrë prioritare ka pasur punën me fëmijët pa kujdes prindor dhe në përgjithësi fëmijët nga familjet devijante. Kemi pasur 2 fëmijë të braktisur të bartur nga viti i kaluar kurse gjatë këtij viti kemi 1 fëmijë të braktisur, ku fëmijët janë regjistruar, ju është caktuar kujdestari ligjor. Dy (2) raste të bartura nga viti i kaluar janë në procedurë gjyqësore, 2 fëmijë janë vendosur në SOS fshat Prishtinë, pastaj janë vendosur në strehim familjar në komunitet, kurse fëmiju tjetër i braktisur është adoptuar.

Gjatë këtij viti i kemi pasur 25 kërkesa për kujdestari të veçanta, kemi caktuar kujdestar ligjor për 12 raste, me rastet e bartura nga vitet paraprake gjithsej 46 kujdestari aktive. Strehim familjar 22 raste, të gjithë fëmijët që janë në strehim familjar tek të afërmit janë vizituar dhe janë trajtuar në formën e duhur duke ju ofruar fëmijëve dhe familjeve seanca këshilluese, e shërbime të tjera të nevojshme,

TË MITURIT ME SJELLJE TË ÇRREGULLUARA DHE DELIKUENT TË MITUR

Kemi 26 raste të delikuencës së të miturve dhe 2 raste fëmijë me sjellje asociale. Punëtorët e shërbimeve sociale asistojnë në polici dhe gjykatë për rastet e të miturve. Me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira në procesin e risocializimit dhe riedukimit kemi pasur bashkëpunim të drejtpërdrejt me policinë, familjen, Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe subjektet e tjera.

Veprat me të cilat karakterizohen të miturit me sjellje asociale janë bredhja, si rezultat i kësaj është prezente edhe trafikimi i vajzave të mitura. Ndërsa delikuenca e të miturve karakterizohet më tepër me vepra penale, si vjedhje si dhe veprat prishje e rendit dhe qetësisë publike. Gjatë tretmanit psiko- social të këtyre fëmijëve dhe të miturve Qendra ka vendos kontakte permanente me të miturit, familjet apo kujdestarët e tyre si dhe bashkëpunim me subjekte tjera si OJQ, shkollat etj.

DHUNA FAMILJARE

Gjatë periodës raportojmë ka pasur shtim të rasteve ku kemi 48 raste të raportimit të dhunës familjare, ndaj femrave dhe raste ndaj anëtarëve të familjes, çka është mjaft brengosëse kur të kemi parasysh se rastet po shtohen dhe ekipet e Qendrës për Punë Sociale duhet të jenë në gadishmëri dhe të ju ofrojnë asistim në polici, gjykatë, vendosje në strehim të përkohshëm, seanca konsultuese e këshilluese dhe bashkimin familjarë.

PERSONAT E MOSHUAR

Sikurse edhe kategoritë tjera të mbrojtjes sociale edhe këto kategori të moshës së pleqërisë kanë pasur tendencën e rritjes, mirëpo në këtë periudhë rëndësi të veçantë i kemi kushtuar sidomos të moshuarve pa kujdes familjar ku i kemi pasur të vendosur 3 raste, 2 në shtëpinë e pleqve Skenderaj dhe 1 në Prishtinë, 4 kërkesa te reja, 1 kërkesë është në procedurë për tu vendosur në shtëpi të pleqve Prishtinë, dhe janë dhënë 6 raporte për bashkim familjar tek të afërme jashtë shtetit.

SHERBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike bënë rregullimin e qytetit dhe mbrojtjen e ambientit, bënë mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt, rregullimin e qarkullimit të komunikacionit, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, parkingjet, transportin lokal, përcjell largimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, mbikëqyrë punën e lëmisë së furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza, menaxhon me procedurat e bartjes dhe deponimit të hedhurinave, pastrimin dhe larjen e rrugëve, shesheve dhe sipërfaqeve publike, mirëmbajtjen e shtratit të lumenjve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e varrezave, parqeve dhe gjelbërimit të qytetit, mbikëqyrë dhe menaxhon punën e autoparkut të Kuvendit Komunal, etj.

Furnizimi me ujë

Gjatë vitit raportues kemi qenë të orientuar në kycjen e të gjitha ekonomive familjare në rrjetin e ujësjellësit në të gjitha fshatrat e komunës, projekt ky i kontraktuar dhe në implementim e sipër. Në këtë projekt do të përfshihen rreth 9000 familje. Deri më tani janë kycur ekonomitë familjare të 5 fshatra prej të cilëve fshati Balinc, Ashlan, Bukosh, Vërnice, Novolan, Liqej, Taraxhë, Dervar, Reznik, Mihaliq, Stanoc i Poshtëm, Stanoc i Epërm, Ropicë, Vilancë, Samadrexhë, Sfararaq, Smrekonicë. Gjithashtu kemi qenë të orientuar në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të kësaj fabrike si dhe krijimin e TASK FORCES për eliminimin e keqpërdorimit të ujit të pijes në mënyrë që të kemi furnizim më të rregullt me ujë.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur gjendja me ofrimin e shërbimeve për ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet që pranojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijes.

Emri i operatorit	Numri i ekonomive familjare	Numri i EF që pranojnë shërbimin e furnizimit me ujë	Numri i bizneseve aktive në komunë	Numri i bizneseve që pranojnë shërbimin e furnizimit me ujë	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve që pranojnë shërbimin e furnizimit me ujë
a	b	c	ç	d	dh	e
Ndërmarrja „Mitrovica”	11866	11866	886	724	164	110

Largimi i ujërave të zeza

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit po ashtu janë bërë investime të shumta sidomos në shtrirjen e rrjetit primar kryesisht për gjatë lumenjve në një numër të konsiderueshëm të fshatrave, duke nënshkruar kontratën me projekte dy vjeçare 2021-2022. Ka vazhduar implementimi i dy kontratave për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit nëpër shumë fshatra të komunës: fshati Dervar në gjatësisë L=1615 m dhe L=1455 m, fsh. Maxhunaj lagja Zekolli L=715 m lagja Kosumi L=950, lagja Bekteshi L=955 m Stanoc lagja Shala L=650 m lagja te mulliri L=630 m, Doberllugë L=1950 m, lagja Sahiti L=655 m, lagja Merovci L=536 m, Stanoc i Epërm L=2105 m lagja Bekteshi L=955m Sllatinë L=3156 m, Pantinë L=1890 m

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur gjendja me ofrimin e shërbimeve për ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet që posedojnë sistemin e ujërave të zeza.

Largimi i ujërave atmosferike

Në kuadër të planit të punës së Drejtorisë, me planin financiar, është paraparë që të intervenohet në pastrimin e pusetave të kanalizimit atmosferik. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen UNITETI.

Menaxhimi i Mbeturinave

Me qëllim të implementimit të kësaj infrastrukture ligjore, krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë përmes menaxhimit të plotë të mbeturinave kemi vazhduar së zbatuari Planin për Menaxhimin e Mbeturinave, Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe një varg dokumentesh që kanë derivuar nga ky plan.

Tashmë shërbimet bazike të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve konsiderohen të përmbushura si rezultat i implementimit të plotë të Planit Operativ të ndërmarrjes.

Pas përmbylljes së proceseve për shërbimet bazike, janë krijuar mundësitë për fillimin e procesit të ndarjes së mbeturinave në burim. Në këtë kontest në bashkëpunim me GIZ dhe GAC kemi implementuar Marrëveshjen e bashkëpunimit, si dhe hartimin e Planit Komunal pesëvjeçar 2022-2026.

Edhe pse jemi ballafaquar me problemet e shkaktuara nga pandemia COVID19 kemi arritur që të bëjmë inkasimin e mjeteve në vlerën 495,558.84 € si dhe kemi bërë filtrimin e listave duke implementuar Vendimin e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për lirim nga pagesa të rasteve sociale për periudhën Janar-Dhjetor 2021.

Gjithashtu përmes Ndërmarrjes komunale „Përparimi” është bërë mirëmbajtja e të gjitha hapësirave publike. Kjo praktikë e mirëmbajtjes së hapësirave publike në qytet është treguar mjaft e suksesshme pasi që janë kursyer mjete të konsiderueshme financiare të buxhetit të komunës si dhe është bërë punë më e madhe në terren.

Pra tërë këto aktivitete përbëjnë fushatën më të madhe mjedisore që për synim kanë mbulueshmërinë me shërbim të tërë territorit të Komunës së Vushtrrisë, eliminimin e qëndrueshëm të deponive ilegale, rritjen e shkallës së inkasimit përmes mekanizmave kushtëzues që parashih rregullorja për menaxhim të mbetjeve, si dhe zvogëlimin e sasisë së mbetjeve që deponohen, përmes promovimit të ndarjes së tyre në burim apo promovimit të 3R, si dhe procesit të kompostimit.

Në kuadër të Raportimit të Sistemit për Menaxhim të Performancës në ofrimin e shërbimeve komunale, në bazë të rezultateve të publikuara Komuna e Vushtrrisë ka përfituar çmime për vitin 2019 dhe mjetet e përfituara janë investuar kryesisht në rikonstruimin e hapësirave publike dhe fushave sportive, ndriqimin publik, ndërtimin e trotuarit në fshatin Stanoc dhe sinjalizim.

Më poshtë është paraqitur gjendja me ofrimin e shërbimeve nga KRM “Uniteti” për ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet që pranojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave:

Nr. i ekonomive familjare: 11866, nr. Ek. Fam. Që pranojnë shërbimin e mbeturinave: 11866, nr.i bizneseve në komunë: 886, nr.i bizneseve që pranojnë shërbimin e mbeturinave: 886, nr.164, i institucioneve: Numri i institucioneve që pranojnë shërbimin e mbeturinave: 164.

Në fushën e mirëmbajtjes së gjelbërimit me sukses janë realizuar projektet e planifikuara, si:

- Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ;
- Plani për pastrimin, mirëmbajtjen dhe kultivimin e parqeve të qytetit;
- Plani i ruajtjes dhe mirëmbajtjes së rrethojës, inventarit, gjelbërimit dhe drunjve në parqe;
- Plani i mirëmbajtjes së stazave dhe rrugicave në parqe;
- Është punuar edhe në planin e mirëmbajtjes së varrezave, në varreza të dëshmorëve, martirëve dhe atyre të qytetit.

Ndriçimi publik

Ka vazhduar zgjerimi i rrjetit të ndriçimit të rrugëve në qytet dhe në fshatra sipas Kontratës dy vjeçare. Kemi bërë ndriçimin e disa rrugëve në gjatësinë 101.503 km në vlerën prej 198,788.00 €.

Po ashtu është zbatuar kontrata për mirëmbajtje të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra për vitin 2020.

Ndërtimi me kubza betoni

Janë realizuar kontratat për ndërtimin e rrugëve me kubza në vlerën 48,096.00 € që përfshinë rrugët: rr. „Greva e Minatorëve” në gjatësinë L=210m, rr. „Durrësi” L=250 m, rr. „segment i rrugës Niman Ferizi” L=460 m, rregullimi i rrugës „Galip Badivuku” dhe rregullimi i rrugës „Pandeli Sotiri”.

Ndërtimi i trotuareve

Me qëllim të rritjes së shkallës së sigurisë për këmbësorët është investuar në ndërtimin e trotuareve në vlerën prej 21,376.80 në rr. „Lidhja e Lezhës” në gjatësinë L=980 m dhe atë në fshatin Stanoc i Poshtëm në vlerën 38.911,87 € L= 1250 m.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur gjendja e rrugëve të asfaltuara, trotuareve dhe shtigjeve për biçikleta në raport me totalin e rrugëve brenda Komunës së Vushtrrisë.

Gjithësej rrugë	Rrugë të ndërtuara	Trotuare	Ndriqim Publik	Shteg për bicikleta	Rrugë të sinjalizuara
750.332 km	715.587 km	171.771 km	337.15 km	16.2	325 km

Komunikacion

Në kuadër të fushës së trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto merimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim shkarkim.

Në fushën e trafikut është nënshkruar kontrata e furnizimit dhe vendosjes së sinjalizimit horizontal dhe vertikal ku është bërë sinjalizimi horizontal dhe vertikal i disa rrugëve brenda territorit të komunës, Komuna e Vushtrrisë synon të krijojë një rrjet funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pa motorizuara, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta.

Po ashtu janë menaxhuar kontratat për mirëmbajtje dhe rikonstruim të rrugëve të asfaltuara, mirëmbajtje të rrugëve të rendit të IV-të dhe kontrata për mirëmbajtje dimërore të rrugëve lokale.

Parkingjet publike

Hapësira për parkingje brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë të cilat janë në shërbim të qytetarëve janë 29 me gjithsej 1198 vend parkingje prej të cilave 22 hapësira posedojnë vende të rezervuara për persona me nevoja të veçanta. Ndërsa lokacioni i rezervuar për parkimin e mjeteve motorike TAKSI është 59.

INSPEKTIMET

Në kuadër të Drejtorisë për Inspektime veprojnë Inspektorë të fushave të ndryshme, prandaj në raport janë paraqitur edhe aktivitetet sipas fushave të inspektimit :Aktivitetet të paraqitur në mënyrë tabelare:

Inspektorati	Nr.i procesverbaleve	Fletparaqitje	Vendime/Urdhëres	Vendime për rrënimë	Mbyllje të lokaleve për kohshistë	Gjoha mandatore
Inspektorët e Tregut - 4	247		18		8	10
Inspektori Sanitar 1	75		179		2	1
Inspektorët e Ndërtimtarisë - 3	53	7	19	3		5
Inspektorët e Komunikacionit - 2	49		18			
Inspektorja e Shërbimeve Publike - Higjienës 1	33		102			4
Totali	457	7	336	3	10	20

Vërejtje: Inspektorati Sanitar, detyrat dhe kompetencat kanë kaluar në AUV , nga muaji Gusht 2021

Subjektet afariste të pajisura me pëlqim të kushteve teknike sanitare:

Inspektorati i Tregut dhe Sanitar

APLIKUAR	41
TË VENDOSURA	40
NË PROCEDURË	1
Mjete të inkasuara në €	3150,00

Të hyra nga Inspektorati i Komunikacionit - Pranimi teknik i automjeteve

APLIKUAR	18
TË VENDOSURA	18
Mjete të inkasuara në €	90,00

PËLQIME SANITARE - Inspektori Sanitar

APLIKUAR	34
TË VENDOSURA	34
Refuzara	-
Mjete të inkasuara në €	7,416.15 €

Malli i asgjësuar - Inspektorati i Tregut dhe Sanitar

Sasia e mallit të asgjësuar në Kg.	21977,07 Kg
Të hyra nga malli i asgjësuar	750,00 €

AKTIVITETET NË FORMË TABELARE

Nr.	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	SASIA	VLERA
1	AKTIVITETE INSPEKTUESE	1863	
2	PROCES VERBALE	457	
3	AKTVENDIME/ URDHËRESA TË NDRYSHME	336	
4	FLETËPARAQITJE NË GJYKATË	7	
5	PRANIME TEKNIKE	41	3150.00
6	PËLQIME SANITARE	34	17,416.15

7	PRANIME TEKNIKE TË AUTOMJETEVE	18	90
8	MALL I LARGUAR NGA SHITJA DHE ASGJASIMI I MALLIT	21977,07 Kg	
9	PAGESË PËR ASGJASIM TË MALLRAVE	3	750,00
10	KËRKESA TË PRANUARA	499	
11	KËRKESA TË MIRATUARA	497	
12	KËRKESA TË REFUZUARA	2	
13	KËRKESA NË PROCEDURE		
14	GJOBË MANDATORE	20	5600.00
15	MBYLLJE TË PËRKOHSHME TË LOKALEVE AFARISTE	10	
16	VENDIME PER RRËNIME	3	

Aktivite tjera lidhur me Covid 19

Për mos respektim te masave anticovid janë shqiptuar 43 gjoba, ndërsa nga gjykata supreme janë hedhur poshtë këto gjoba pasi që kanë qenë te shqiptuara pra se te hyj Ligji covid 19 ne fuqi.
Për mos respektim te masave anticovid është shqiptuar një gjobë mandatore në shume prej 1000.00 € si dhe janë mbyllur 3 lokale.

Koment : Gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka pasur asnjë rast të konfirmimit zyrtar të intoksikimit alimentar (helmimit me ushqim) .

INSPEKTORATI I NDËRTIMIT

Për këtë periudhë janë kryer inspektime lidhur me ndërtimet e objekteve të ndërtimit të lartë dhe të ulët, duke kontrolluar terrenin e komunës së Vushtrrisë.

Në kuadër të kontrollimit të terrenit, janë hartuar procesverbalet dhe Aktvendime për ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi.

Procesverbale.....	53
Vendime për ndërprerjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi	19
Lëndë të dërguara në Gjykatë për Kundërvajtje	7
Vendimet për rrënim.....	3
Gjoba mandatorë.....	5
Takimet me palë	44
Lëndët (kërkesat) e pranuar	112
Lëndët e përfunduara	11

INSPEKTOATI KOMUNIKACIONIT Janë lëshuar gjithsej : 49 procesverbale, 18 vendime për pranime teknike të auto taksive dhe janë inkasuar gjithsej 90.00 €.

Gjatë vitit 2021 janë kryer 82 aktivitete inspektuese

Qëllimi i inspektimeve ka qenë mbikëqyrja dhe inspektimi i të gjithë operatorëve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarëve dhe –mallrave që qarkullojnë në territorin e Komunës Vushtrri
Inspektimi i Auto taksive, Operatorët “Taksi”, Ndërmarrjet të cilat merren me transport të udhëtarëve,
Ndalimi i operatorëve ilegal , masat e ndërmarra ndaj tyre, kushtet teknike të automjeteve, inspektimin e automjeteve të transportit të mallrave, kontrollimin e vijave Komunale urbane dhe nder urbanë,
bashkëpunimi me Policinë e Kosovës ku janë kryer edhe inspektime në komunikacionin rrugor.

INSPEKTORATI I HIGJENËS KOMUNALE

Gjatë punës vjetore 2021 inspektorja ka bërë inspektime dhe mbikëqyrje të vazhdueshme bazuar në rregulloren komunale që e rregullon këtë lëmi. Janë ndërmarr të gjitha masat administrative të nevojshme për arritjen e objektivave të përcaktuara me planin e vitit 2021 sikur që janë:

- Inspektimi i pastërtisë të qytetit me rrethinë dhe objektet komunale të rrjedhjes së kanalizimeve dhe fekaleve ;
- Inspektimi i papastërtisë së sipërfaqeve të gjelbëruara publike;
- Inspektimi i papastërtisë rreth objekteve banesore ;
- Inspektimi i pastërtisë e lokaleve afariste – vitrinat;
- shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve sa i përket lëmisë se higjienës komunale dhe
- marrjen e masave administrative në rastet e nevojshme.

Angazhimi për mbikëqyrjen e pastërtisë së qytetit me rrethinë dhe objektet komunale ka qenë në përditshmëri dhe i vazhdueshëm po ashtu kemi bërë inspektime të mbikëqyrje të rregullta papastërtisë rreth objekteve banesore dhe përcjelljen e hedhjes së hedhurinave të banorëve në kontejnerë. Ne gjithashtu kemi përcjell mbajtjen e pastërtisë se vitrinave dhe lokaleve afariste . Për konstatimet e bëra kemi lëshuar procesverbale dhe urdhëresa dhe masave tjera administrative me qëllim të ngritjes së cilësisë të higjienës në Komunën tonë .

Angazhime të rregullta kanë qenë edhe në mbikëqyrjen e rrjedhjes se ujit, vetëm në raste kur kemi konstatuar dhe në rastet e caktuara me kërkesë të qytetarëve ,ne e kemi urdhëruar KRU-Ujësjellësi për të bërë sanime të menjëhershme. Të gjitha kërkesat e qytetarëve të cilat i janë drejtuar për Inspektorin e Higjienës Komunale – Shërbimeve Publike janë zgjidhur brenda afateve ligjore.

Përgjatë këtij vjetori kemi pasur angazhime të vazhdueshme për mbikëqyrjen e pastërtisë së sipërfaqeve të gjelbëruara publike .

Me qëllim të realizimit të detyrave jam angazhuar dhe kam bashkëpunuar me Inspektorët si ata të Tregut dhe inspektorët tjerë varësisht nga kërkesa e Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit.

Në këtë periudhë janar-dhjetor 2021 inspektorja e higjienës komunale - shërbimeve Publike ka bërë kontrollime inspektuese në rrugët e qytetit dhe të fshatrave. Kemi 84 shënime zyrtare, janë dorëzuar, raporte ditore dhe javore sipas kërkesës së Drejtorit të Inspeksionit. Nga inspektimet dhe konstatimet janë hartuar 33 procesverbale, 102 urdhëresa dhe 4 gjoba mandatore.

Nga ana e Inspektorëve është mbajtur kujdestari jashtë orarit të punës për ditët e vikendeve dhe të festave me qëllim të inspektimit dhe mbikëqyrjes të punëve nga të gjitha lëmitë që i përkasin, si dhe duke marrë parasysh gjendjen e krijuar nga sëmundja ngjitëse Covid-19, Inspektorati është angazhuar në zbatimin e Ligjit Për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin e AUV-it.

KULTURË RINI DHE SPORT

QENDRA E KULTURËS “HASAN PRISHTINA”

Duke qenë se në fillim të këtij viti kalendarik është bërë edhe përrurimi i objektit të ri të Qendrës për Kulturë Hasan Prishtina’, rrjedhimisht edhe rrethanat për punë më të mirë dhe efikase kanë ndryshuar në kuptimin pozitiv.

Stafi i Qendrës për Kulturë “Hasan Prishtina” gjatë këtij viti ka mbështetur apo organizuar të gjitha aktivitetet kulturore që janë organizuar nga institucionet komunale. Po ashtu, ka ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe aktiviteteve të ndryshme në të cilat është kërkuar ndihma jonë. Shfrytëzimi i mjeteve të zërimit çdoherë është bërë në përputhje me rregulloren komunale, Ne në vazhdimësi kemi mbështetur, por edhe kemi marrë pjesë në organizimin e shumë takimeve letrare, si promovime të librave të ndryshëm në territorin e komunës sonë por edhe jashtë, kryesisht të autorëve vushtrrias. Gjithashtu, janë mbështetur edhe shumë artistë për organizimin e ekspozitave të tyre, në Galerinë e Arteve në Qendrën e Kulturës, si dhe aktorëve për realizimin e shfaqjeve që janë dhënë në Teatrin e Qytetit ‘Adem Mikullovc’ Një punëtor i QK “Hasan Prishtina” mban në vazhdimësi të hapur dhe përkujdeset për Kalanë e Qytetit.

BIBLIOTEKA “NAIM FRASHËRI”

1. Në sektorin për fëmijë janë dhënë për lexim 1014 libra;
2. Në sektorin për të rritur janë dhënë për lexim 587 libra;
3. Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 457 lexues (për shkak të pandemisë, deri më 14 shator 2020, salla e leximit nuk ka qenë në funksion);
4. Janë përpunuar 461 libra;
5. Lexues të regjistruar në sektorin për të rritur 31 vetë (12 me pagesë, 12 x 2 = 24 Euro);
Lexues të regjistruar në sektorin për fëmijë ishin 104 (25 me pagesë, 25 x 2 = 50 Euro).

Në dy sektorët kanë qenë 135 lexues të regjistruar, derisa janë dhënë për lexim 1601 libra.

Në sektorin për fëmijë libri më i kërkuara për lexim ishte: **“Lushi si askushi”**, i autorit Arif Demolli

Në sektorin për të rritur, librat më të kërkuar për lexim ishin: **“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”** i Ismail Kadares Libri shkencor më i kërkuar ishte **“Historia e popullit shqiptar IV”**, i botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë më 2002.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2021, në bibliotekë kanë hyrë 474 libra (libra të dhuruara) dhe janë blerë 291 libra, gjithsej 765.

Kështu, në muajin shtator, biblioteka ka blerë 291 libra shkollor dhe shkencor (158 tituj), përmes subvencionimit të MKRS-së, në vlerë 3,000.00 Euro. Librat janë blerë në librarin **Migros -2** në Vushtrri. Përzgjedhja e titujve është bërë sipas kërkesave të lexuesve.

MUZEU HISTORIK – ETNOGRAFIK

MUZEU	Muzeu i Vushtrrisë - “Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit”, është përzgjedhur të projektohet nga Komisionit Evropian duke e mundur qasjen edhe për persona me nevoja të veçanta.
PUNËT HULUMTUESE DHE IDENTIFIKIMET	Përgjegjësjë e muzeut gjatë gjithë vitit vazhdoi punën në hulumtimin e të burgosurve politik gjatë periudhës 1944-1950 në Vushtrri dhe rrethinë, duke mbledhur dhe regjistruar në muze 36 biografi secila histori në vete të asaj kohe. Stafi i muzeut gjatë punëve hulumtuese në terrenin e Vushtrrisë, identifikuan dhjetëra eksponate nga fusha të ndryshme të trashëgimisë kulturore
PASURIMI I SEKTORËVE: ARKEOLOGJI HISTORI ETNOGRAFI TEKNOLOGJI FOLKLOR DHE KULTURË SHPIRTËRORE	Gjatë vitit 2021 muzeu u pasuria me një palë veshje popullore tradicionale të Rrafshit të Dukagjinit dhe 29 eksponate nga fusha e etnologjisë, folklorit dhe teknologjisë të hulumtuara në Vushtrri dhe rrethinë.
PASURIMI I SEKTORIT TË KINOTEKËS DHE FOTOTEKËS	Ndërsa, sektori i kinotekës të muzeut u pasuria me tre (3) video dokumentar të realizuar në komunën e Vushtrrisë,
BIBLOTEKA SHKENCORE E MUZEUT	Është sistemuar fondi i botimeve shkencore në hapësirën dedikuar bibliotekës shkencore të muzeut. Është punuar me studentë dhe lexues, duke iu ofruar shënime dhe literaturë shkencore në realizimin e detyrave dhe punimeve shkencore.

INVENTRIZIMI DIGJITAL I EKSPONATEVE HISTORIKE, ARKEOLOGJIKE, ETNOGRAFIKE FOLKLORIKE	<ul style="list-style-type: none"> • Në muze u inventarizuan gjithsejtë 58 eksponate nga kultura materiale: <ul style="list-style-type: none"> ○ 47 nga sektori i etnologjisë; ○ 8 nga sektori i teknologjisë; ○ 3 nga sektori i arkeologjisë. • Gjithashtu u inventarizuan dhe u regjistruan dy këngë lirike nga kultura shpirtërore të vjelura nga terreni.
--	---

SEKTORI I RINISË – Aktivitetet kryesore:

Së bashku me Qendrën Rinore, bordin e KVRL-së dhe grupet joformale u diskutua dhe planifikua për projektet që do të realizohen gjatë vitit 2021, po ashtu u bë edhe ristrukturimi i këtij këshilli.

Takime pune dhe informues me përfaqësuesit e OJQ- ve rinore gjatë takimeve me ta është bërë planifikimi dhe janë hartuar projekt propozime dha janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera.

Takime pune dhe bashkëpunim me OSBE

Qendra Rinore “Hareja” ka mbajtur trajnime për Rrobaqepësi dhe Modë për të gra dhe vajza të grup moshave të ndryshme, në fund të këtyre trajnimeve pjesëmarrësve në trajnime u janë ndarë edhe certifikata për ndjekjen e trajnimeve. Ky projekt është mbështetur nga IOM dhe është asistuar nga sektori i rinisë.

Organizata Rinore “Acces” në bashkëpunim me sektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në komunën e Vushtrrisë, është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet për financim.

Takim me përfaqësuesin e OJQ “Lëvizja Koha” me të u diskutua për projektet që parasheh të realizojë kjo OJQ, për formën e aplikimit dhe qasje ne fonde te donator të ndryshëm.

KVRL në bashkëpunim me organizatën “Domain for Kosovo” kanë mbajtur sesion informues për të rinjtë në shkollat e mesme, ky sesion ka për qëllim informimin e të rinjve për themelimin dhe punën e KVRL-së si dhe promovimin e Domenit shtetëror për Kosovë.

Trajnime për shkathtësi të buta, kurse për kompjuter, kurse për gjuhë të huaja, kurse për matematikë, të mbajtura nga Qendra Rinore “Hareja” e cila është licencuar në fund të vitit të kaluar

SEKTORI I SPORTIT

Siç edhe jeni në dijeni nga Pandemia Covid-19 Sporti ka qenë ndër më të rrezikuarit dhe shumica e Aktiviteteve dhe Kampionateve janë anuluar me arsyetim për të mbrojtur shëndetin. Palestra Jeton Tërstena Tota për një kohë ka shërbyer si qendër e vaksinimit nga data 08/06/2021 deri në muajin Shtator dhe ka vështirësuar punën e Klubeve.

Dita Olimpike u shënua me datën 23/06/2021. Aktiviteti i Vrapimit nga Komuna e Vushtrrisë u mbajt në Stadiumin e Qytetit " Ferki Aliu" dhe filloj në ora 10:00. Ku pjesëmarrës në organizimi ishin 150 fëmijë, prej të cilëve 75 vajza dhe 75 djem, nga Shkollat SHMU 1 dhe SHMU 2 . Aktiviteti ishte shumë atraktiv dhe të gjithë fëmijët morën medalje.

Me datën (27.09.2021 ditë e Hëne) është organizua turneu në basketboll I(Streetball) për vajza. Pjesëmarrëse në këtë turnir kanë qenë katër (4)ekipe. Arsyeya e turneut ishte rihapja e dy fushave te basketbollit ku u be rinovimi i tyre.

Gjatë muajit Nëntor kemi organizuar turneun në Futsall për ditën e Flamurit Turneu “28 NËNTORI”
DKRS-JA KA PËRFUNDUAR PLANIN STRATEGJIK PËR KAMPIONET E ARDHSHËM VUSHTRRIA
2021/2025

me datën (27/12/2021) është organizuar aktiviteti përmbyllës nga DKRS-ja . Për festat e fund Vitit kemi organizuar “ Turneun në Futboll të vogël U13 “. Përgatitjet për turneun në Futboll i kemi filluar me datën 20.12.2021.

ARKIVI HISTORIK

Shërbimi për mbrojtjen e dokumenteve arkivore jashtë arkivit	Gjatë kësaj periudhe kemi bashkëpunuar me Gjykatën Komunale-Vushtrri, materiali është në gjendje të mirë në bazë të rregullave të ruajtjes së dokumentacionit.
Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale	Gjatë kësaj kohe kemi pranuar dosje personale (Civile) të gjykatës të cilat janë gjetur në ndërkohë si lëndë të mbetura ose të përfunduara me vonesë
Evidentimi rregullimi dhe klasifikimi dokumenteve brenda arkivit	Gjate vitit 2021 kemi përpunuar materiale të ndryshme dhe renditje të tyre vetëm sa për të krijuar hapësirë të punës më efektive.
Aktivitetet tjera	Punët e depos Materiali i cili ka qenë në depot e arkivit ishte në gjendje të mirë vetëm se kanë munguar kushtet e përshtatshme të temperaturës, të cilat janë të kërkuara me Ligjin mbi Lëndën Arkivore dhe Arkivat.

GJEODEZI KADASTËR DHE PRONE

Punët dhe aktivitetet kryesore:

Nr. Rend.	LENDET E ARRITURA Janar- dhjetor 2021	Gjithsejtë
1.	KERKESAT E ARRITURA	9362
2.	AKTVENDIME PER BARTJE	1516
3.	AKT. PER KORRIGJIMIN E EMRAVE DHE MBIEMRA.	152
4.	AKTVENDIME PER REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	103
5.	AKTVENDIME PER CREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	86
6.	VERTETIME-CERTIFIKATA	380
7.	COPTIMI-NDARJE FIZIKE	1
8.	INQIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	37
9.	Uzurpimet	1
10.	KOPJE TE PLANIT	620
11.	LISTA POSEDUESE	2215
12.	KERKESA ZYRTARE TE NDRYSHME	110
13.	Shpronësime	2
14.	LENDET NE PROCEDURE	42
15.	Kërkesa tjera(identifikim, dalje ne teren, ankesa etj).	195

Për nevoja të përfituesve të ndihmës sociale janë lëshuar 320 certifikata që nuk posedojnë pasuri të paluajtshme si dhe 218 certifikata pronësore.

Janë zhvilluar procedurë të shpronësimit të pronës së paluajtshme për interes publik në Vushtrri, rruga 2 Maji (dy prona të paluajtshme).

Gjithsejtë të hyrat buxhetore për vitin periudhën janar qershor 2021 nga drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë 126,115.62 euro, ndërsa të hyra nga dhënia me qira të pronave komunale janë inkasuar 2,155.00 euro borxhe paraprake pasi që me Vendim të Kuvendit edhe për këtë vit janë të liruar nga pagesa e qirasë.

Pranë kësaj drejtorie gjatë kësaj periudhe kemi aprovuar kërkesa zyrtare të ndryshme të parashtruara nga ana e organeve komunale, gjyqësore, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare etj.

PUNET E KRYERA PER NEVOJA TE KOMUNES:

Gjatë periudhës raportuese zyrtarët e drejtorisë kanë kryer punë të ndryshme për nevoja të Komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.)

URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Vushtrrisë ka vazhduar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për trajtimin e kërkesave në kuadër të: Sektorit të Urbanizmit, Planifikimit, Legalizimit, Mjedisit dhe Zyrës së Adresave si dhe Shërbimet Juridike.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021, kryesisht janë mbajtur takime të organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban (të prezantuara në vijim), pjesëmarrja në konferenca të organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, takimet e rregullta me komunitetet e zonave të ndryshme, propozimet e ndryshme për rregullimin e infrastrukturës dhe është punuar në rritjen e bashkëpunimit në mes të DUMM me drejtoritë e tjera për qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta në dobi të Komunës së Vushtrrisë.

Sa i përket planeve hapësinore ka në zbatim Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024 i aprovuar me vendim nr.01Nr.126/17 të dt.04.05.2017 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, i cili është një plan strategjik multi-sektorial dhe i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021, DUMM ka zbatuar në përpikëri Planin Zhvillimor Komunal ku zyrtaret përgjegjës gjatë çdo shqyrtimi të kërkesave të pranuar që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale të tyre janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II) janë trajtuar me përkushtim dhe në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunal.

DUMM është në partneritet që nga viti 2019 me UN Habitat Kosova në hartimin e Hartës Zonale për komunën e Vushtrrisë, drafti final është në përfundim e sipër.

Lejet ndërtimore:

Vendim për Leje ndërtimore.....27, prej të cilave:

Për objekte të kategorisë I - 16 kushte ndërtimore

Për objekte të kategorisë II - 11 kushte ndërtimore.

-Vazhdim i Lejeve I;

-Refuzime: 3

-Në procedurë: 3

Kushte ndërtimore:

Vendim për caktimin e kushte ndërtimore.....28 prej të cilave:

Për objekte të kategorisë I - 17 kushte ndërtimore

Për objekte të kategorisë II - 11 kushte ndërtimore.

Në bashkëpunim me UN Habitat Kosova është punuar në: Raportin e Vlerësimit të Planit Zhvillimor Ekzistues, Databaza e integruar e planifikimit hapësinor, Draft Harta Zonale Komunale, Raporti mbi procesin e Konsultimeve Publike, Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për HZK, Draft Plani i Veprimit për Zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrri, Draft Koncepti i Kufirit të Qendrës Historike të Vushtrrisë

Në respektim të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimit Administrativ kemi lëshuar me kërkesën e palëve 20 Leje Mjedisore Komunale .

Legalizimet

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar gjithsejtë 507 kërkesa, si në vijim: .

Vendim për Legalizim.....110

Kategori I.....105

Kategori II.....5

Sistemi i Adresave-

Të gjitha palët që kanë aplikuar për Leje Ndërtimore sipas Ligjit janë regjistruar edhe në Sistemin e Adresave ARIS.

Gjate vitit 2021 janë digjitalizuar në Sistemin e Arisit 118 hyrje të reja.

Të tjera:

Kërkesa të ndryshme të qytetarëve 231

Vlerësime të ofertave..... 18

Mbikëqyrje të objekteve..... 23

Komisione të ndryshme 5

Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të qytetarëve për ndërtime, legalizime etj bëhet në bashkëpunim edhe me drejtori tjera komunale për realizimin e tyre.

Buxheti i planifikuar dhe shpenzuar

Deri më 31.12.2021 janë realizuar të hyrat buxhetore në vlerë prej **612,619.13 €**, nga Taksa Administrative për leje të ndërtimit dhe Tarifa për Ndikimet nga Rritja e Densitetit të Infrastrukturës nga Taksa për pajisjen me Certifikatë Legalizimi janë realizuar **18,365.90 €** të hyra buxhetore.

MBROJTJE DHE SHPËTIM

Angazhimi për azhurnimin dhe hartimin e planeve për parandalimin dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera ka qenë detyrë permanente e kësaj drejtorie.

Qëllimi i azhurnimit i këtyre planeve është që të bëhet koordinimi i të gjitha shërbimeve për reagim emergjent në nivel komunal, si dhe asistimi i qytetarëve në rast të fatkeqësive natyrore, teknologjike dhe fatkeqësive të tjera dhe që të kemi një strukturë të koordinuar civile, shërbimet emergjente komunale (shërbimin e zjarrfikësve dhe shpëtimit, shërbimin emergjent komunal medicinal, kryqi i kuq , OJQ-të), PK-ën, në mënyrë që këto struktura të jenë të gatshme të reagojnë shpejt dhe me efikasitet në raste emergjente civile.

Me këto struktura jemi në kontakt të përhershëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në raste emergjente. Pastaj, caktimi i subjekteve përgjegjëse, identifikimi i pikave emergjente caktimi i prioriteteve dhe koordinimi sa më efikas në mes të këtyre subjekteve që të reagojnë shpejt, profesionalisht dhe me efikasitet në raste të fatkeqësive natyrore, teknologjike etj. Që të shpëtohen jetët e njerëzve në radhë të parë, pasurisë të mirave materiale dhe stabilizimi i situatës së krijuar gjatë dhe pas emergjencës.

Realizimi i këtyre synimeve kërkon një angazhim të madh jo vetëm të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, por të gjitha organeve komunale për përmbushjen e nevojave me mjetet materiale teknike me qëllim të ngritjes së efikasitetit.

Në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë këtij viti kemi pranuar dhe shqyrtuar 451 lëndë të ndryshme . Të gjitha këto lëndë i kemi shqyrtuar dhe miratuar, gjithashtu nga DMSH janë lëshuar dhe pranuar:

Në fillim të javës së dytë të Janarit 2021 gjegjësisht më 09,10,11 dhe 12 janar Komunën e Vushtrrisë e përfshiu një mot me shi të dendur dhe temperatura mbi nivelin mesatar për këtë stinë me çrast nga shkrirja e borës dhe reshjet e pandërprera të shiut , një pjesë e territorit të komunës u përmyt nga ujërat.

Lumenjtë kryesor e veçanërisht Silnica dolën nga shtrati ku për pasojë shumë prona, shtëpi banimi, anekse shtëpish, prona bujqësore dhe ferma u vërshuan nga uji.

Ekipeve të shpëtimit në koordinim të plotë me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim janë vu në gjendje gatishmërie dhe kanë punuar në punuar në terren për identifikimin e faktorëve ndihmën, shpëtimin dhe lehtësimin e përballimit të kësaj situatë.

Për shkak të vërshimeve është dashtë edhe intervenimi i ekipeve shpëtimtare të përkrahura nga FSK-ja, Njësia e Zjarrfikësve, Policia e Kosovës dhe ekipet vullnetare të cilat janë angazhuar në mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve të rrezikuar nga vërshimet.

Janë vërshuar rreth 250 shtëpi banimi nga të cilat shumica e banorëve janë larguar me të parë rrezikun dhe të cilët janë strehuar tek të afërmit e tyre.

Janë evakuuar gjithsej 14 familje me 48 persona si dhe disa kafshë shtëpiake.

Viktima në njerëz fatbardhësisht nuk ka pasur.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka angazhuar edhe Kompaninë Kontraktuese e cila ka bërë ndërhyrjet e nevojshme për sanimin e gjendjes dhe minimizimin e pasojave.

Pas kalimit të fazës emergjente dhe rënjes së nivelit të ujit, zyrtarët e DMSH-së bashkë me komisionin kanë bërë vlerësimin e dëmeve si në tokat bujqësore ashtu edhe në ekonomitë familjare ku pastaj është bërë kompensimi i pjesrëshëm i atyre dëmeve nga Ministritë e linjës.

NJËSIA E ZJARRËFIKËSVE

Sa i përket gjendjes së përgjithshme të sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri në rajonin e komunës së Vushtrrisë me rrethinë në krahasim me vitin e kaluar mund të thuhet se gjatë këtij viti (2021) ka pasur me pakë raste e veçanërisht atyre të zjarreve (fushore- malore) zjarre të shkaktuara nga temperaturat dhe pakujdesia e faktorit njeri, ndërkaq që janë kryer punë aktivitete (inspektime) të objekteve të ndryshme sipas kategorive të rrezikshmërisë në sektorin e parandalimit nga zjarri (shkaku i zjarrit) dhe hulumtimi - vendshiqimi i ngjarjes (zjarrit) dhe shkaktarit të zjarrit.

Inspektimet janë bërë sipas planit të punës të vitit 2021 dhe sipas rekomandimeve nga Niveli Qendror - Prishtinë, për ndërmarrjen e masave parandaluese-shtese për sezonin veror në bujqësi dhe pylltari për shkak të dukurive të cilat u paraqiten edhe në këtë vit.

Inspektimet janë bërë në objekte të ndryshme si: pompa gasi, pompa derivatesh, fabrika, kopshte fëmijësh, kuvendi komunal, posta, gjykata komuna, spitale, ambulanta, shtëpia e kulturës, biblioteka, kompani ujësjellësi rajonal, kompania për menaxhimin e hedhurinave, trafostacione, etj.

Deri më 31.12.2021 janë kryer 57 inspektime.

- 17 inspektime fillestare
- 40 ishin inspektime të rregullta

Në të gjitha këto objekte janë propozuar 116 -masa parandaluese të cilat janë shënuar në procesverbale.

ZYRA LIGJORE

Gjatë periudhës raportuese, Zyra Ligjore ka kryer këto punë dhe aktivitete:

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prehivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
T-38FT-38FT-38F		T-38F	27.12.2017	

Oytezë / SHREKONICE

A.2 LLOJTI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Nomri Bregj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Statutëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti Klasse Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m ²)
1	Bujqësore/Pojqimorëdud/Agriculture	Kullosar/Pashajaci/pasture	Kullosë E Klasës 2/Pashnjak 2 Klasse/2nd Class Pasture	14617

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtuar Prava Rights	Emri Ise Name	Nr. personai Licencij ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Detaje të adresës Podrobnosti adrese Address details	Pjesa e pronës Diel imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posezim individual / Individualna Dejavina / Single possessor	Komuna e Vushtrisë	600335901	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		AHMET KRASNOI	1/1		






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Qytezë

Njësia/JedInlca/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70202062-0K136-0		



Shkalla/Razmera/Scale: 1:681

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 12.10.2021

Koha/ Vreme/ Time: 03:15:53

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënimi/Beleška/Note:



Aprovoi/Usvojlo/Approved: Drejtori/Direktor/Director



Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATE	21.3.2022
PËR:	Kuvendin e Komunës
PROPOZUES:	Ferit Idrizi  Kryetar i Komunës
HARTUES:	Miradije Maloku  Drejtoreshë e Drejtorisë për Arsim
LËNDA:	Propozim-vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdheve publike në Komunën e Vushtrrisë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja “d”, në lidhje me nenin 14, paragrafi 1 dhe nenin 17, “h” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 41, paragrafi 2, shkronja “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2022, mori këtë:

VENDIM

për ndërrimin e destinimit të ish - objektit të shkollës në çerdhe publike në fshatin Pestovë

1. Me këtë vendim bëhet ndërrimi i destinimit të ish - objektit të shkollës në çerdhe publike në fshatin Pestovë të Vushtrrisë, e cila gjendet në parcelën kadastrale P-70202051-K01181-0 në sipërfaqe prej 18995 m², Zona Kadastrale – Pestovë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Arsim, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është certifikata mbi të drejtën e pronës.
4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

ARSYETIM

Investimi në edukimin e hershëm është vendimi më i duhur për të siguruar një ardhme më të mirë për fëmijët tanë dhe për të siguruar një shoqëri të shëndoshë. Ndërsa, modeli i çerdheve me bazë në komunitet është mënyra më e mirë e gjithëpërfshirjes së prindërve në edukimin e fëmijëve, si dhe për t'i ndihmuar çerdhet tjera në lirim të hapësirës. Andaj, Drejtoria për Arsim bazuar në numrin e fëmijëve në lokalitetin e sipërcekur, e sheh të nevojshme ndërtimin e një çerdheje publike në mënyrë që ata të kenë një ambient më të ngrohtë dhe hapësirë për aktivitete të ndryshme.

Njëherazi, Drejtoria në fjalë i propozon Kuvendit të Komunës që ta aprovojë këtë propozim – vendim.

Miradije Maloku



Drejtoreshë e Drejtorisë për Arsim



PESTOVA

Republika e Kosovës
Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësior dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

18168

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202051-K01181-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	18-678/22
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	23.02.2022 - 09:29
Komuna / Opština / Municipality:	VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Pestovë / Pestovë / Pestovë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azuresano Uprkade Updated
P-70202051-K01181-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna Imovina / Privately owned Land	Rural	18995	AKT Komasacioni 461-235 me date 27.01.1989	08.11.2017	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prehivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azuresano Uprkade Updated
T-663A/T-663A/T-663A			08.11.2017	



A2 LLOJTI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m ²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Araz/Njive/Arable	Arë E Klasës 6/Njiva 6 Klase/6th Class Arable Land	18995

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	PSH.SHKOLLA FILLORE	KCID0213212	PESTOVË / PESTOVË / PESTOVË /			1/1	AKT Komasacioni 461-235 me date 27.01.1989	08.11.2017



Arsyetim

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Vushtrrisë, gjatë kryerjes së punëve dhe shërbimeve ka hasur pengesa në zbatimin e politikave në rregulloren aktuale, dhe po ashtu e sheh të nevojshme për një ristrukturim dhe rirregullim të rregullores aktuale e cila bazuar në ligjet dhe nevojat aktuale ka nevojë për plotësim, ndryshim apo edhe hartim të ri!

Remzi Ahmeti



Drejtor i DBF-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Për: KPF-në dhe Kuvendin e Komunës
Propozues: Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës *Ferit Idrizi*
Hartues: Drejtoria për EBPZHR, Ergin Sunguri *Ergin Sunguri*
Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" dhe nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja "a" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë ____/____/2022 merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES (KKV) NR.03/2020 PËR PÛRKRAHJEN E FERMERËVE NË BUJQËSI DHE BIZNESEVE NË SEKTORIN PRIVAT

1. Me këtë vendim formohet komisioni për plotësim-ndryshimin e Rregullores nr.03/2020 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, me nr. të protokollit 01.nr.45/20 i datës 27.2.2020, në këtë përbërje:

- 1.1 anëtar i kuvendit
- 1.2 anëtar i kuvendit
- 1.3 anëtar i kuvendit
- 1.4 anëtar i ekzekutivit
- 1.5anëtar i ekzekutivit.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi në takimin e parë, në përbërjen e tij duhet të zgjedhë kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, ashtu që të evidentojë ndryshim-plotësimet e dispozitave të rregullores dhe të përgatitë draftin "Propozim-ndryshimet e rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat".

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, bazuar në kërkesat e fermerëve të Komunës së Vushtrisë dhe planifikimet e saj për përkrahje financiare, ka hasur pengesa në zbatimin e politikave të përkrahjes për arsye të disa dispozitave të kësaj rregulloreje aktuale. Andaj bazuar në këto të gjetura, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural kërkon nga Kuvendi i Komunës që të formojë komision për plotësim-ndryshimin e kësaj rregulloreje.



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Për: Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues: Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi 

Hartues: Drejtoria për Buxhet dhe Financa 

Lënda: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2022, merr këtë:

VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR LIRIM NGA PAGESA E TAKSËS PËR
ÇERDHET PUBLIKE

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.29/22 i datës 31.1.2022 lidhur me lirimin nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve për fëmijët që marrin shërbime nga çerdhet publike.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Vendimi për lirimin nga obligimi i pagesës së takës për shërbimet e çerdheve publike, për prindërit, fëmijët e të cilëve marrin shërbime nga çerdhet publike, ishte marrë si pasojë e krijimit të rrethanave nga pandemia covid-19, e njohur si corona-virus, për muajt janar dhe shkurt me vazhdim të afatit deri në një vendim tjetër të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, dhe si rezultat i mbylljes së çerdheve publike.

Në kushtet aktuale të rënies së numrit të infektuarve nga covid-19 dhe hapjes së çerdheve publike, vlerësojmë se kanë pushuar rrethanat për vazhdimin e kësaj mase.

Nga të cekurat më lartë i propozojmë Kuvendit të komunës që ta aprovojë propozim-vendimin si në dispozitiv të tij.

Per
Remzi Ahmeti

Drejtor i DBF-së



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI



Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës *G. Prizreni*
Hartues: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje e Mjedisit *[Signature]*
Çështja për shqyrtim: propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (b), nenin 40, pika 1 e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 28 qershor 2008); neni 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, nën-nënparagrafi 1.2.2, neni 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, neni 11, neni 16 dhe neni 26 i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor i datës 23/08/2013; Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore mbi Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës; neni 41, paragrafi 1 dhe 2, pika (ç) e Statutit të Komunës së Vushtrrisë Nr.28/11 dt.28/04/2011; Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31/03/2022, mori këtë:

VENDIM

PËR ZGJATJEN E AFATIT KOHOR PËR HARTIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË

Pika 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë Vendim zgjatet afati kohor për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë i përcaktuar me vendimin fillestar (nr. 255/18 – 5) të marrë më 27/09/2018 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë;

Pika 2

Subjekti përgjegjës për hartim

Hartës i hartimit të Hartës Zonale të Komunës mbetet Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim Hapësinor (APKPH) respektivisht Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;

Pika 3

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë përderisa zgjatja e afatit kohor nuk e shton nevojën për mjete financiare shtesë. Dokumenti hartohet nga

APKPH në bashkëpunim me drejtorinë komunale dhe nën mbështetjen substanciale të UN-Habitat-it bazuar në Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar mes dy palëve (datë 14/04/2018);

Pika 4
Afati i hartimit

Afati shtesë për hartimin e Hartës Zonale të Komunës nga subjekti përgjegjës është 9 muaj (27/03/2022-27/12/2022) i cili i vazhdohet afatit të mëparshëm (27/09/2018 – 27/09/2020-27/03/2022);

Pika 5
Arsyetimi për zgjatjen e afatit

Afati për hartimin e Hartës Zonale të Komunës zgjatet për arsye të vonesave të shkaktuara nga masat strikte anti-Covid-19 të aplikuara posaçërisht gjatë vitit 2020 dhe 2021; nga proceset e paplanifikuara të ndërlidhura me Hartën Zonale si: mbledhja dhe digjitalizimi i të dhënave për 65 vendbanimet dhe të gjitha fushat tematike dhe krijimi për së pari herë i GIS databazës për planifikim hapësinor, ri-analizat e domosdoshme hapësinore në lidhje me produktet e Planit Zhvillimor i cili doli të ishte i mangët pas vlerësimit të tij, dhe kompleksitetit (në kontekst funksional dhe integruar i të gjitha palëve të interesit) të definimit të kufirit të zonës historike në qendër të Qytetit si dhe hartimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për këtë HZK. Duke marrë parasysh këto, mendojmë se nevojitet edhe pak kohë në funksion të prezantimit të draft-HZK-së në MMPHI, shqyrtimit publik dhe miratimit të HZK-së nga autoritetet përkatëse në nivel lokal dhe qendror.

Pika 5
Dispozitat tjera

Të gjitha pikat tjera nga Vendimi fillestar për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë si: përkufizimi, qëllimi, kufiri i territorit, konsultimet publike, gjuha zyrtare, programi dhe pika 12 mbeten në fuqi;

Pika 6
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas aprovimit të tij në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë.

Kopje për:

1. Arkivin e Komunës
2. MMPH-së
3. DUMM
4. Zyrën e Kryetarit
5. Dosje

Melihate Basholli Latifi

Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Për: Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues: Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi

Hartues: Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Lënda: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2022, merr këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR OFRIMIN E PËRKRAHJES FINANCIARE PËR KLUBIN E HENDBOLLIT "VUSHTRRIA", KLUBET TJERA SPORTIVE DHE SHOQATAT TJERA TË NDRYSHME

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër protokollit 01-Nr.210/21 i datës 6.10.2021 për ofrimin e përkrahjes financiare për klubin e hendbollit "Vushtrria", klubet tjera sportive dhe shoqatat tjera të ndryshme.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me numër protokollit 01-Nr.210/21 i datës 6.10.2021 për ofrimin e përkrahjes financiare për klubin e hendbollit "Vushtrria", klubet tjera sportive dhe shoqatat tjera të ndryshme, është dërguar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa e njëjta këtë vendim e kishte proceduar për vlerësim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në ç' rast (brenda afateve ligjore) kishte kërkuar informata shtesë për këtë çështje, në adresimin e përgjigjes nga ana e Komunës së Vushtrrisë, gjegjësisht Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kjo e fundit kishte deklaruar se: Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në seancën e Kuvendit Komunal ju ka tërheq vërejtjen që ky vendim është në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligjin e Buxhetit, Rregulloren për Shpenzimin e Parasë Publike dhe Udhëzimin Administrativ 2005/8 për Klasifikimin Ekonomik të Shpenzimeve, prandaj ky vendim nuk mund të zbatohet në praktik sepse nuk mund të merren mjetet financiare prej mallrave dhe shërbimeve dhe investimeve kapitale për ndihmë klubeve sportive dhe shoqatave.

Nisur nga faktet e parashtruar më sipër, dhe si rezultat i pamundësisë financiare të komunës për ta zbatuar aktin në fjalë, propozohet shfuqizimi i këtij vendimi, pasi që ministria e linjës nuk ka dhënë përgjigje nëse vendimi është i ligjshëm apo jo.

Nga të cekurat më lartë, vlerësojmë se akti në fjalë nuk ka efekt juridik pasi i njëjti nuk ka marrë konfirmimin e ligjshmërisë nga ana e ministrisë së sipërcekur, andaj i propozojmë kuvendit që bëjë shfuqizimin e tij.

Në shtojcë të këtij propozimi-vendimi gjeni të bashkëngjitur vlerësimet e dhëna nga ministrinë e linjës.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br. 210/21

Nr. i fq. / Br. sh. - 2 -

Data: / Datum 06.10.2021

KOMITETI I VUÇITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 41, paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrië në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 06 tetor 2021 merr këtë:

VENDIM
PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR KLUBIN E HENDBOLLIT
"VUSHTRRIA" KLUBET TJERA SPORTIVE DHE SHOQATAT TJERA TË
NDRYSHME

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare për Klubin e Hendbollit "Vushtrria", klubet tjera sportive dhe shoqatat tjera të ndryshme në vlerat financiare si në vijim:

1.1. OVL e UÇK-së.....	5,250 €
1.2. Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve.....	5,250 €
1.3. Shoqata e Invalidëve të Luftës.....	5,250 €
1.4. Shoqata e Martirëve.....	5,250 €
1.5. Shoqata e të Burgosurve Politik.....	5,250 €
1.6. Handikos.....	8,250 €
1.7. FC "Vushtrria".....	20,250 €
1.8. FC "El Clasico".....	4,250 €
1.9. FC "Forca".....	3,250 €
1.10. "Tifozët Forca".....	10,250 €
1.11. KF i veteraneve "Vushtrria".....	2,250 €
1.12. KHM "Vushtrria".....	10,250 €
1.13. KHF "Vushtrria".....	24,250 €
1.14. KHF "Samadrexha".....	6,250 €
1.15. KHM "Samadrexha".....	6,250 €
1.16. KBB "Vushtrria" F+M.....	2,250 €
1.17. KBB "Vushtrria basket".....	2,250 €
1.18. KBB "Gjimnazisti".....	2,250 €
1.19. KVF "Vushtrria".....	3,250 €
1.20. KVM "AS Vushtrria".....	3,250 €
1.21. KVF "AS Vushtrria".....	3,250 €
1.22. KB "Vushtrria".....	3,250 €
1.23. KB "Kalaja".....	3,250 €


1.24. K.i Kickoxit "Vushtrria".....	4,250 €
1.25. KXH "Studenti".....	3,250 €
1.26. KPPF "Vushtrria".....	2,250 €
1.27. KPPM "Vushtrria".....	2,250 €
1.28. KPP "Hasan Prishtina".....	2,250 €
1.29.KGJ "Vushtrria".....	2,250 €
1.30. KA "Vushtrria".....	2,250 €
1.31. SHPRS " Sitnica".....	3,250 €
1.32. Shoqata e Shurdhërve Vushtri.....	2,250 €
1.33. Qendra Rinore "Hareja".....	6,250 €
1.34. OJQ "ACCESS".....	2,250 €
1.35. OJQ "The Power of Mind".....	2,250 €
1.36. OJQ "Stand Out".....	4,250 €
1.37. OJQ "Viciansa 2019".....	2,250 €
1.38. OJQ "Ura Sociale".....	4,250 €
1.39. OJQ "Strategjia Rinore".....	3,250 €
1.40. Ansambli i këngëve dhe valleve "Hasan Prishtina".....	6,250 €


2. Shuma totale e mjeteve për përkrahje financiare për klubet sportive dhe shoqatat e ndryshme është dyqindmijë euro (200,000.00 €).

3. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të sigurohen nga suficiti në kategorinë mallra dhe shërbime në njësitë buxhetore në të cilat ka mjete të lira, si dhe nga kategoria investimet kapitale (asfaltimi i rrugëve), në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

5.Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu

 Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 11.10.2021 VI-020-855
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës: Gëzim Sahiti , Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse: Ardita Latifi , Zyrtare e lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vushtrrisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, "Vendimin Nr. 212 për përkrahje financiare për Klubin e Hendbollit "Vushtrria", klubet tjera sportive dhe shoqatat e tjera të ndryshme", i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i kuvendit të komunës së Vushtrrisë, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendim Nr. 212 për përkrahje financiare për Klubin e Hendbollit "Vushtrria", klubet tjera sportive dhe shoqatat e tjera të ndryshme

I miratuar më datë: 06.10.2021

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 11.10.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOŠOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkivo - Arhiva - Archive

NUMERU I DOKUMENTIT: 020/150
 Nr. Dokumenti: 4259/2021
 Nr. Primitje: 27
 Dato: 15.10.2021
 PRISHTINE/A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOŠOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration
 Ministry of Local Government Administration

Dato: 15.10.2021

NUMERU I DOKUMENTIT: Nr. Lënda: Shifra: Vija:
 -A- 020-855/2

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transferit -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Trim Berisha, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Kopje:	Hekuran Murati, Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Kryetari i Komunës së Vushtrrisë Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 14.10.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë	
I. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Elmedina Bajgora, Zyrtare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	153/2021
Lënda:	Kërkesë për informatë shtesë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Ministër z. Krasniqi,
 I nderuari Sekretar i Përgjithshëm z. Berisha,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe

Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

<i>Vendimi Nr. 212 për përkrahje financiare të klubeve sportive dhe shoqatave tjera</i>
<i>I miratuar më datë 06.10.2021</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 11.10.2021</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 13.10.2021</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), duke u bazuar vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë, si dhe pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Vushtrrisë, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Vushtrrisë, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon ndarjen e mjeteve për përkrahjen financiare të klubeve sportive dhe organizatave tjera brenda territorit të kësaj komune.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, një tregues i rëndësishëm për të konstatuar ligjshmërinë e aktit komunal është ndarja buxhetore e kategorizuar në bazë të programit dhe/apo klasifikimit ekonomik. Kështu që, me nenin 1 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21, ndarja buxhetore përkufizohet si:

“...shuma maksimale e përcaktuar në një Ligj për Ndarjet Buxhetore e cila mund të vihet në dispozicion për shpenzim nga një organizatë buxhetore gjatë vitit fiskal për shpenzim në një program të caktuar ose kategori tjetër shpenzimi.”

3. Në këtë kuptim, çdo shpenzim i një organizatë buxhetore duhet të ketë të evidentuar kategorinë dhe/apo programin e caktuar të shpenzimit. Si plotësim i kësaj, çdo kategori dhe/apo program i organizatave buxhetore e ka shumën maksimale në dispozicion për shpenzim, e që në esencë duhet të ketë për bazë ndarjet e përcaktuara sipas Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.
4. Në rastin konkret, për të vlerësuar ligjshmërinë e aktit komunal, Komuna e Vushtrrisë në vendimin i cili është subjekt i ligjshmërisë, ka dështuar ta specifikojë programin e caktuar të shpenzimit, dhe rrjedhimisht nga ku po financohet masa e përcaktuar me vendimin administrativ komunal. Në mungesë të këtij specifikimi dhe/ose precizimi, Ministria e ka të pamundur të bëjë konstatimin nëse akti komunal është i ligjshëm ose jo.

5. Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Vushtrisë informata shtesë rreth kategorisë së shpenzimeve, nën-programet buxhetore dhe burimet e fondeve (pra, sqarimin nëse burimi derivon nga grante apo të hyra vetanake) për realizimin e vendimit administrativ-komunal, në mënyrë që të procedohet tutje me shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit administrativ.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Vushtrisë dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë shkresë.

Me respekt!



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Vushtrisë Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Date: 11.10.2021 VI-020-855
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministrinë të Linjës Gëzim Sahifi, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
	2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vushtrisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, "Vendimin Nr. 212 për përkrahje financiare për Klubin e Hendbollit "Vushtrria", klubet tjera sportive dhe shoqatat e tjera të ndryshme", i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrisë, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i kuvendit të komunës së Vushtrisë, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendim Nr. 212 për përkrahje financiare për Klubin e Hendbollit "Vushtrria", klubet tjera sportive dhe shoqatat e tjera të ndryshme

I miratuar më datë: 06.10.2021

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 11.10.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

08.10.2024

PËR/ZA/TO:	MAPL Departamenti Ligjor zgj. Venera Çerkini
NGA/OD/FROM:	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, z. Nasur Aliu
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Në shtojcë të kësaj shkresë iu dërgojmë aktin e aprovuar të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 06 tetor 2021, për shqyrtim të ligjshmërisë konform dispozitave të LVL-së dhe atë si të vijim:

1. Vendimin për përkrahje financiare për Klubin e fildbollit "Vushtrria", klubet tjera sportive dhe shoqatat e tjera të ndryshme.

Nga ju presim përgjigje me shkrim brenda afatit ligjor lidhur me ligjshmërinë e aktit të shënuara më lartë.

Me respekt!

Kuvendi Komunal Vushtrri

From: Kuvendi Komunal Vushtrri
Sent: Tuesday, October 19, 2021 8:35 AM
To: Ardita Latifi
Subject: Fw: Kërkesë për informatë shtesë

Sekretaria e Kuvendit Komunal
Komuna e Vushtrrisë

038 200 42439

From: Lutfi Gerguri
Sent: 18 October 2021 09:30
To: Kuvendi Komunal Vushtrri; Abit Abiti; Berat Sadiku; beratsadiku@gmail.com
Cc: Xhafer Sh. Tahiri
Subject: RE: Kërkesë për informatë shtesë

Te nderuar

Unë si Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe financa në seancen e Kuvendit Komunal ju kam tërheq vërejtjen që ky vendim është në kundërshtim me LMFPF, me Ligjin e Buxhetit ,rregulloren për shpenzimin e paras publike dhe UA 2005/8 për klasifikimin ekonomik të shpenzimeve ,prandaj ky vendim nuk mund të zbatohet në praktik sepse nuk mund të merren mjetet financiae prej mallrave dhe shërbimeve dhe investimeve kapitale për ndihmë klubeve sportive dhe shoqatave

From: Kuvendi Komunal Vushtrri <kuvendi.vushtrri@rks-gov.net>
Sent: Friday, October 15, 2021 2:39 PM
To: Abit Abiti <abit.abiti@rks-gov.net>; Lutfi Gerguri <lutfi.gerguri@rks-gov.net>; Berat Sadiku <berat.sadiku@rks-gov.net>; beratsadiku@gmail.com
Cc: Xhafer Sh. Tahiri <Xhafer.Sh.Tahiri@rks-gov.net>
Subject: Fw: Kërkesë për informatë shtesë

Përshëndetje të nderuar,

Është kërkesë e Ministrisë së Financave, që të ofrohen informata shtesë lidhur me vendimin për subvencionimin e klubeve sportive dhe shoqatave.

Presim informata nga ana juaj brenda afatit prej dy (2) ditë pune si afat ligjor.

Sekretaria e Kuvendit Komunal

Komuna e Vushtrrisë

038 200 42439

From: Ardita Latifi
Sent: 15 October 2021 11:19
To: Nasuf Aliu; nasufaliu@gmail.com; Batri Duraku; Kuvendi Komunal Vushtrri
Cc: Gëzim Sahiti; Besim Murtezani
Subject: FW: Kërkesë për informatë shtesë

Të nderuar,

Bashkëngjitur gjeni shkresën të cilën kemi pranuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me Vendimin Nr. 212 për përkrahje financiare për Klubin e Hendbollit "Vushtrria", klubet tjera sportive dhe shoqatat e tjera të ndryshme".

Ju lutem, që bazuar në këtë shkresë, na përcjellni informatat shtesë të kërkuara nga MFPT!

Ju faleminderit shumëArdita

From: Shkrimorja Mapl
Sent: Friday, October 15, 2021 9:20 AM
To: Besim Murtezani <Besim.Murtezani@rks-gov.net>; Gëzim Sahiti <Gzim.Sahiti@rks-gov.net>; Ardita Latifi <Ardita.Latifi@rks-gov.net>
Cc: Saranda Stublla <Saranda.Stublla@rks-gov.net>; Doruntina E. Hasani <Doruntina.E.Hasani@rks-gov.net>; Arjeta F. Shala <Arjeta.F.Shala@rks-gov.net>; Lendita S. Muhaxheri <Lendita.S.Muhaxheri@rks-gov.net>; Sibel Gutiq <Sibel.Gutiq@rks-gov.net>; Mimoza S. Morina <mimoza.s.morina@rks-gov.net>
Subject: Kërkesë për informatë shtesë




Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Për: Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues: Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë 

Hartues: Fortuna Krasniqi, Drejtoreshë e DUMM-së 

Lënda: Propozim-vendim

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, dhe nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d", në lidhje me nenin 14, paragrafi 1 dhe 17, shkronja "c" dhe "f" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2022, merr këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIMIN DHE HARMONIZIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIM TË TREGUT TË GJELBËR PËR PRODHIME VENDORE NË VUSHTRRI

1. Me këtë vendim plotësohet dhe harmonizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01-54/22 i datës 24.2.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtri, në parcelën kadastrale P-70202016-00655-0, në sipërfaqe prej 1637 m², Zona Kadastrale Vushtri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, ashtu që ndryshimi i vendimit të cekur më lartë konsiston në plotësimin e preambulës së vendimit me referencat në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, dhe Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024, konfom instruksioneve ligjore të dhëna nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit
4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPSTINA VUCITRN

21 Nr. / Br. 54/22

Nr. i sq. / Pr. si -1-

Data / Datum 24.02.2022

VESHTRRI - VUCITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja "d", në lidhje me nenin 14, paragrafi 1 dhe 17, shkronja "c" dhe "f" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 24 shkurt 2022, merr këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIM TË TREGUT TË GJELBËR PËR PRODHIME VENDORE NË VUSHTRRI

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtri, në parcelën kadastrale P-70202016-00655-0, në sipërfaqe prej 1637 m², Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit
4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuesë e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIJSVO ŽIVOTNE SREDINA, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org.Jedlika Org.Unit	02	Nr i Prot. Broj Prot. Prot.No.	1138-2/22
Nr i Faqëve Be Stranica No.Pages	-02-	Data: Datum: Date	25.03.21
PRISHTINË / A			No 1

Për:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrri, Melihate Basholli - Latifi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI	
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor	Datë: 22.03.2022
Zyrtarët përgjegjës:		
1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të	
2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit	
Lënda:	Vendimi është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi	
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.54/22 për caktimin e lokacionit për ndërtim të tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri, miratuar nga KK Vushtrri.	

I nderuari Kryetar/e Idrizi,
I nderuar Kryesues/e Basholli - Latifi,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI) ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.54/22 për caktimin e lokacionit për ndërtim të tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri, miratuar nga KK Vushtrri
I miratuar më datë: 24.02.2022
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.03.2022
I dërguar për shqyrtim në MMPHI më datë: 15.03.2022

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së Vendimit Nr.54/22 për caktimin e lokacionit për ndërtim të tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri, miratuar nga KK Vushtrri, vlerëson se akti është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.54/22 për caktimin e lokacionit për ndërtim të tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri, miratuar nga KK Vushtrri, konstatoi se:

- Hyrja e vendimit është e bazuar vetëm në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Vushtrrisë, dispozitat e të cilave nuk e rregullojnë fare çështjen e caktimit të lokacionit.
- Vendimi Nr.54/22 për caktimin e lokacionit për ndërtim të tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri, nuk është i bazuar në Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor
- Gjithashtu, vendimi nuk është i bazuar as në dokumentet e planifikimit hapësinor sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe dokumentet tjera (tekstuale dhe grafike) që janë në fuqi të parapara me këtë ligj.

Bazuar në nga ajo që u tha më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës i propozon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.